

NXITJA E ZHVILLIMIT RAJONAL NEPERMJET OBJEKTIVAVE TE MIJEVJEÇARIT

QARKU I BERATIT





**NXITJA
E ZHVILLIMIT RAJONAL
NEPERMJET OBJEKTIVAVE
TE MIJEVJEÇARIT**

Procesi i përgatitjes së raportit u drejtua nga Grupi Qëndror i përbërë nga:

Vullnet Zylyftari, Luiza Hoxha, Vjollca Hoxha, Artur Kurti, Ymer Kordha, Agim Koxhaj, Sezai Kurti, Fatmira Mustafarai, Neki Hysko dhe Dervish Hoxha.

Për pjesë të veçanta bashkëpunuan:

Drejtorja e Programim-Zhvillimit, Drejtorja e Shërbimeve dhe Seksioni i Ruajtjes dhe Administrimit të Tokës në Këshillin e Qarkut, Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik të Prefekturës, Drejtoritë e Zhvillimit Ekonomik të bashkive, Drejtorja e Shërbimit Parësor, Drejtorja e Sigurimit Shëndetësor, Drejtoritë e Shëndetit Publik të rretheve, Drejtoritë Arsimore të rretheve, Drejtoritë e Bujqësisë të rretheve, Zyra Rajonale e Përkrahjes Sociale, Zyra Rajonale e Punësimit, Drejtoritë e Pyjeve dhe Kullotave të rretheve, Agjencia Rajonale e Mjedisit, Agjencia Rajonale e Zhvillimit.

si dhe:

Alketa Durdia, Arjan Ruka, Besa Peçi, Bujar Lybesha, Haki Kola, Kastriot Spahiu, Kliti Ceca, Lindita Prendi, Luan Abedini, Maksim Konini, Margarita Caci, Milva Ekonomi, Nexhmije Xhezo, Nurie Çausi, Silvana Simaku, Sotir Rrapo, Tatjana Liçollari dhe Ymer Tola.

Përgatitja e raportit u bë me ndihmën e Qendrës për Nxitjen e Zhvillimit Njerëzor (HDPC). Autorë udhëheqës: Dr. Lindita Xhillari dhe Dr. Ylli Çabiri

Për më shumë informacion, ju lutem kontaktoni:

Drejtorja e Programim-Zhvillimit
Këshilli i Qarkut Berat
Tel: +355 32 34 754, Fax: +355 32 34 283

Qendra për Nxitjen e Zhvillimit Njerëzor (HDPC)
Rr. Vaso Pasha, P. 9/1, Tiranë
Tel: +355 4 253 300, Fax: +355 4 253 299
E-mail: hdpc@icc-al.org

dhe

Zyra e Përfaqësuesit Rezident të UNDP në Shqipëri
Tel: +355 4 233122
E-mail: registry.al@undp.org

Këtë Raport mund ta gjeni në trajtë elektronike nëpërmjet rrjetit të internetit me adresë:

<http://www.undp.org.al> dhe
<http://www.berat.org.al>

Redaktor i gjuhës shqipe:
Prof. Dr. Xhevat Lloshi



Përmbajtja e lëndës

Hyrje	7
Zhvillimi ekonomik dhe të ardhurat	13
Shtimi i mundësive për shkollim	49
Nxitja e barazisë gjinore	73
Përkujdesja për shëndetin e nënës dhe fëmijës	87



Hyrje

Në shtator të vitit 2000, udhëheqësit e 191 vendeve të botës nënshkruan Deklaratën e Mijëvjeçarit, e cila, duke sintetizuar Konventat dhe Deklaratat e mëparshme mbi zhvillimin, përcakton 8 Objektivat e Mijëvjeçarit për Zhvillimin. Nëpërmjet këtyre objektivave, çështje të tilla si: zhdukja e varfërisë, kryerja universale e arsimit bazë, nxitja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i rolit të gruas, zvogëlimi i vdekshmërisë foshnjore, rritja e kujdesit për shëndetin e nënës, lufta kundër sëmundjeve të rrezikshme, sigurimi i një mjedisi të qëndrueshëm dhe partneriteti për zhvillim global, u vlerësuan si kërkesat më themelore për të nxitur një zhvillim të qëndrueshëm të secilit vend. Më pas, këto Objektiva u zbrëthyen në 18 synime e 48 tregues, që ndihmojnë për matjen e përparimit të secilit vend. Si firmëtare e Deklaratës së Mijëvjeçarit, Shqipëria, e mbështetur nga UNDP, është përfshirë në një proces të gjerë njohjeje, ndërjegjësimi, zbrëthimi e zbatimi të secilit prej Objektivave të Mijëvjeçarit. Strategjia

Kombëtare e Zhvillimit Ekonomik e Social, që përcakton drejtimit themelore të zhvillimit të Shqipërisë për një periudhë afatmesme, tashmë merr parasysh edhe këta Objektiva, duke përzgjedhur tregues sasiore për çdo sektor. Këta tregues janë në harmoni dhe po kombinohen me të gjithë treguesit e reformave që po ndërmerren në kuadrin e procesit të Stabilizim-Asociimit, i cili konsiderohet si një objektiv mjaft i rëndësishëm për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Zyra e UNDP në Tiranë u bë, gjithashtu, nismëtare për lokalizimin në nivel qarku e rrethi të synimeve dhe treguesve të këtyre Objektivave, duke i shndërruar ato në instrumente nxitëse të zhvillimit të gjithanshëm rajonal. Nevoja për këtë zbrëthim u pohua gjatë debateve të gjera e mjaft të frutshme të përfaqësuesve të aktorëve vendorë në kuadrin e një turneu rajonal të Objektivave të Mijëvjeçarit, ku u mbështet idea e shndërrimit të Objektivave në instrumente nxitëse të zhvillimit të gjithanshëm rajonal.



Vështrim i përgjithshëm

Qarku i Beratit, i teti në vend për nga numri i popullsisë dhe i nënti për nga sipërfaqja, përbëhet prej tre rrethesh: Berati, Kuçova dhe Skrapari. Secili prej tyre, deri në vitin 1990, dallohej si për prodhimin bujqësor e blegtoral, ashtu edhe për atë industrial. Që në fillimet e periudhës së tranzicionit, privatizimi i tokës solli ndryshime thelbësore në zhvillimin e zonës rurale, veçanërisht në strukturën e prodhimit dhe në të ardhurat e fermave private. Ndërsa industria dhe, veçanërisht, ndërmarrjet e mëdha të industrisë së lehtë, industrisë mekanike dhe të nxjerrjes e përpunimit të naftës, nuk mundën të mbijetojnë. Nga ky këndvështrim, qarku i Beratit në përgjithësi dhe rrethi i Beratit dhe Kuçovës në veçanti, mund të renditen midis rajoneve me pasoja të rënda nga reformat e tranzicionit.

Papunësia e lartë, niveli i ulët i prodhimit bujqësor, si dhe faktorë të tjerë që lidhen me shtrirjen gjeografike dhe nivelin e shërbimeve, kanë nxitur migrimin e popullsisë. Ndikim të madh kanë patur edhe ngjarjet e vitit 1997. Aktualisht, qarku i Beratit renditet i treti në shkallë vendi për numrin e popullsisë së larguar gjatë 10 vjetëve të fundit. Kjo është shumë më e theksuar për rrethin e Skraparit, ku rezultoi se është shpërngulur rreth 35% e popullsisë. Si rrjedhim edhe popullsia aktive e qarkut është zvogëluar rreth 33% në qytet dhe rreth 49% në fshat.

Qarku i Beratit dallohet për burime të shumta natyrore e njerëzore. Por ai dallohet, veçanërisht, për një potencial të madh turistik ende të panxjerrë në pah e të pashfrytëzuar sa duhet.

Vlerat më të spikatura turistike të tij lidhen me qytetin muze 2,400 vjeçar të Beratit, parkun kombëtar të Tomorit dhe mjedise të tjera natyrore me florë dhe faunë shumë të pasur. Duke u bazuar në këto burime, në këtë qark po bëhen përpjekje të mëdha për rritjen e ritmeve të zhvillimit ekonomik e shoqëror dhe zbutjen e varfërisë. Në kuadrin e këtyre përpjekjeve, të gjitha strukturat e pushtetit vendor të bashkërenduara nga Këshilli i Qarkut, si dhe të gjithë aktorët e tjerë lokalë, u përfshinë në përgatitjen e këtij dokumenti strategjik për zhvillimin rajonal, me synimin që të përcaktojnë objektivat e zhvillimit dhe masat përkatëse prioritare, të harmonizuara me Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit.

Procesi i përgatitjes

Procesi i përgatitjes së këtij dokumenti është drejtuar prej një grupi qendror, të përbërë nga përfaqësues të pushtetit vendor, të strukturave të pushtetit qendror, që veprojnë në nivel lokal, dhe të organizatave të shoqërisë civile. Ky grup, i mbështetur në debatin e gjerë të zhvilluar në shkallë qarku mbi raportin “Shqipëria dhe Objektivat e Mijëvjeçarit”¹ si dhe në vlerësimin e treguesve të zhvillimit të qarkut, të rretheve përbërëse të tij, të bashkive dhe të komunave, përzgjedhi edhe çështjet më themelore, ku duhen përqendruar analizat dhe ndërhyrjet në qarkun e Beratit. Rritja e të ardhurave, shtimi i mundësive për shkollim, nxitja e barazisë gjinore dhe përkujdesja për shëndetin e nënës dhe fëmijës, ishin katër drejtimet e përzgjedhura.

Rreth 40 specialistë të këtyre fushave nga administratat vendore të qarkut, bashkive dhe

¹Raport i përgatitur në maj të vitit 2002 nga Qendra për Nxitjen e Zhvillimit Njerëzor (HDPC) për sistemin e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri.

komunave, nga drejtoritë rajonale që administrojnë përgjegjësitë e pushtetit qendror në nivel lokal, nga Organizata Jofitimprurëse vendore dhe nga sektori privat, të grupuar sipas problematikës së përzgjedhur, u përfshinë drejtpërdrejt në përgatitjen e bazës së të dhënave, në analizat specifike dhe në përcaktimin e orientimeve mbi përparësitë e zhvillimit që lidhen me këta objektiva.

Materialet e përgatitura nga secili grup iu nënshtruan debateve në tryeza të rrumbullakta, me pjesëmarrje të më shumë se 250 specialistësh dhe perfaqësuesish të komunave, biznesit privat, shoqërisë civile dhe medias. Kjo ndihmoi vështrimin realist të gjendjes dhe të prioriteteve të përzgjedhura, si dhe përcaktimin e potencialeve të qarkut për t'i zbatuar këto përparësi. Këto debate ishin veçanërisht të frytshme për formulimin e synimeve dhe treguesve të përshtatshëm vendorë për secilin nga Objektivat e Mijëvjeçarit.

I gjithë procesi u përcoll te publiku i gjerë nga mediat lokale, të cilat pasqyruan hap pas hapi takimet e specialistëve dhe debatet për çështjet më themelore të zhvillimit të qarkut, veçanërisht për papunësinë, të ardhurat nga fermat private, mundësitë për t'u arsimuar dhe për të pasur shërbim shëndetsor në fshat etj.

Ky proces u mbështet nga të gjitha Agjencitë e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, të cilat ndihmuan me ekspertizë sipas përkatësisë së çështjeve që u trajtuan. Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara (UNDP) dha mbështetjen kryesore, duke vënë në dispozicion të procesit edhe ekspertizën e projekteve që financohen prej tij në të gjithë Shqipërinë, të shoqëruar me trajnime për administratën vendore dhe për aktorë të tjerë të interesuar.

Në këtë mënyrë, përgatitja e këtij dokumenti strategjik shërbeu edhe si një proces njohjeje të thellë në nivel vendor të Objektivate të Mijëvjeçarit, ngritjeje kapacitetesh në administratat dhe në strukturat e zgjedhura vendore, pjesëmarrjeje të publikut dhe medias në diskutimin e mundësive reale për përmbushjen e objektivate dhe debati për masat që duhen marrë me përparësi në qarkun e Beratit, për të zgjidhur problemet më kryesore dhe përshpejtuar progresin. Objektivat e Mijëvjeçarit u kthyen kështu në nxitës të pjesëmarrjes së publikut të gjerë në një debat demokratik mbi zhvillimin e qarkut.

Përmbajtja

Për të shmangur trajtesat e gjera e të përgjithshme, në këtë dokument janë përzgjedhur dhe analizuar vetëm ato çështje, ndikimi i të cilave është mbizotërues për secilin sektor dhe që mund të përshpejtojë ritmet e përmbushjes së objektivate. Kështu, profili i varfërisë është analizuar veçmas për zonën urbane dhe rurale. Në zonën urbane, punësimi, nëpërmjet zgjerimit të biznesit privat, shfrytëzimit të potencialeve turistike dhe përshtatjes me tregun e punës, është veçuar si kushti themelor për zbutjen e varfërisë, duke qënë se papunësia reale është mjaft e lartë, e ndikuar edhe nga falimentimi i industrisë gjatë periudhës së tranzicionit. Në zonën rurale, rritja e prodhimit nga fermat, ndryshimi i strukturës së prodhimit të tyre, rritja e kapaciteteve përpunuese të prodhimeve bujqësore e blegtorale, mbarështimi i qëndrueshem i pyjeve dhe zgjerimi i zonave të mbrojtura, janë veçuar si rrugët më kryesore për të rritur të ardhurat. Një analizë e veçantë është bërë për gjendjen e infrastrukturës rrugore në zonat rurale dhe mundësitë reale që kjo krijon për lidhjen e fermave private me tregun.



Shtimi i mundësive për shkollim është përqendruar në analizën e treguesve më kryesorë të arsimit bazë, duke veçuar rëndësinë e rritjes së mundësisë reale të nxënësve për të ndjekur shkollën, shpërndarjen optimale të infrastrukturave dhe burimeve njerëzore, si dhe vendosjen e disa standardeve në arsim. Arsimi profesional është përcaktuar si një drejtim strategjik prioritar për zhvillimin e arsimit në qarkun e Beratit. Bazuar në një analizë të hollësishme, janë përzgjedhur edhe masat më të rëndësishme që duhen marrë për përmirësimin e gjendjes së këtij sektori, ku mund të veçohen optimizimi i arsimit profesional, rritja e llojshmërisë së ofertave për kualifikime profesionale dhe rritja e autonomisë financiare.

Nxjtja e barazisë gjinore është trajtuar nëpërmjet analizës së nivelit të arsimit, punësimit dhe përfshirjes së femrave në jetën politike e shoqërore në nivel lokal, duke analizuar në veçanti kontributin e femrave në sektorin e arsimit dhe në strukturat vendimmarrëse vendore të të gjitha niveleve, në përfaqësimin e tyre në organet drejtuese lokale të partive politike dhe në përfshirjen e tyre në organizatat jofitimprurëse. Nevoja për ndërgjegjësimin e publikut dhe të të gjitha niveleve politike e qeverisëse të qarkut mbi rritjen e pjesëmarrjes së femrave në të gjitha aspektet e jetës politike, ekonomike e shoqërore është nxjerrë në plan të parë, për shkak të treguesve mjaft të ulët që ka qarku në këto aspekte.

Përkujdesja për shëndetin e nënës dhe fëmijës është mbështetur në analizën e vdekshmërisë foshnjore dhe amësore dhe të mundësisë për të pasur shërbime shëndetësore bazë, duke vënë theksin në domosdoshmërinë e rritjes së mundësive për ta pasur shërbimin shëndetësor

në fshat. Plotësimi me ambulanca i fshatrave, veçanërisht në rrethin e Skraparit, dhe shpërndarja optimale e personelit shëndetësor, janë quajtur si masa prioritare që duhen ndërmarrë.

Mbështetur në analizat e bëra për të gjitha këto çështje dhe në vlerësimet e ekspertëve lokalë, janë përcaktuar synime afatgjata dhe tregues sasiorë, si dhe janë parashikuar vlerat e tyre për periudha afatmesme dhe, aty ku ka qenë e mundur, afatgjata. Në këtë mënyrë, për qarkun e Beratit është arritur si përfundim të një paketë me 4 objektiva, 11 synime dhe 36 tregues sintetikë. Këto parashikime dhe masat prioritare për arritjen e tyre janë të harmonizuara me objektivat e prioritetet afatmesme dhe afatgjata të përcaktuara në shkallë vendi në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social dhe me strategjitë sektoriale të përgatitura nga disa ministri të linjës, sipas një skenari realist sidomos të mundësive dhe kontributeve lokale.

Një qasje e re

Pothuajse të gjitha çështjet e trajtuara në këtë dokument ndërthuren me njëra tjetrën, çka provon një lidhje të ngushtë dhe varësi të ndërsjellë midis Objektivave të Mijëvjeçarit për Zhvillimin. Punësimi për zbutjen e varfërisë lidhet ngushtë me arsimin dhe formimin profesional, çështjet gjinore lidhen me punësimin, mundësinë për shkollim dhe mbrojtjen e shëndetit, vdekshmëria foshnjore dhe ajo amësore janë të lidhura me kushtet sociale dhe ekonomike të familjeve dhe me nivelin kulturor të tyre, zhvillimi ekonomik i qarkut nuk mund të arrihet pa zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit, përmirësimin e gjendjes së pyjeve dhe zgjerimin e zonave të mbrojtura. Si rrjedhim, edhe shumica e ndërhyrjeve prioritare në nivel lokal mund të

bëhen të kombinuara, duke shpenzuar më pak kohë dhe financime.

Të gjitha këto analiza janë mbështetur në llogaritjen e të ardhurave për frymë, e mundësive për të pasur shërbime dhe daljen në treg, të cilat bëhen për herë të parë.

Synimet dhe treguesit lokalë

Drejtimet strategjike të zhvillimit të qarkut për secilin prej objektivave të përzgjedhur janë sintetizuar në 11 synime dhe 36 tregues të matshëm, të cilët shërbejnë për të vlerësuar periodikisht shkallën e përmbushjes së objektivave dhe nivelin e arritur të zhvillimit. Në përzgjedhjen e synimeve dhe treguesve janë pasur parasysh Objektivat e Mijëvjeçarit për Zhvillimin, si dhe masat e parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social dhe treguesit afatgjatë që janë parashikuar në këtë strategji për secilin sektor. Të gjitha këto janë përshtatur për qarkun e Beratit, duke u mbështetur në analizat e hollësishme që janë bërë në këtë dokument mbi gjendjen dhe mundësitë e zhvillimit të secilit sektor.

Synimet dhe treguesit lokalë të përzgjedhur nuk duhen vështruar si të pandryshueshëm. Ato kanë nevojë të verifikohen dhe përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme gjatë procesit të monitorimit dhe përditësimit të kësaj strategjie.

Zbatimi dhe matja e përparimit

Ky dokument strategjik është një bazë e mirë nisjeje drejt përcaktimit të projekteve prioritare, formulimit të projekteve dhe përpjekjeve për sigurimin e financimeve, në radhë të parë nga burimet e brendshme, ku përfshihen ato të

buxhetit të shtetit dhe fondet e veta. Këshilli i Qarkut e konsideron këtë si hapin e parë që do të ndërmerret për zbatimin e kësaj strategjie. Një proces i tillë merr rëndësi të madhe veçanërisht tani që ka një anagazhim të dukshëm për ecjen e shpejtë të reformës së decentralizimit fiskal.

Ky dokument është, gjithashtu, një udhëzues i mirë për donatorët ndërkombëtare, përfshirë Agjencite e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, që janë të interesuara të mbështesin prioritetet e zhvillimit të qarkut të Beratit.

Përmbajtja e këtij dokumenti krijon mundësinë e monitorimit të progresit për të gjitha fushat prioritare të shtjelluara. Treguesit e përzgjedhur janë tregues lokalë dhe mjaft tipikë për qarkun e Beratit. Ata janë të matshëm dhe shkalla e përmbushjes së tyre mund të vlerësohet në mënyrë periodike. Kjo nxit, gjithashtu, pjesëmarrjen e publikut të gjerë të qarkut në proceset e politikëbërjes lokale dhe kontributin e tyre në zhvillimin e mëtejshëm lokal.



SYNIMET

TREGUESIT

OBJEKTIVI 1 ZHUKJA E VARFËRISË EKSTREME DHE E URISË

1. Përgjysmimi, brenda periudhës 1990 - 2015, i pjesës së popullsisë, të ardhurat e së cilës janë më pak se një dollar në ditë	1. Përqindja e popullsisë me më pak se një dollar në ditë
2. Përgjysmimi, brenda periudhës 1990 - 2015, i numrit të njerëzve që vuajnë nga uria.	2. Raporti i varfërisë (rastet e ndeshura x thellësia e varfërisë)
	3. Pjesa e kuantileve më të varfëra në konsumin kombëtar
	4. Mbitotërimi i fëmijëve nën peshë (nën moshën 5 vjeç)
	5. Përqindja e popullsisë së cilës i mungon ushqimi i balancuar.

OBJEKTIVI 2 KRYERJA E ARSIMIT FILLOR NGA TË GJITHË

3. Të sigurohet që brenda vitit 2015, fëmijët, kudo që janë, si djemtë ashtu edhe vajzat, të kenë mundësi të kryejnë arsimin e plotë fillor.	6. Raporti i frekuentimit neto në arsimin fillor
	7. Përqindja e nxënësve që fillojnë klasën e parë, të cilët arrijnë klasën e pestë.
	8. Përqindja e atyre që dinë shkrim e këndim në grup moshën 15-24 vjeç.

OBJEKTIVI 3 NXITJA E BARAZISË GJINORE DHE FUQIZIMI I ROLIT TË GRUAS

4. Zhdukja mundësisht deri në vitin 2005 i dallimeve gjinore në arsimin fillor e të mesëm dhe deri në vitin 2015 në të gjitha nivelet e arsimit.	9. Raporti i vajzave me djemtë në arsimin fillor, tetëvjeçar e të mesëm.
	10. Raporti i vajzave me djemtë me shkollim në moshën 15-24 vjeç.
	11. Përqindja e grave të punësuar në sektorin jo bujqësor.
	12. Përqindja e grave deputete në parlament.

OBJEKTIVI 4 ZVOGËLIMI I VDEKSHMËRISË FOSHNJORE

5. Brenda periudhës 1990-2015 të zvogëlohet me dy të tretat norma e vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç.	13. Vdekshmëria nën moshën 5 vjeç.
	14. Vdekshmëria foshnjore.
	15. Përqindja e fëmijëve njëvjeçarë të vaksinuar ndaj fruthit.

OBJEKTIVI 5 PËRMIRËSIMI I SHËNDETIT TË NËNËS

6. Pakësimi me 3/4 brenda periudhës 1990-2015 të normës së vdekshmërisë amëtare.	16. Vdekshmëria amëtare.
	17. Përqindja e lindjeve të asistuara nga personeli i kualifikuar shëndetsor.

OBJEKTIVI 6 TË LUFTOEN VIRUSI I HIV/AIDS, MALARJA DHE SËMUNDJET E TJERA

7. Të ndalohet përhapja e virusit HIV/AIDS deri në vitin 2015 dhe të fillojë prirja e kundërt.	18. Mbitotërimi i HIV në gratë shtatzëna të moshës 15-24 vjeç.
8. Brenda vitit 2015, të ndalohet rritja e numrit të rasteve të malarisë e sëmundjeve të tjera dhe të nisë prirja e kundërt.	19. Shkalla e përdorimit të kontrceptivëve.
	20. Numri i fëmijëve që kanë mbetur jetimë për shkak të virusit HIV/AIDS.
	21. Numri i vdekjeve të shkaktuara nga malaria.
	22. Përqindja e popullsisë në zonat me rrezik malarieje.
	23. Rastet e vdekjeve me TB.
	24. Përqindja e rasteve me TB të diktuar dhe mjekuara në programin DOTS.

OBJEKTIVI 7 MJEDISI DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM

9. Përfshirja e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programet e vendit dhe kthimi në të kundërt i prirjes së humbjes së burimeve mjedisore.	25. Përqindja e sipërfaqes së mbuluar me pyje.
	26. Toka e mbrojtur për të ruajtur diversitetin biologjik.
	27. PBB për njësi të përdorimit të energjisë.
	28. Lëshimi në ajër i dyoksidit të karbonit (për frymë)
10. Përgjysmimi brenda vitit 2015 i numrit të njerëzve pa furnizim të vazhdueshëm me ujë të pijshëm të sigurtë.	29. Përqindja e popullsisë me furnizim të vazhdueshëm nga një burim uji i përmirësuar.
11. Brenda vitit 2020, të jetë arritur një përmirësim i ndjeshëm në jetën e të paktën 100 milion njerëzve që banojnë në banesa të papërshtatshme.	30. Përqindja e popullsisë me sistem higjieno-sanitar të përmirësuar.

OBJEKTIVI 8 ZHVILLIMI I PARTNERITETIT GLOBAL

zhvillimi ekonomik dhe të ardhurat

“Lufta kundër varfërisë së skajshme dhe urisë” është Objektivi i parë i Mijëvjeçarit për Zhvillimin. Përgjysmimi brenda vitit 2015 i pjesës së popullsisë me të ardhura nën 1 \$ në ditë është synimi më kryesor i këtij objektivi². Sipas analizave në nivel kombëtar, del se Shqipëria mbase e përmbush këtë objektiv dhe se shkalla e mbështetjes së politikave, kuadrit ligjor, burimeve të financimit, ndërgjegjësimit të publikut etj., për ta përmbushur këtë objektiv deri në vitin 2015 është e dobët në përmirësim³. Ky objektiv i rëndësishëm është i ndërthurur me zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit, që është një Objektiv tjetër i Mijëvjeçarit Zhvillimin. Integrimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programet e zhvillimit të vendit dhe kthimi në drejtim të kundërt i prirjes së humbjes së burimeve mjedisore është një ndër synimet më kryesore të këtij objektivi. Përqindja e sipërfaqes së mbuluar me pyje dhe niveli i mbrojtjes së tokës për të ruajtur diversitetin biologjik konsiderohen si tregues për të vlerësuar shkallën e arritjes së këtij synimi. Sipas analizave në nivel kombëtar, del se Shqipëria e ka të vështirë ta përmbushë këtë objektiv dhe se shkalla e mbështetjes së politikave, kuadrit ligjor, burimeve të financimit, ndërgjegjësimit të publikut etj. për ta përmbushur këtë objektiv deri në vitin 2015 është e dobët.

²Sipas anketës mbi nivelin e jetesës në Shqipëri (LSMS), të kryer në vitin 2002 nga INSTAT me mbështetjen e Bankës Botërore, konsiderohen «ekstremisht të varfër» ata që konsumojnë deri në 3,847 lekë/frymë në muaj dhe «të varfër» ata që konsumojnë midis 3,847 dhe 4,891 lekë/frymë në muaj.

³UNDP (HDPC), “Shqipëria dhe Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit”, Tiranë, maj 2002. Nivelet e përdorura për vlerësimin e mundësisë së përmbushjes së objektivit janë “Mundet”, “Mbase”, “Vështirë” dhe “S’ka të dhëna”. Nivelet e përdorura për vlerësimin e shkallës së mbështetjes së mjedisit janë “E plotë”, “Normale”, “E dobët në përmirësim” dhe “E dobët”.

1.1 Tipare demografike

Popullsia

Qarku i Beratit renditet i teti në vend për numrin e popullsisë dhe i nënti për nga sipërfaqja e tij. Popullsia e qarkut është rreth 193 mijë banorë me dendësi mesatare rreth 107 persona për km², pothuajse sa mesatarja e vendit. Dendësine më të lartë e ka rrethi i Kuçovës, 420.2 banorë për km². Kjo është rreth katër herë më e lartë se mesatarja e vendit dhe më e larta ndër të gjitha rrethet e vendit.

Sipas ndarjes administrative të vitit 2000⁴, popullsia e qarkut është e përhapur në 3 rrethe, që përfshijnë 5 qytete, 20 komuna dhe 245 fshatra (shih tabelën 1.1). Më shumë se gjysma e saj banon në rrethin e Beratit (shih tabelën 1.2). Pjesa më e madhe e popullsisë, rreth 60%, banon në fshat, kundrejt rreth 58% në nivel vendi. Në rrethin e Kuçovës vihet re e kundërta, sepse në qytet banon rreth 51.2% e popullsisë. Sipas pjesës së popullsisë urbane, ky rreth renditet i katërtri në shkallë vendi, pas rrethit të Tiranës, Durrësit dhe Vlorës, në të cilët banojnë në qytet përkatësisht rreth 67.8%, 62.5% dhe 51.2% e popullsisë. Rreth 65% e popullsisë së qarkut është e moshës 15 deri 64 vjeç. Si rezultat Norma e Varësisë rezulton të jetë rreth 0.54⁵, kundrejt 0.58 në nivel vendi.

tabela 1.1 Ndarja administrativo-territoriale e qarkut

Rrethi	Bashki	Qytete	Komuna	Fshatra
Berat	2	2	10	122
Kuçovë	1	1	2	18
Skrapar	2	2	8	105
Qarku	5	5	20	245

Gjatë periudhës së tranzicionit qarku ka pësuar ndryshime thelbësore demografike. Popullsia është zvogëluar rreth 13.4% për shkak të migrimit jashtë dhe brenda vendit, duke e renditur Beratin të tretin në vend, pas qarkut të Kukësit dhe Dibrës. Dendësia e popullsisë është zvogëluar nga 124 banorë për km² në rreth 107 banorë për km². Ulja e dendësisë është shumë më e ndjeshme në rrethin e Skraparit.


⁴Ligji Nr. 8653, datë 31.07.2000, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

⁵Ky tregues shpreh raportin e popullsisë në moshë nën 15 vjeç dhe mbi 64 vjeç me popullsinë në moshë 15 deri 64 vjeç.

Fig. 1.1 Popullsia sipas rretheve



Fig 1.2 Popullsia ne qytet dhe ne fshat



Ka një diferencë të dukshme midis të dhënave administrative të zyrave lokale të gjendjes civile mbi popullsinë dhe të dhënave të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë të vitit 2001⁶. Sipas të dhënave administrative popullsia e qarkut është rreth 254,000 banorë. Kjo diferencë lidhet me vështirësitë e evidentimit në kohë të shpërnguljes së vazhdueshme të banorëve në qytetet e mëdha ose jashtë vendit.

Migrimi

Migrimi është një dukuri tipike e dhjetëvjeçarit të fundit për qarkun e Beratit, sikundër për shumicën e rajoneve të vendit. Gjatë kësaj periudhe popullsia është pakësuar më shumë në fshat, rreth 20% kundrejt vetëm 8% në zonën urbane, gjë që tregon se largimet nga qytetet janë kompensuar në një farë mase prej shpërnguljes së popullsisë nga fshati në zonat urbane brenda qarkut. Për nga zvogëlimi i numrit të banorëve në periudhën 1989-2001, rrethi i Skraparit renditet i pari në qarkun e Beratit dhe i katërti në shkallë vendi me rreth 36% të popullsisë të larguar jashtë rrethit (shih tabelën 1.3), pas Delvinës, Sarandës dhe Tropojës, ku popullsia është zvogëluar përkatesisht rreth 54%, 46% dhe 37%.

⁶Kjo strategji bazohet në të dhënat zyrtare të regjistrimit të popullsisë.



tabela 1.2 **Popullsia sipas rretheve**

Nr.	Rrethi	Popullsia gjithsej	Urbane		Rurale		Banorë për km ²
			Gjithsej	Popullsia aktive	Gjithsej	Popullsia aktive	
1	Berat	127,837	45,572	25,400	82,265	39,678	136.10
2	Kuçovë	35,338	18,038	8,822	17,300	7,377	420.20
3	Skrapar	29,845	13,257	6,770	16,588	8,547	38.50
	Qarku	193,020	76,867	40,992	116,153	55,602	107.30

Burimi: Repoba 2001

Pjesa më e madhe e popullsisë së larguar është vendosur në Tiranë, Fier e Durrës dhe përfaqëson përkatësisht rreth 34%, 23% dhe 17%. Kjo shpërngulje ka qenë më e shumtë pas ngjarjeve të vitit 1997. Ardhjet në qarkun e Beratit nga pjesë të tjera të vendit kanë qenë shumë të pakta. Popullsia e ardhur gjatë dhjetëvjeçarit të fundit përfaqëson vetëm rreth 1.9% të popullsisë rezidente të qarkut.

tabela 1.3 **Popullsia sipas rretheve në vitin 1989**

Nr	Rrethi	Popullsia në vitin 1989 ⁷	Banorë për km ² 1989	Ndryshimi i popullsisë 1989/2001 ne %
1	Berat	136,461	124.00	-6.32
2	Kuçovë	39,937	475.40	-11.52
3	Skrapar	46,503	60.00	-35.82
	Gjithsej	222,901	124.00	-13.4

1.2 Të ardhurat në zonën urbane

Tregu i punës

Popullsia aktive e qarkut të Beratit aktualisht zë rreth 50% të popullsisë gjithsej të qarkut. E ndikuar nga emigrimi dhe shpërnguljet, popullsia aktive është ulur rreth 27% në krahasim me vitin 1989. Kjo ulje vihet re si në zonat urbane ashtu edhe në fshat. Pakësimi më i madh i forcave të punës është në rrethin e Skraparit, ku popullsia aktive është zvogëluar rreth 33% në qytet dhe rreth 49% në fshat dhe kjo lidhet me zvogëlimin më të madh të popullsisë në këtë rreth.

Një pjesë e madhe e forcave të punës të qarkut është e zënë me punë në sektorin privat bujqësor (shih tabelën 1.4 dhe 1.5). Kjo përfaqëson rreth 48% të popullsisë aktive dhe rreth 63% të të punësuarve gjithsej. Në rrethin e Beratit dhe Skraparit, ky është sektori mbizotërues i punësimit, me përkatësisht 64% dhe 58% të të punësuarve. Në rrethin e Kuçovës, pjesa e popullsisë që punon në bujqësi është më e vogël, rreth 48% e të punësuarve, për shkak të një shkallë më të lartë urbanizimi në krahasim me rrethet e tjera të qarkut.

⁷INSTAT, Vjetari Statistikor 1991.

tabela 1.4 Treguesit kryesorë të tregut të punës sipas rretheve

Treguesi	Berat	Kuçovë	Skrapar	Qarku	Vendi
Forca e punës	62,918	16,199	15,317	96,594	1,347,300
Punësimi	51,431	12,077	12,724	76,232	1,041,800
Papunësia %	18.3	25.4	16.9	19.3	22.7

Burimi: HDPC mbështetur në të dhënat e Repoba 2001

Rreth 20% e të punësuarve janë zënë me punë në sektorin shtetëror dhe shumica e tyre në arsim dhe shëndetësi. Ndërsa pjesa e popullsisë e punësuar në sektorin privat jo bujqësor vazhdon të jetë e vogël. Në fund të vitit 2002 aty ishin të zënë me punë vetëm rreth 7% e të punësuarve gjithsej të qarkut ose vetëm rreth 15% e të punësuarve gjithsej të qyteteve. Kjo strukturë punësimi është mjaft e ndryshme nga ajo në shkallë vendi, sipas të cilës në fund të vitit 2002, rreth 56% e të punësuarve gjithsej janë zënë me punë në bujqësi, rreth 23% në sektorin privat jo bujqësor dhe rreth 21% në sektorin shtetëror⁸.

tabela 1.5 Treguesit e punësimit në qytetet kryesore

Qyteti	Popullsia aktive		Të punësuar		Të papunë		Shkalla e papunësisë në qytet %	
	Gjithsej	Femra %	Gjithsej	Femra %	Gjithsej	Femra %	Gjithsej	Femra
1 Berat	22,558	47.0	14,517	38.7	8,041	61.8	35.6	46.9
2 Ura Vajgurore	2,842	46.5	1,614	39.4	1,228	66.8	43.2	62.2
3 Kuçovë	8,822	47.3	5,572	37.5	3,250	63.9	36.9	49.8
4 Çorovodë	3,152	44.2	2,179	34.8	1,017	64.2	32.3	46.2
5 Poliçan	3,618	47.4	2,502	42.2	1,116	59.1	30.8	38.4
Gjithsej	40,992	46.8	26,384	38.58	14,652	62.7	35.7	45.7

Burimi: Repoba 2001

Kjo strukturë punësimi tregon zhvillimin e paktë të sektorit privat në zonën urbane, jo thjesht nga numri gjithsej i subjekteve private, por në radhë të parë nga numri i paktë i subjekteve prodhuese. Në qarkun e Beratit janë aktive 2,643 subjekte private të regjistruara, nga të cilat 2,524 u përkasin sektorëve jo bujqësorë (shih tabelën 1.6). Shumica dërrmuese e tyre janë ndërmarrje të vogla, me numër shumë të kufizuar punonjësish dhe me të ardhura të pakta. Numri i ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari prodhuese është, gjithashtu, shumë i vogël. Kështu, vetëm rreth 13% e ndërmarrjeve rezultojnë me një qarkullim vjetor mbi 8 milion lekë, shumica e tyre janë ndërmarrje ndërtimi dhe vetëm rreth 15% e tyre ushtrojnë veprimtari prodhuese. Midis ndërmarrjeve me qarkullim vjetor më pak se 8 milion lekë, mbizotërojnë ato të transportit, tregtisë dhe shërbimeve, ndërsa vetëm rreth 8% e tyre ushtrojnë veprimtari prodhuese.

⁸INSTAT, Tregu i punës 2002.



tabela 1.6 Numri i subjekteve private aktive në tetor 2003

Rrethi	Numri i subjekteve në sektorët jo bujqësorë						Gjithsej
	industri	ndërtim	transport	tregti	shërbime	Të tjera	
Berat	160	70	217	669	552	11	1,679
Kuçovë	44	18	53	211	198	-	524
Skrapar	33	25	24	190	49	-	321
Qarku	237	113	294	1070	799	11	2,524

Burimi: Agjencia Rajonale e Zhvillimit, Berat

Midis subjekteve të regjistruara mbizotërojnë ato me kapital vendas. Vetëm 8 subjekte janë me kapital të huaj dhe 3 subjekte me kapital të përbashkët. Këto subjekte ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Berat, ndërsa në Skrapar dhe në Kuçovë nuk ka asnjë investim të huaj.

Kjo strukturë punësimi është, gjithashtu, një pasojë e drejtpërdrejtë e tranzicionit. Deri në vitin 1990, ndërmarrjet më të mëdha të qakut ishin të përqendruara në rrethin e Beratit, ku mbizotëronte industria tekstile, dhe në rrethin e Kuçovës⁹, që dallohej për industrinë e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës. Kuçova është një rajon me vendburime naftë e gazi me një fond prej 1,700 puseh dhe deri më sot janë shfrytëzuar vetëm rreth 5% e rezervave gjeologjike dhe rreth 32% e rezervave industriale. Në fund të vitit 1990, në 13 ndërmarrjet kryesore të qarkut ishin të punësuar rreth 22,700 punonjës (shih tabelën 1.7), të cilët përfaqësonin rreth 54% të numrit të punonjësve gjithsej të sektorit shtetëror të rrethit.

tabela 1.7 Punësimi në disa ndërmarrje kryesore të qarkut


Nr.	Ndërmarrja	Numri i punonjësve	
		1990	2003
1	Kombinati i tekstit	8,063	180
2	Uzina mekanike e tekstit	664	-
3	Ndërmarrja ushqimore	1,012	-
4	NTAN	841	-
5	NB Berat	3,360	-
6	SMT	887	-
7	Uzina e përpunimit të naftës	670	-
8	Uzina mekanike e naftës	1,435	272
9	Ndërmarrja e shpim-kërkimit	718	221
10	Ndërmarrja e nxjerrjes së naftës	921	450
11	NB Kuçovë	1,968	-
12	NB Skrapar	1,392	-
13	Ndërmarrja e grumbullimit	730	-
	Shuma	22,661	1,123

Burimi: HDPC

⁹Në këtë periudhë Berati dhe Kuçova ishin së bashku në rrethin e Beratit.

Pas vitit 1990, shumica e ndërmarrjeve industriale ekzistuese nuk mundën të mbijetonin, për shkak të teknologjive të vjetruara, efektivitetit mjaft të ulët dhe konkurrencës së lartë të produkteve të importuara. Ato ndërprejnë punën dhe u përfshinë në procesin e ristrukturimit apo privatizimit, por vetëm një pjesë e vogël e tyre e rifilloi punën dhe me kapacitete prodhimi mjaft të reduktuara, duke bërë njëkohësisht shkurtime drastike të punonjësve. Kështu, në 13 ndërmarrjet kryesore të vitit 1990, aktualisht janë mbajtur në punë vetëm 4% e numrit të mëparshëm të punonjësve, të cilët përfaqësojnë vetëm rreth 2% të forcave të punës në vitin 2003. Nga ky këndvështrim, qarku i Beratit në përgjithësi dhe rrethi i Beratit e i Kuçovës në veçanti, mund të renditen midis rajoneve me pasoja të rënda nga reformat e tranzicionit.

Fig 1.3 Punësimi në ndërmarrjet kryesore të qarkut të Beratit



Aktualisht në 5 qytetet e qarkut deklarohen të punësuar rreth 26,400 punonjës, të cilët përfaqësojnë rreth 64% të popullsisë aktive të qyteteve (shih tabelën 1.8). Rreth 71% e tyre janë të punësuar në punë të përhershme, që do të thotë se në qytet është e punësuar në një punë të përhershme më pak se gjysma e popullsisë aktive. Pjesa tjetër janë të punësuar në punë të përkohshme, sezonale, të rastit ose janë të papunë.

tabela 1.8 Lloji i punësimit

	Qyteti	Të punësuar gjithsej	Nga këto, në punë							
			Të përhershme		Të përkohshme		Sezonale		Të rastit	
			Gjithsej	%	Gjithsej	%	Gjithsej	%	Gjithsej	%
1	Berat	14,517	9,594	66.1	2,289	15.8	1,899	13.1	735	5.1
2	Ura Vajgurore	1,614	1,121	69.5	210	13	207	12.8	76	4.7
3	Kuçovë	5,572	4,344	78.0	641	11.5	383	6.9	204	3.7
4	Çorovodë	2,179	1,710	78.5	224	10.3	160	7.3	85	3.9
5	Poliçan	2,502	1,928	77.1	320	12.8	162	6.5	92	3.7
	Shuma	26,384	18,697	70.9	3,684	14.0	2,811	10.7	1,192	4.5

Burimi: Repoba 2001

Papunësia

Numri i të papunëve në qarkun e Beratit dhe veçanërisht në zonën urbane është i konsiderueshëm (shih tabelën 1.4 dhe 1.5). Në 5 qytetet e qarkut numri i të papunëve sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2001 rezulton të jetë 14,652. Sipas këtyre të dhënave, shkalla e papunësisë në nivel qarku është 19.3%, ndërsa e llogaritur vetëm për zonën urbane është rreth 35.7%, me vlera shumë të larta në qytetin e Kuçovës, Beratit dhe Çorovodës (shih tabelën 1.5). Rreth 41% e të papunëve janë kryefamiljarë.

Sipas të dhënave administrative të Drejtorisë Rajonale të Punësimit, në fund të muajit tetor 2003, në zonën urbane figurojnë të regjistruar 12,238 punëkërkuar të papunë (shih tabelën 1.9) apo rreth 83% e të papunëve të zonës urbane.


Më se 80% e të papunëve janë të moshës mbi 25 vjeç dhe kjo është edhe grupmosha që ka interesin më të madh për punë. Këta janë punonjës të mbetur pa punë nga tranzicioni dhe të rinj që kanë mbaruar shkollat 8-vjeçare ose të mesme pas vitit 1991. Kjo kategori përfshijet të përshtatet me tregun e punës kryesisht nëpërmjet përfshirjes në kurset e formimit profesional publikë apo privatë. Te rinjtë e grupmoshës 15-24 vjeç përbëjnë vetëm 15% të totalit të punëkërkuarve të papunë të regjistruar. Përfshirja në rrethi i Kuçovës, ku rreth 30% e të papunëve janë të moshës 20-25 vjeç. Kjo kategori ka më shumë nevojë për këshillim dhe informim nga zyrat e punësimit.

tabela 1.9 Punëkërkuar të papunë të regjistruar në shtator 2003

	Rrethi	Gjithsej	Sipas grupmoshave				Sipas nivelit arsimor			
			15-19	20-24	25-34	mbi 34	8vjeçar	i mesëm	profesional	i lartë
1	Berat	6,182	252	384	1,828	3,718	4,431	841	882	28
2	Kuçovë	2,432	53	765	201	819	506	946	960	20
3	Skrapar	3,624	137	281	1,249	1,957	1,724	1,255	609	36
	Qarku	12,238	442	1,430	3,278	6,494	6,661	3,042	2,451	84

Burimi: Drejtoria Rajonale e Punësimit

Fig 1.4 Te papunët sipas rretheve



Në strukturën e të papunëve sipas nivelit arsimor, vendin kryesor, rreth 54%, e zënë punëkërkuarit me arsim tetëvjeçar. Në Berat këta përfaqësojnë rreth 71% të të papunëve. Ky grup është edhe kontingjenti më i pakualifikuar. Punëkërkuarit me arsim të mesëm profesional përbëjnë vetëm 20% të numrit të përgjithshëm të punëkërkuarve. Ky grup zë edhe përqindjen më të lartë të punësimit çdo muaj. Përfundimisht në rrethin e Kuçovës, ku shumica e të papunëve janë me arsim të mesëm. Punëkërkuarit e papunë me arsim të lartë janë shumë të paktë.

Struktura e punëkërkuarve të papunë, sipas kohës që qëndrojnë të regjistruar pranë zyrave të punësimit, dëshmon për mbizotërimin absolut të të papunëve afatgjatë dhe të tillë konsiderohen ata që figurojnë të regjistruar pranë zyrës së punësimit prej më shumë se një vit. Shumicën e tyre e përbëjnë të papunët e moshës mbi 45 vjeç, të cilët paraqesin vështirësitë më të mëdha në punësim, për shkak se nuk kanë profesionin apo formimin e duhur për t'iu përgjigjur kërkesave të reja të tregut të punës.

Analiza e treguesve të tregut të punës si në nivel qarku ashtu edhe për secilin rreth tregon një shkallë të ulët punësimi por edhe mundësi shumë të pakta punësimi nga sektori privat. Sipas të dhënave administrative, numri i të punësuarve gjatë vitit 2002 është 745 veta, shumica e të cilëve janë punësuar në Berat. Ritmet më të ulëta të punësimit janë në Kuçovë, ku gjatë vitit 2002 janë punësuar vetëm 53 veta nga rreth 3,250 veta të deklaruar si të papunë. Ndërkohë, numri i vendeve të lira të shpallura është tepër i kufizuar: gjithsej 109, nga të cilët 100 në rrethin e Beratit për punëtorë shërbimesh dhe shitës.

Të gjitha të dhënat e mësipërme tregojnë qartë se niveli i përshtatjes së forcave të punës me tregun e punës në përgjithësi është i ulët. Këtu ndikon fakti se kualifikimi i forcave të punës të moshës mbi 35 vjeç nuk u përgjigjet siç duhet kërkesave të reja të biznesit, veçanërisht për disa profesione “të reja”, si dhe fakti që rreth 44% e të papunëve janë pa profesion ose fillestarë. Edhe struktura e kurseve të autorizuara të formimit profesional në secilin rreth tregon mundësi të pakta të përshtatjes së punëkërkuarve të papunë me tregun e punës¹⁰.

tabela 1.10 Ndhimja ekonomike në zonën urbane në vitin 2002

Rrethi	Familje përfituese të ndihmës ekonomike në %	Pagesamesatare mujore nga ndihma ekonomike lekë
Berat	26	3,055
Ura Vajgurore	15	2,776
Kuçovë	21	2,679
Çorovodë	25	3,105
Poliçan	26	2,790
Gjithsej	23	2,948

Burimi: Zyra Rajonale e Përkrahjes Sociale

¹⁰Një trajtim më i hollësishëm i gjendjes së formimit profesional është bërë në kapitullin e dytë të këtij dokumenti.



Në zonën urbane të qarkut të Beratit pëfitojnë pagesën e ndihmës ekonomike rreth 23% e familjeve dhe pagesa mesatare që ato marrin është rreth 2,950 lekë në muaj (shih tabelën 1.10). Kjo do të thotë se rreth 26% e popullsisë urbane të qarkut mund të konsiderohet se ka si burim të rëndësishëm jetese një pagesë prej rreth 755 lekë në muaj për person. Në rrethin e Beratit kjo përfaqëson rreth 28% të popullsisë urbane, në Skrapar rreth 25% dhe në Kuçovë rreth 20%.

Sipas ligjit nr. 7710, datë 18.05.1993, shteti u ofron ndihmë ekonomike familjeve të shtetasve të cilëve u mungojnë të ardhurat dhe mjetet e jetesës krejtësisht ose i kanë ato të pamjaftueshme. Familje pa të ardhura konsiderohen ato që nuk kanë të ardhura e burime materiale nga veprimtaria ekonomike, sigurimet shoqërore ose nga kapitali. Ndihma është e plotë, për rastet kur të ardhurat mungojnë krejtësisht, dhe e pjesshme, kur plotëson të ardhurat e pamjaftueshme. Përfituesit dhe masa e ndihmës ekonomike përcaktohen nga Këshilli Bashkiak ose i Komunës.

tabela 1.11 Investimet gjithsej sipas viteve

Në mijë lekë

	Rrethi	1998-2000	2001	2002	2003 ¹¹
1	Berat	515,541	404,203	379,884	592,295
2	Kuçovë	224,522	166,610	114,671	126,074
3	Skrapar	387,260	320,253	248,565	636,518
	Gjithsej	1,127,323	891,066	743,122	1,354,887

Burimi: Këshilli i Qarkut

Investimet publike në qarkun e Beratit janë rritur ndjeshëm duke filluar nga viti 2001 dhe kjo është bërë e mundur kryesisht nga rritja e financimeve nga buxheti i shtetit. Në vitin 2002 është investuar në rikonstruksionin e tri shkollave të mesme, në ndërtimin e dy shkollave 8-vjeçare dhe të një kopshti fëmijësh, si dhe në rehabilitimin ose asfaltimin e 6 rrugëve, në 14 projekte të ndërtimit të ujësjellësve e kanalizimeve dhe në 5 projekte rehabilitimi veprash ujitëse. Investimet e vitit 2003 janë rreth 1.8 herë më të mëdha se ato të vitit 2002 dhe më të mëdha se investimet gjithsej të periudhës 1998-2000 (shih tabelën 1.11). Rreth 90% e tyre janë financime të buxhetit të shtetit. Vihet re se kjo rritje është shumë e madhe për rrethin e Skraparit dhe shumë më e vogël për rrethin e Kuçovës.

1.3 Tendencat e zhvillimit të fermave private

Qarku i Beratit zotëron një fond toke prej 178,485 ha. gjithsej, nga e cila rreth 30% është tokë bujqësore, 47% janë pyje e kullota dhe pjesa tjetër është tokë e papërdorshme. Në shkallë qarku sipërfaqja e tokës së ndarë bujqësore për familje në zonën rurale është 1.54 ha (shih tabelën 1.12). Kjo vlerë është më e vogël në rrethin e Kuçovës dhe më e madhe në rrethin e Skraparit. Në shumicën e komunave të qarkut sipërfaqja e tokës për çdo familje është 1 deri në 2 ha dhe vetëm në 6 komuna është më shumë se 2 ha për familje.

¹¹Parashikim

tabela 1.12 Sipërfaqja e tokës bujqësore të ndarë për familje

	Rrethi	Sipërfaqja mesatare e tokës për familje në ha	Numri i komunave me			
			Deri 1ha/familje	1-2 ha/familje	2.01-3 ha/familje	Mbi 3 ha/familje
1	Berat	1.52	-	8	1	1
2	Kuçovë	1.19	1	1	-	-
3	Skrapar	2.00	-	4	4	-
	Qarku	1.54	1	13	5	1

Burimi: Drejtoritë e Bujqësisë, 2002

Tradicionalisht drithërat kanë zënë pjesën më të madhe të prodhimit bujqësor të qarkut të Beratit. Por, pas vitit 1992, në të gjithë qarkun, sipërfaqja e mbjellë me drithëra është zvogëluar nga viti në vit sepse: (i) toka është e copëzuar në ngastra të vogla; (ii) mundësitë e mekanizimit janë mjaft të kufizuara si nga madhësia e parcelave ashtu edhe nga tarifat e larta të punimit të tokës me mjete mekanike, ku ndikon edhe numri mjaft i vogël i mjeteve në rrethin e Skraparit; (iii) shkalla e përdorimit të imputeve bujqësore është mjaft e ulët, sepse çmimet e plehrave kimike, farnave etj. janë të larta krahasuar me nivelin ekonomik të fermerëve; (iv) aftësia ujitëse është mjaft e ulët si rezultat i mosfunksionimit dhe dëmtimit të sistemeve ekzistues të ujitjes; (v) largësia nga qendrat urbane është e madhe dhe mundësia e daljes në treg shumë e vogël për shkak të mungesës thujse të plotë të rrugëve. Për të gjitha këto arsye kostoja e prodhimit të drithërave dhe perimeve është më e lartë, aq sa në shumë raste e kalon edhe çmimin e shitjes së tyre në treg.

Rrethi i Skraparit

Rrethi i Skraparit ka rreth 12,100 ha tokë bujqësore, nga e cila rreth 7,200 ha e ndarë. Nga ndarja e tokës janë krijuar ferma private me sipërfaqe të vogël toke, mesatarisht 2 ha për familje dhe kjo e copëzuar në 5 e me shumë parcela brenda fermës. Megjithëse kjo sipërfaqe është më e madhe se mesatarja e dy rrethëve të tjera të qarkut, prodhimi bujqësor është më i vogël, sepse cilësia e tokës është e ulët. Relievi është kodrinoro-malor me lartësi nga 250 m në Bogovë deri në 1500 m në Faqe-kuq dhe Backë. Përgjithësisht fshatrat janë të vendosura në lartësitë 750-850 m mbi nivelin e detit, e cila përkon me lartësinë mesatare të rrethit. Klima karakterizohet nga pranvera e hershme, vera e thatë dhe vjeshta e dimri mesatarisht të lagësht, të shoqëruara me borë e ngrica në një pjesë të rrethit. Këta faktorë kanë përcaktuar tendencat

e reja të zhvillimit të fermave private të rrethit, të ardhurat e të cilave, veçanërisht pas vitit 1997, po dominohen gjithnjë e më qartë nga frutikultura, vreshtaria dhe blegtoria.

Sipërfaqja e mbjellë me drithëra në rrethin e Skraparit është zvogëluar çdo vit. Kështu, në vitin 2002 u mbollën 2,150 ha nga 2,990 ha në vitin 2000. Megjithatë, në shkallë rrethi kjo përfaqëson rreth 30% të tokës bujqësore të ndarë. Përdorimi kryesor i drithërave ka filluar të jetë ushqimi i blegtorisë dhe përdorimi për prodhimin e bukës ka mbetur vetëm në disa fshatra të largëta.

Sipërfaqja e mbjellë me perime është e vogël, rreth 100 ha, dhe pothuajse nuk ka ndryshuar vitet e fundit. Perimet prodhohen për konsum familjar, me përjashtim të disa fshatrave përreth qyteteve të Çorovodës dhe Poliçanit, të cilat prodhojnë edhe për t'i shitur prodhimet në këto qytete. Gjendja është e ngjashme edhe për kultivimin e patates dhe fasules. Arsyet kryesore lidhen me faktin se shumica e fshatrave nuk kanë dalje në treg për të shitur prodhimet; kostoja e prodhimit është e lartë për shkak të faktorëve klimatikë dhe mungojnë fabrikat e përpunimit të perimeve.

Zhvillimi i vreshtarisë është karakterizuar nga rehabilitimi i vreshtave të degraduara ekzistuese dhe mbjellja e vreshtave të reja me teknologji bashkëkohore dhe me varietete të zgjedhura, ku mbizotërojnë ato për prodhim industrial të verës dhe rakisë. Aktualisht ka rreth 119 ha vreshta dhe parashikohet një rritje vjetore e sipërfaqes prej rreth 30 ha çdo vit. Vihet re, gjithashtu, një rritje e madhe e prodhimit të rrushit nga pjergullat: në vitin 2002 u prodhuan rreth 1620 ton dhe parashikohet që në vitin 2005 prodhimi të arrijë në rreth 3000 ton. Zhvillimi i shpejtë i vreshtarisë nxitet nga faktorë të tillë, si hyrja e shpejtë në prodhim e sipërfaqeve të mbjella, që garanton shlyerjen e shpejtë të investimit; të ardhurat e larta për njësi sipërfaqeje krahasuar me prodhimet e tjera dhe kostoja e ulët; dhe siguria për tregun e shitjes sepse ka disa fabrika përpunimi.

Baza e zhvillimit të blegtorisë është mbarështimi i bagëtive të imëta, dheneve dhe dhive në tufa të mëdha që shkojnë deri në 200-400 krerë, si dhe fermat me 2-5 krerë lopë. Këto favorizohen nga kullotat e bollshme e cilësore, tradita e fermerëve dhe fitimi i kënaqshëm. Rritja e prodhimit blegtoral do të lidhet jo aq me rritjen e numrit të krerëve sesa me përmirësimin cilësor të tufave. Kjo do të shoqërohet me rritjen e sipërfaqes së mbjellë me foragjere, sidomos me jonxhë.

Rrethi i Kuçovës

Rrethi i Kuçovës ka rreth 5,500 ha tokë bujqësore, nga e cila rreth 4,600 ha e ndarë. Sipërfaqja mesatare e tokës bujqësore për familje është më e vogël se e rrethëve të tjera të qarkut. Komuna e Perondisë ka më pak tokë bujqësore për familje se të gjitha komunat e qarkut. Rreth 65% e sipërfaqes është reliev kodrinor dhe pjesa tjetër është fushë. Në vitet e fundit, prodhimi bujqësor e blegtoral përgjithësisht është rritur, me një tendencë të qartë rritjeje veçanërisht për vreshtarinë, ullishtat, frutikulturën, perimet dhe blegtorinë. Sipërfaqja e mbjellë me drithëra është zvogëluar me ngadalësi nga viti në vit. Kështu, në vitin 2002 u

mbollën rreth 1,600 ha nga rreth 1,750 ha në vitin 2000. Megjithatë, në shkallë rrethi kjo përfaqëson rreth 35% të tokës bujqësore të ndarë. Ky zvogëlim është bërë për llogari të rritjes së sipërfaqes së mbjellë me dru frutorë, ullishta e vreshta. Sipërfaqja e mbjellë me perime pothuajse nuk ka ndryshuar, por është rritur dukshëm sipërfaqja dhe prodhimi i perimeve në serra, i cili ka filluar të eksportohet.

Baza e zhvillimit të blegtorisë është gjedhi. Vitet e fundit, megjithëse numri i krerëve të lopëve nuk është rritur, vihet re tendenca e krijimit të tufave me 10-30 krerë për prodhim qumështi dhe mishi, si dhe e përmirësimit racor dhe e mbarështimit. Tradicionale për rrethin e Kuçoves është edhe rritja e gjelit të detit, që ka arritur deri në rreth 30,000 krerë në vit.

Rrethi i Beratit

Rrethi i Beratit ka rreth 35,700 ha tokë bujqësore, nga e cila rreth 26,700 ha e ndarë. Sipërfaqja e mbjellë me drithëra zë rreth 54% të sipërfaqes së mbjellë gjithsej. Sigurimi i bukës, mundësitë ende të pakta financiare për të investuar në pemëtari e ullinj dhe mungesa e tregut për kulturën e duhanit dhe lulediellit janë arsyt më kryesore të këtij mbizotërimi. Ulliri zë aktualisht rreth 11% të sipërfaqes dhe ritmet e rritjes së sipërfaqes së mbjellë me ullinj gjatë dy viteve të fundit janë rreth 50 ha në vit, duke u shtrirë gati në të gjithë zonën kodrinore, si edhe në një pjesë të zonës fushore.

Pemëtaria dhe vreshtaria janë zhvilluar me ritme të shpejta, duke pasur si bazë prodhimin tradicional të pemëve frutore dhe rrushit. Ritmet e mbjelljeve të pemëve frutore janë mesatarisht rreth 30 ha në vit dhe të vreshtit rreth 25 ha në vit. Në shumë zona mbizotërojnë fiku¹² dhe qershia, por kapacitetet përpunuese për këto prodhime vazhdojnë të jenë mjaft të kufizuara dhe mundësitë e tregtimit shumë të pakta.

Baza e zhvillimit të blegtorisë edhe për rrethin e Beratit është gjedhi dhe vihen re prirje të qarta të shtimit numerik dhe të përmirësimit racor për prodhim qumështi dhe mishi. Vihet re, gjithashtu, rritje e numrit të krerëve të bagëtive të imëta, kryesisht dhenvë, dhe synimi për të krijuar tufa të mëdha e futur raca të përmirësuara, me prodhimtari të lartë qumështi, mishi e leshi.

1.4 Të ardhurat në zonën rurale

Të ardhurat nga fermat

Llogaritja e të ardhurave nga fermat për vitin 2002 është bërë për çdo komunë, duke marrë parasysh prodhimin bujqësor e blegtoral, prodhimet nga frutikultura, si dhe prodhime të tjera të veçanta për çdo komunë¹³. Klasifikimi i komunave sipas të ardhurave mesatare për frymë nga

¹²Fiku «Roshnik» është një nga prodhimet më tradicionale të Beratit për tregun vendas dhe për eksport. Rreth 110,000 rrënjë fiq kultivohen në blloqe në një sipërfaqe prej rreth 900 ha.

¹³Të dhënat mbështeten në regjistrin statistikor të dalë nga evidencat e specialistëve të bujqësisë, në studimet zoostatistikore dhe inventarizimet e kryera, si dhe në intervistat me fermerët e kontaktit. Të ardhurat bruto janë llogaritur me çmimet mesatare të vitit 2002, për çdo komunë e për çdo prodhim. Shpenzimet janë llogaritur me modele planesh biznesi për çdo kulturë e kategori toke bujqësore dhe për çdo prodhim blegtoral.



fermat paraqitet në figurën 1.5. Dallohet qartë se shumica e komunave të rrethit të Skraparit kanë të ardhura më të ulta nga fermat në krahasim me komunat e tjera të qarkut. Krahas sipërfaqes së vogël të tokës bujqësore për familje, një ndikim të madh në këtë nivel të ardhurash ka edhe cilësia e ulët e tokës bujqësore. Sipërfaqja nën ujë, sidomos në tokat e pjerrëta, është shumë e vogël dhe investimet për ndërtimin apo rehabilitimin e veprave ujitëse janë shumë të pakta. Aktualisht në nivel qarku vetëm rreth 37% e tokës së kultivuar është e ujitshme. Në rrethin e Kuçovës ky tregues është rreth 80%, ndërsa në atë të Skraparit vetëm 20%. Edhe sipërfaqja potencialisht e ujitshme e këtij rrethi është mjaft e vogël, vetëm rreth 32%, gjë që zbeh perspektivën për një përmirësim të rëndësishëm të prodhimit bujqësor në këtë rreth.

Emigracioni dhe dërgesat në të holla

Rreth 44% e familjeve të zonës rurale të qarkut të Beratit del se kanë të paktën një pjesëtar të tyre në emigracion të përhershëm ose sezonal. Në rrethin e Beratit këta përfaqësojnë rreth 58% të familjeve, ndërsa në dy rrethet e tjera rreth 40%. Pothuajse në të gjitha komunat mbizotëron emigracioni sezonal. Këta përgjithësisht punojnë 3-5 muaj në vit në vendet fqinje, ku shkojnë ilegalisht, dhe të ardhurat që sjellin janë të pakta, mesatarisht të nivelit 50 mijë lekë në vit, ku ndikon mjaft edhe fakti se kostot e këtij lloj emigrimi janë shumë të larta. Nevoja ekonomike quhet si arsyeja mbizotëruese e emigrimit. Përfaqësues të këtyre familjeve pohojnë se kjo është e vetmja zgjidhje për meshkujt dhe sidomos për të rinjtë për të punuar, sepse në fshat kanë shumë pak tokë.

Ndihma ekonomike

Në zonën rurale të qarkut të Beratit përfitojnë pagesën e ndihmës ekonomike rreth 24% e familjeve dhe pagesa mesatare që ato marrin është rreth 1,604 lekë në muaj (shih tabelën 1.13 dhe figurën 1.6). Kjo do të thotë se rreth 22% e popullsisë rurale të qarkut kanë si burim kryesor të jetesës një pagesë prej rreth 356 lekë në muaj për person. Në rrethin e Skraparit kjo përfaqëson rreth 40% të popullsisë rurale me pagesë mesatare rreth 450 lekë në muaj për person, në Berat rreth 20% dhe në Kuçovë rreth 14%. Pjesën më të madhe të popullsisë që përfiton pagesë të ndihmës ekonomike e kanë komunat Gjerrbës, Bogovë, Potom, Zhepë dhe Vendreshë të rrethit të Skraparit, ku kjo arrin nga 51% në 40% të popullsisë.

tabela 1.13 Ndihma ekonomike në zonën rurale

Rrethi	Familje përfituese të ndihmës ekonomike në %	Pagesa mesatare mujore nga ndihma ekonomike lekë
Berat	22	1,419
Kuçovë	14	1,578
Skrapar	40	2,078
Gjithsej	24	1,604

Burimi: Zyra Rajonale e Shërbimeve Sociale, 2002

Figura 1.5 | Shpërndarja e të ardhurave nga fermat





Figura 1.6 | Pjesa e popullsisë me ndihmë ekonomike



Të ardhurat mesatare për frymë

Të ardhurat mesatare për frymë për çdo komunë janë llogaritur duke marrë parasysh të ardhurat nga fermat për vitin 2002, të ardhurat e përafërta nga emigracioni dhe pagesën e ndihmës ekonomike (shih tabelat 1.14 dhe 1.15). Të ardhurat më të larta për frymë në ditë i ka komuna e Kozarës në rrethin e Kuçovës, ndërsa të ardhurat më të ulëta i kanë komunat e rrethit të Skraparit, ku mbizotërojnë tokat malore e të varfëra (shih figurën 1.7). Për nga të ardhurat mesatare për frymë, pesë komuna të rrethit të Skraparit mund të konsiderohen si ekstremisht të varfëra.

tabela 1.14 Të ardhurat mesatare në zonën rurale të qarkut

Rrethi	Numri i banorëve	Të ardhurat vjetore gjithsej (mijë lekë)	Të ardhura mesatare në leke për frymë në ditë
Berat	74,616	6,654,135	244.32
Kuçovë	17,300	1,502,512	237.94
Skrapar	16,467	908,094	151.80
Qarku	108,383	9,064,741	229.14

Burimi: Këshilli i Qarkut, 2003


Këto rezultate përkojnë dhe pjesërisht shpjegojnë lëvizjen e madhe të popullsisë në dhjetëvjeçarin e fundit në zonën rurale të rrethit të Skraparit (shih tabelën 1.3). Këto rezultate përkojnë, gjithashtu, me të dhënat mbi përdorimin e imputeve bujqësore. Kështu, në rrethin e Kuçovës përdoren rreth 4.8 kv/ha plehra kimikë, ndërsa në atë të Skraparit vetëm rreth 2 kv/ha.

tabela 1.15 Të ardhurat mesatare për frymë sipas komunave

Rrethi	Numri i komunave sipas të ardhurave mesatare			
	nën 130 lekë/ditë frymë	130-164 lekë/ditë frymë	165-200 lekë/ditë frymë	201-300 lekë/ditë frymë
Berat	-	-	-	10
Kuçovë	-	-	1	1
Skrapar	5	-	3	-
Qarku	5	-	4	11

Burimi: Këshilli i Qarkut, 2003

Figura 1.7 | Shpërndarja e të ardhurave gjithsej



1.5 Zhvillimi i qëndrueshëm i mjedisit natyror

Vizioni strategjik i zhvillimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, i përcaktuar nga konventat ndërkombëtare, mbështetet në parimet e qëndrueshmërisë mjedisore, ekonomike dhe shoqërore. Këto nënkuptojnë ruajtjen e biodiversitetit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësive të burimeve natyrore, shfrytëzimin afatgjatë për të nxjerrë përfitime ekonomike dhe garantimin e funksioneve publike nëpërmjet menaxhimit të qëndrueshëm e shumëfunksional të tyre.

Në mjedisin natyror të qarkut dallohen zona fushore e kodrinore e Beratit dhe Kuçovës, si pjesë të ultësirës bregdetare të vendit. Dallohen, gjithashtu, mali i Tomorit dhe Shpiragut, si dhe lugina e Osumit dhe Tomoricës, si pjesë të zonës malore jugore të vendit. Ndërsa zona fushore dhe kodrinore janë tashmë baza e zhvillimit të prodhimit bujqësor të qarkut, malet dhe luginat përfaqësojnë burime të mëdha pyjore, kullimore dhe hidrike ende të pavlerësuara si potenciale të rëndësishme zhvillimi ekonomik e mjedisor.

Mali i Tomorit është më tipiku për këto burime. Një sipërfaqe e kufizuar e tij prej 4,000 ha është shpallur Park Kombëtar¹⁴, që për nga numri i vizitorëve renditet i dyti në vend, pas Parkut Kombëtar të Dajtit. Mali i Tomorit ka shtrirje të theksuar vertikale. Në shpatin perëndimor deri në lartësinë 500-600m shtrihet brezi i makjeve, duke u ngjitur në lartësinë 900-1000 m ato zëvendësohen nga dushku dhe më lart shtrihet brezi i ahut dhe halorëve, ku mbizotëron rrobulli. Ndërsa mali i Shpiragut përdoret kryesisht për kullotjen e të imtave. Rezervate natyrore janë shpallur, gjithashtu, një sipërfaqe prej 330 ha në rrethin e Beratit dhe 330 ha në Bogovë (rrethi i Skraparit)¹⁵.

Lugina e Osumit është, gjithashtu, e dëgjuar për kanionet rreth 150m të thella dhe 15-20m të gjera, ndërsa lugina e Tomoricës për një potencial mjaft të rëndësishëm ujqor. Ujërat sipërfaqësore dalin në formën e burimeve të fuqishme, ku dallohet burimi i Sotirës, i cili krijon edhe një ujëvarë të bukur dhe më tej një lumë të rrëmbyer.

Masat për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të këtyre burimeve natyrore mund të konsiderohen si fare të pamjaftueshme dhe nuk janë të përfshira ende në programet e ndërhyrjeve prioritare të zhvillimit, si në nivel vendi ashtu edhe në nivel qarku. Si rezultat, kushtet natyrore dhe malet e luginat, nga një burim i rëndësishëm të ardhurash, materiali drusor, kullotë, ujrash e turizmi, janë kthyer aktualisht në një burim përmbytjesh të tokës bujqësore dhe pengesash

¹⁴Parku Kombëtar i Tomorit është miratuar si Zonë e Mbrojtur e kategorisë së dytë në vitin 1996.

¹⁵Këto janë miratuar si Zona të Mbrojtura të kategorisë së katërtë në vitin 1983.

serioze për infrastrukturën rrugore. Tokat bujqësore në luginat e lumenjve dhe përrrenjve i janë nënshtruar erozionit masiv dhe rrëshqitjeve. Pas çdo sezoni reshjesh, toka bujqësore pakësohet dhe shtohen mbushjet dhe toka joproduhuese. Shkaku kryesor i shtimit të shpejtë të këtyre fenomeneve negative, më shumë se natyra e shkëmbinjve dhe vetitë fizike të tokës, janë degradimi dhe pakësimi në mënyre drastike i mbulesës pyjore e bimore në 10 vjeçarin e fundit, që ka ardhur si rezultat i: (i) prerjeve të pakontrolluara; (ii) kullotjes pas prerjes, duke hequr çdo mundësi për t'u rritur filizeria dhe (iii) zjarreve të vazhdueshme gjatë stinës së nxehtë e të thatë të verës.

Shpyllëzimet e bëra për hapjen e tokave të reja apo për krijimin e kullotave të kultivuara, si dhe prerjet e pandërprera të pyjeve për lëndë drusore, kullotja e vazhdueshme e gjësë së gjallë në shpatet e pjerrta pa asnjë rregull e kufizim, mungesa e praktikave të trajtimit të pyllit për ta përgatitur atë si kullotë, kanë sjellë degradim të mbi 60% të sipërfaqeve të tokave të pjerrëta të qarkut. Si rezultat vihet re degradim i tokës bujqësore dhe rënie e ndjeshme e aftësive prodhuese të saj. Në nivel qarku aktualisht ka rreth 40,000 ha toka të lëna djerr e të papërdorshme. Pjelloria e tokave të pjerrëta bujqësore ka pësuar rënie të theksuar nga humbja e shtresës aktive, mungesa e qarkullimit bujqësor dhe e plehërimit, veçanërisht pas vitit 1990.

Masat kryesore të parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social për sektorin e pyjeve janë: (i) vazhdimi i kalimit të pyjeve dhe kullotave në pronësi ose përdorim të komunave; (ii) përmirësimi i strukturave të menaxhimit dhe kontrollit të shfrytëzimit të pyjeve; (iii) fuqizimi i shërbimeve pyjore për rehabilitimin dhe mbrojtjen e pyjeve. Sipërfaqja e pyjeve e administruar nga komunat dhe sipërfaqja e ripyllëzuar janë parashikuar si tregues monitorimi në Matricën e Programit të Veprimeve Prioritare Afatmesme 2003-2006

Hapja e tokave të reja, dëmtimi dhe degradimi i pyjeve, mbipopullimi me kafshë bujqësore i pyjeve dhe shfrytëzimi i tyre pa asnjë kriter, kanë dëmtuar rëndë edhe biodiversitetin. Kjo ka sjellë degradimin e shpejtë të ekosistemeve, keqtrajtimin e kafshëve të egra, zhdukjen e specieve, dëmtimin dhe pakësimin e burimeve gjenetike. Kështu, ariu, që ka qënë i pranishëm deri në mes të shekullit të kaluar në malin e Tomorit, pothuajse është zhdukur. Po kështu edhe shumë kafshë të tjera, që popullonin rezervatin e gjuetisë së Bogovës. Shumë lloje drusore veçanërisht lisi, që ka qënë edhe përbërësi kryesor i pyjeve të Tërpanit, Vërtoptit e Gjerbësit, tani takohen rrallë e më rrallë e në formë shkurresh. Vendin e tyre e kanë zënë shqopa e mareja në zonën e ulët dhe lajthia e të tjera shkurre në zonën e lartë. Bimësia tipike si rrapë, verrini, shelgu e plepi, që duhet të veshë shtretërit e përrrenjve, haset gjithnjë e më rrallë dhe e copëzuar.

Megjithatë, pyjet dhe kullotat mbeten pasuria më e rëndësishme natyrore e qarkut të Beratit. Sipërfaqja e mbuluar me pyje dhe kullota është më e madhe se ajo e tokës bujqësore (shih tabelat

1.16 dhe 1.17). Ky ndryshim është veçanërisht i dukshëm në rrethin e Skraparit, në të cilin pyjet dhe kullotat zënë rreth 4 herë më shumë sipërfaqe se toka bujqësore. Por të ardhurat e zonës rurale vazhdojnë të bazohen më shumë te toka bujqësore, duke mos i konsideruar ende pyjet si një pasuri të madhe natyrore dhe burim i qëndrueshëm jetese. Në një përfundim të tillë mund të arrihet lehtë po të analizohen të ardhurat në zonën rurale të rrethit të Skraparit, ku ka rreth 1.49 ha pyje për frymë dhe vetëm rreth 0.5 ha tokë bujqësore për frymë.

tabela 1.16 **Pyjet dhe kullotat**

Rrethi	Fondi i tokës gjithsej ha	Tokë bujqësore ha	Tokë pyjore, kullotë, livadh ha	Sipërfaqja pyjore ha	Pyje ha/frymë	Të imëta për 1 ha pyll-kullotë
Berat	92,580	35,772.7	36,046	27,940	0.37	3.61
Kuçovë	8,410	5,503	1,211	780	0.05	
Skrapar	77,495	12,095	46,660	24,500	1.49	1.72
Qarku	178,485	53,370.7	83,917	53,220		2.50

Burimi: Këshilli i Qarkut, 2003

Numri i të imëtave për 1 ha pyll/kullotë në këtë rreth është dy herë më i vogël se në rrethin e Beratit, megjithëse në të dy rrethet ka mjaft zona ku ngarkesa me bagëti të imëta për njësi të sipërfaqes e tejkalon kapacitetin optimal mbajtës të pyllit. Mbingarkesa në të shumtën e rasteve shkaktohet nga mungesa e bazës ushqimore për periudhën e dimrit, kështu që në vend të mbajtjes së bagëtive në regjim stallor për 4-6 muaj, ato qëndrojnë pothuajse tërë dimrin në kullotë, duke përjashtuar ditët me borë e ngrica të forta, që përgjithësisht zënë më pak se 1 muaj.

tabela 1.17 **Sipërfaqet me pyje e kullota**

	Rrethi	Sipërfaqja me pyje e kullota në ha	Numri i komunave me			
			deri 2000 ha	Mbi 2000 deri 4000 ha	Mbi 4000 deri 6000 ha	Mbi 6000 ha
1	Berat	36,046	5	2	1	2
2	Kuçovë	1,211	2		-	
3	Skrapar	46,660	-	3	-	5
	Qarku	83,917	7	5	1	7

Burimi: Këshilli i Qarkut, 2003

1.6 Lidhja me rrugë

Nga pikëpamja e lidhjes me rrugë, qarku i Beratit mund të quhet se ka vetëm një dalje nëpërmjet rrugës kombëtare, që e lidh me qarkun e Fierit. Ndërsa lidhja e tij me qarkun e Elbasanit bëhet aktualisht nëpërmjet një rruge dytësore, që lidh Kuçovën me Cërrikun, me parametra teknikë të ulët dhe të pamirëmbajtur, ku nuk mund të lëvizet me shpejtësi më të mëdha se 25 km/orë. Të gjitha këto e kanë kufizuar trafikun në rreth 650 mjete në ditë, i cili parashikohet se mund të arrijë në vitin 2020 në rreth 2980 mjete në ditë. Ndërtimi i këtij segmenti rrugor do të krijonte mundësi për zhvillim më të shpejtë të qarkut, duke përmirësuar komunikimet me



Elbasanin, Korçën e Tiranën. Sipas një studimi zbatueshmërie¹⁶, janë përcaktuar disa mundësi për ndërtimin e këtij aksi rrugor, për të cilat kërkohet një investim nga rreth 900 milion lekë në rreth 1,056 milion lekë.

Rrjeti rrugor brenda qarkut të Beratit përbëhet nga rreth 930 km rrugë, nga të cilat 730 km janë rrugë rurale, të cilat realizojnë lidhjen e fshatrave me qendrat e komunave dhe të komunave me rrugët kombëtare. Gjendja e rrugëve rurale të qarkut është e keqe dhe në këtë rrjet mbizotërojnë rrugët e kategorive të ulëta. Shumica e tyre janë rrugë të pamirëmbajtura ose të kalueshme vetëm gjatë sezonit të verës, gjë që kufizon dukshëm daljen në treg të shumicës së fermerëve të qarkut. Mundësia e daljes në treg është më e paktë në komunat e rrethit të Skraparit. Komuna të tilla si Zhepa, Potomi, Gjerbësi, Çepani, Leshnja, Vendresha dhe Bogova janë komunat me mundësitë më të kufizuara për daljen në treg në të gjithë qarkun (shih tabelën 1.18)¹⁷. Këto janë, gjithashtu, komunat me të ardhurat më të vogla për frymë në qarkun e Beratit (shih figurën 1.5) dhe në përgjithësi komunat me më pak të ardhura kanë edhe kufizimet më të mëdha të daljes në treg.

tabela 1.18 **Mundësia e daljes në treg të fermerëve**

Rrethi	Komuna	Mundësia e daljes në treg në %
BERAT	Poshnje	71
	Velabisht	64
	Kutalli	75
	Cukalat	71
	Otlak	68
	Lumas	55
	Vërtop	68
	Sinjë	59
	Tërpan	52
	Roshnik	62
KUÇOVE	Kozarë	77
	Perondi	38
SKRAPAR	Qendër	57
	Bogovë	38
	Vendreshë	36
	Çepan	32
	Potom	28
	Leshnjë	34
	Gjerbës	31
	Zhepë	23

Burimi: Këshilli i Qarkut, 2003

¹⁶Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve, Tiranë, dhjetor 1999.

¹⁷Mundësia e daljes në treg shprehet me përqindjen e fermave që lidhen me zonën më të afërt urbane me rrugë të kalueshme gjithëvjetore. Rezultatet kanë dalë nga analiza e hollësishme e gjendjes së rrugëve lidhëse të çdo fshati të qarkut.

Pothuajse i gjithë rrjeti rrugor rural ka nevojë për investime. Por nevojat prioritare për të sjellë një përmirësim të dukshëm të lidhjes së fshatrave me tregun janë rreth 1,4 miliard lekë. Nga këto, rreth 1/3 mund të konsiderohen si më të domosdoshme për t'u realizuar në një periudhë afatmesme (shih tabelën 1.19 dhe figurën 1.8, 1.9 dhe 1.10)¹⁸.

tabela 1.19 Nevojat e përafërta për investime në rrjetin e rrugëve rurale

Rrethi	Prioriteti	Nevojat për investime		
		Numri i segmenteve	Gjatësia e përgjithshme në km.	Investimi i përafërt në milionë lekë
Berat	1	34	181	543
	2	13	78	195
	3	13	83	207
Kuçovë	1	5	21	63
	2	2	10	25
	3	3	10	25
Skrapar	1	46	164	492
	2	21	87	217
	3	18	66	165
Qarku	1	85	366	1,098
	2	36	175	437
	3	34	159	397

Burimi: Këshilli i Qarkut, 2003



¹⁸ Radha e investimeve për rrugët rurale mund të përcaktohet duke përdorur kritere shtesë prioritari të tilla si numri i familjeve në çdo fshat dhe prodhimin bujqësor e blegtoral, ose kritere të tjera më specifike.

Figura 1.8 | Investime prioritare në rrugët rurale-Rrethi Beratit



Figura 1.9 | Investime prioritare në rrugët rurale-Rrethi Kuçovës





Figura 1.10 | Investime prioritare në rrugët rurale-Rrethi Skraparit



1.7 Rrugët për rritjen e të ardhurave

Masat me përparësi për rritjen e të ardhurave të popullsisë në qarkun e Beratit lidhen kryesisht me rritjen e shkallës së punësimit në zonën urbane dhe rritjen e të ardhurave nga fermat në zonën rurale. Në këndvështrimin e Objektivave të Mijëvjeçarit për Zhvillimin dhe në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social, rëndësi të veçantë merr zbatimi i këtyre masave parësore:

Shfrytëzimi i vlerave turistike

Qarku i Beratit dallohet për një potencial të madh turistik ende të panxjerrë në pah e të pashfrytëzuar¹⁹. Vlerat më të veçanta turistike të tij lidhen me:

- **Qytetin muze të Beratit**, ku dallohet kështjella, në territorin e së cilës vazhdojnë të banojnë rreth 1000 banorë. Brenda saj ndodhen 14 kisha Bizantine dhe post-Bizantine të ruajtura me kujdes, të cilat trashëgojnë një dekoracion pikturash murale me shumë vlera. Poshtë kështjellës dallohen, gjithashtu, dy lagjet me banesa karakteristike Mangalem dhe Goricë me një strukturë dhe organizim që e ka filluesën në periudhën Osmane. Me interes të veçantë është edhe bërthama islamike e qytetit, ku dallohen veçanërisht tri xhamitë dhe dy teqete me piktura e dekoracione me vlera të mëdha artistike dhe historike. Prej këtyre vlerave të mëdha, qyteti i Beratit është shpallur qytet muze me vendim të Këshillit të Ministrave në vitin 1961 dhe për mbrojtjen e tij ekziston një rregullore e posaçme “Për mbrojtjen e qyteteve muze të Beratit dhe Gjirokastrës” e vitit 1981.
- **Parkun kombëtar të Tomorit**, me pyje, kullota, livadhe dhe terrene të thepisura shkëmbore, i cili dallohet për florën dhe faunën e shumëllojshme dhe mjaft të veçantë të tij si dhe për shumë monumente të natyrës (shih 1.5).
- **Kanionet e lumit Osum**, në afërsi të qytetit të Çorovodës.
- **Mjedise të tjera natyrore me florë dhe faunë shumë të pasur**, të tilla si pylli i lisave të malit të Bardhë në Velçan, fshati i Bogovës dhe masivi pyjor në komunën e Potomit.

Drejtimet strategjike për shfrytëzimin e këtyre burimeve janë: (i) Ruajtja dhe administrimi i vlerave ekzistuese historike, kulturore e natyrore, ku përparësi të veçantë kërkohet t’i jepet përfshirjes së qytetit të Beratit në listën e pasurive botërore nën mbrojtjen e UNESCO-s; (ii) Investimet publike e private për infrastrukturën rrugore, hotelieri dhe të turizmit familjar; (iii) Zhvillimi i një sistemi informacioni bashkëkohor për njohjen e vlerave turistike brenda dhe jashtë vendit; ; (iv) Hartimi i një modeli koncesioni për sipërmarrësit privatë që janë të interesuar të sigurojnë shërbime turistike dhe argëtuese në natyrë, apo që kanë interes për shtimin në rezervate të kafshëve të egra, që nxisin gjuetinë turistike dhe shtojnë numrin e vizitorëve. Zbatimi i këtyre masave do të ketë një ndikim të dukshëm në zhvillimin ekonomik të rajonit, nëpërmjet krijimit të vendeve të punës dhe krijimit të mundësive më të mëdha për përdorimin e prodhimeve të fermave private të rajonit.

¹⁹Një vështrim i plotë e i hollësishëm strategjik mbi vlerat turistike të qarkut të Beratit dhe rrugët e shfrytëzimit të tyre është përpunuar nga Zyra Rajonale e Turizmit pranë prefektit të Beratit në dokumentin “Zhvillimi i turizmit në qarkun e Beratit”, gusht 2003.



Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO) ka miratuar në nëntor të vitit 1972 Konventën «Për mbrojtjen e pasurive botërore kulturore e natyrore». Pasuri kulturore konsiderohen grupet e ndërtesave që, për shkak të arkitekturës dhe integritit në peizazhin natyror, kanë një vlerë universale të jashtëzakonshme nga pikëpamja e historisë, artit ose shkencës. Të tilla konsiderohen, gjithashtu, veprat arkitekturore, të skulpturës ose të pikturës monumentale, si dhe qendrat arkeologjike me vlera universale të jashtëzakonshme historike, estetike dhe etnologjike. Këtyre pasurive u garantohet mbrojtje në radhë të parë nga shteti që i ka, i cili duhet të angazhohet: (i) të zbatojë politika për mbrojtjen e tyre, duke i pasqyruar këto edhe në programet e zhvillimit të vendit; (ii) të ngrejë shërbime të posaçme për mbrojtjen e tyre; (iii) të realizojë studime dhe kërkime shkencore e teknike për të përballuar rreziqet që i kanosen; (iv) të ndërmarrë masat e nevojshme juridike, shkencore, teknike, administrative dhe financiare për mbrojtjen, konservimin, nxjerrjen në pah dhe gjallërimin e vlerave të tyre. Përfshirja e një pasurie në listën e pasurive botërore kulturore e natyrore vendoset nga Komiteti i Pasurive Botërore në bazë të propozimit zyrtar të shtetit të interesuar. Këtyre pasurive u garantohet, gjithashtu, mbrojtje ndërkombëtare, veçanërisht kur ato rrezikojnë të zhduken për shkak të degradimit të përsheptuar, ndërtimeve publike e private, zhvillimit të shpejtë urban e turistik, ndryshimit të pronësisë, braktisjes, zjarreve etj. Në këto raste ky Komitet i përfshin në listën e pasurive botërore në rrezik në bazë të argumenteve që paraqet zyrtarisht shteti i interesuar. Vlerat e jashtëzakonshme të qytetit të Beratit përqasen dukshëm me këto kritere. Si rrjedhim, ndërmarrja e disa veprimeve të bashkërenduara konkrete mund të përshpejtojë vendime në të mirë të këtij qyteti: (i) Angazhimi zyrtar i pushtetit qendror për të rikonfirmuar dhe trajtuar me përparësi të veçantë çështjen e përfshirjes së qytetit të Beratit në listën e pasurive botërore kulturore e natyrore; (ii) Përgatitja e dosjes teknike në përputhje me kërkesat e Konventës, duke angazhuar personalitetet më të spikatura shkencore dhe të gjitha institucionet e nevojshme, si dhe ndihmë nga struktura të specializuara ndërkombëtare²⁰; (iii)

²⁰ Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe një grup ekspertësh shkencorë të nivelit të lartë, të nxitur nga Prefekti i Beratit dhe strukturat e pushtetit vendor, janë përfshirë në përgatitjen e dosjes teknike.

Argumentimi i domosdoshmërisë së përfshirjes së Beratit edhe në listën e pasurive botërore në rrezik; (iv) Përditësimi i vendimeve e rregulloreve ekzistuese për shpalljen e Beratit qytet muze dhe mbrojtjen e tij, duke shqyrtuar veprime të bashkërenduara të pushtetit qendror e atij vendor dhe pasojat buxhetore përkatëse; dhe (v) Ngarkimi i strukturave shtetërore për të bërë propozimin në UNESCO dhe për të ndjekur procedurat e shqyrtimit, përmirësimit dhe miratimit të këtij propozimi.

Duke i dhënë përparësi zbatimit të masave të mësipërme²¹, është e mundur që në këtë sektor të punësohen rreth 3.500 veta, si dhe të rritet ndjeshëm numri i ditëqëndrimeve të vizitorëve vendas e të huaj. Nga numri i sotëm i vizitorëve rezultojnë rreth 4.000 netëqëndrime në vit, nga të cilat vetëm rreth 25% janë të shtetasve të huaj. Gjatë pesë vjetëve të ardhshme ky tregues mund të rritet gradualisht deri në 10 herë dhe në vitin 2015 mund të jetë rreth 50 herë më i madh, duke mbizotëruar netëqëndrimet e shtetasve të huaj.

Zhvillimi i sektorit privat

Zhvillimi i sektorit privat e veçanërisht shtimi i numrit të ndërmarrjeve prodhuese është rruga kryesore për uljen e papunësisë në zonat urbane. Drejtimet strategjike për të përmbushur këtë synim janë: (i) Nxitja e krijimit dhe e konsolidimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme, duke i dhënë prioritet industrisë së përpunimit të prodhimeve bujqësore e blegtorale në përgjithësi dhe në veçanti prodhimeve tradicionale të trevave të qarkut; (ii) Nxitja e investimeve të huaja për shfrytëzimin e vendburimeve të naftës e të gazit me teknologji prodhimi më të përparuara; (iii) Zhvillimi i turizmit; dhe (iv) Zgjerimi i rrjetit të sistemit të formimit profesional në përputhje me kërkesat specifike të tregut.

Rritja e të ardhurave nga fermat

Rritja e të ardhurave nga fermat dhe shtimi i mundësive për përpunimin dhe shitjen e prodhimeve është rruga kryesore e rritjes së të ardhurave në zonën rurale. Kjo mund të arrihet duke synuar përparësi zhvillimi të përbashkëta për të gjithë zonën rurale të qarkut dhe të posaçme, që ndryshojnë sipas zonave, në mënyrë që në një periudhë afatmesme të sigurohet një rritje e prodhimit bimor e blegtoral në masën 15-20% dhe 10-25% përkatësisht dhe në një periudhë afatgjatë një rritje rreth 30-55% e 35-68%.

Masat afatmesme dhe afatgjata që duhen ndërmarrë për rritjen e të ardhurave janë përzgjedhur duke marrë parasysh edhe prijet e zhvillimit të fermave private. Këto lidhen me përmirësimin

²¹Një program i hollësishëm afatmesëm veprimi është përfshirë në dokumentin "Zhvillimi i turizmit në qarkun e Beratit", gusht 2003, përgatitur nga Zyra Rajonale e Turizmit pranë prefektit të Beratit.



e strukturës së prodhimit bujqësor e blegtoral, që shprehet qartë në pakësimin e sipërfaqes së mbjellë me drithëra, sidomos me grurë, stabilizimin dhe rritjen e vogël të sipërfaqes së mbjellë me perime dhe rritjen e ndjeshme të sipërfaqes së mbjellë me vreshta, ullinj e dru frutorë. Konvejeri i perimeve po rritet nga 4-5 muaj që ka qenë më parë, në 8-10 muaj, duke krijuar mundësi më të mëdha për rritjen e eksportit dhe një shpresë për uljen e importit të këtyre prodhimeve. Kjo është një prirje e dukshme në 4-5 vitet e fundit, ndonëse është një tendencë spontane zhvillimi e pambështetur nga politikat qeveritare. Kjo dëshmon se fermerët kanë filluar të kuptojnë se cilat janë kulturat më fitimprurëse, që kërkohen më shumë nga tregu dhe që pranohen prej tij edhe me çmime më të larta se të importit për arsye të shijes më të mirë. Numeriku i blegtorisë, sidomos në gjedhë (lopë) po pëson, gjithashtu, një ulje të vogël dhe ka gjasa që të mos ketë rritje në numër edhe për disa vjet. Kjo lidhet me prirjen e specializimit të fermave që merren me blegtori dhe prandaj mbjellin vetëm foragjere për ushqim blegtorie dhe me rritjen e numrit të fermave me mbi 5-10 lopë, mbi 100 dele e dhi, 100 pula etj.

Për të gjithë zonën rurale të qarkut është e rëndësishme (i) Nxitja e krijimit të shoqatave të prodhimit dhe të shërbimeve në zonën rurale, për të forcuar bashkëpunimin e prodhuesve dhe rritur interesin e fermerëve nëpërmjet përmirësimeve të teknologjisë së prodhimit. Ky proces duhet të mbështetet me përmirësimet e nevojshme ligjore dhe lehtësi financare; (ii) Nxitja e prodhimit bujqësor e blegtoral në funksion të zhvillimit të turizmit rural, për të shfrytëzuar mundësitë e mëdha që ofron natyra e qarkut për këtë lloj biznesi; (iii) Rritja e shkallës së mekanizimit të prodhimit bujqësor, për të ulur koston shumë të lartë të prodhimit, dhe fuqizimi i mekanikës bujqësore të përshtatur me terrenin dhe madhësinë e fermave. (iv) Ngritja e tregjeve të shumicës në afërsi të qyteteve për grumbullimin e prodhimeve të fermerëve privatë; (v) Ngritja e shkollave dhe hapja e kurseve të kualifikimit për fermerët e fëmijët e tyre; dhe (vi) Mbështetja për marketingun e prodhimeve të njohura lokale tradicionale, si fiku i Roshnikut, ulliri i Beratit, gjeli i detit, djathi i Skraparit etj., për të nxitur tregtimin dhe rritur vlerën e tyre në treg.

Drejtimet strategjike të zhvillimit për zona të veçanta janë në përshtatje me relievin e secilës zonë. Në **fushë në afërsi të qyteteve** është me leverdi: (i) Shtimi i prodhimit të perimeve nga fusha dhe nga serat, duke rritur sipërfaqen e mbjellë dhe zbatuar metoda moderne prodhimi; (ii) Rritja e prodhimit të ullirit, të vreshtave dhe të frutave të tilla si fiku, dardha etj., duke krijuar pemëtore të reja dhe rritur rendimentin e prodhimit; (iii) Rritja e numrit të krerëve të lopëve të racave të përparuara. Në **zonat kodrinore** është me leverdi: (i) Shtimi i prodhimit të pemëve frutore dhe i vreshtave, duke nxitur me përparësi ngritjen e pemëtoreve dhe vreshtave familjare me sipërfaqe 2-4 dn. (iii) Zhvillimi i blegtorisë duke i dhënë përparësi lopës dhe deles. Në **malësi** është më efektiv përqendrimi në pemët frutore, të tilla si qershia e kumbulla, dhe në blegtorinë e imët.

Shtimi i kapaciteteve përpunuese

Kapacitetet përpunuese të prodhimeve bujqësore e blegtorale në përgjithësi janë shumë të kufizuara. Kështu, në të gjithë qarkun janë rreth 26 baxho për përpunimin e qumështit, të cilat përballojnë më pak se 25% të nevojave përpunuese gjithsej. Janë vetëm 6 linja të përpunimit

të frutave dhe perimeve, aftësia përpunuese e të cilave përballon vetëm rreth 18% të nevojave. Edhe kapacitetet përpunuese të ullirit janë të pamjaftueshme.

Megjithëse interesi për ngritjen e punishteve të përpunimit të frutave dhe të prodhimeve bujqësore e blegtorale është i madh e i dukshëm, mundësitë financiare për ngritjen e linjave me teknologji bashkëkohore janë mjaft të kufizuara. Kjo konsiderohet si pengesë jo vetëm për rritjen e të ardhurave, por edhe si një frenim për rritjen e mëtejshme të prodhimit bujqësor e blegtoral, veçanërisht në zonat me dalje të kufizuara në treg. Si rrjedhim, kreditimi për ngritjen e linjave të përpunimit të prodhimeve dhe nxitja e bizneseve mbetet masa më prioritare për shtimin e kapaciteteve përpunuese.

Kreditimi

Financimi për të krijuar modele fermash bujqësore e blegtorale dhe modele linjash përpunimi të prodhimeve, duke zbatuar teknologji të reja, për të ndryshuar mendësinë e fermerëve dhe nxitur ata drejt zbatimit të këtyre modeleve, mund të quhet si një nga masat më të rëndësishme për rritjen e të ardhurave në zonën rurale. Kjo lidhet me (i) Sigurimin e linjave të kreditimit për frutikulturën, serrat, komplekset blegtorale etj., për të ngritur serra familjare 1-3 dy, pemëtore 5-10 dy, ferma me mbi 10 krerë lopë, mbi 100 dele e dhi etj.; (ii) Nxitjen e investimeve për farërat e fidanet, duke i prodhuar në vend nëpërmjet shoqatave të specialistëve e fermerëve dhe duke i importuar, për të rritur sipërfaqen ku përdoren farëra hibride e me gjeneracion elite; (iii) Kreditimin e mjeteve mekanike; (iv) Subvencionimin e karburantit; dhe (v) Financimin e linjave të përpunimit që janë privatizuar por nuk vihen dot në punë për mungesë burimesh financiare.

Mbarështimi i qëndrueshëm i pyjeve

Rruga kryesore për përmirësimin e shpejtë të gjendjes së pasurive natyrore të qarkut, veçanërisht të pyjeve, dhe për shndërrimin e tyre në burime të rëndësishme të ardhurash është mbarrësimi i tyre në bazë të pellgjeve të vegjël ujëmbledhës, duke e transferuar të drejtën e menaxhimit nga strukturat e pushtetit qendror tek komunat e bashkitë, duke bërë edhe ndarjen e qartë të territorit të çdo fshati brenda pellgut ujëmbledhës.

Drejtimet strategjike për mbarrësimin e qëndrueshëm të këtyre vlerave janë: (i) Dhënia e së drejtës afatgjatë të përdorimit ose kalimi në pronësi të bashkësive të cilat banojnë në zonat që i kanë këto pasuri, në mënyrë që fshatrat të jenë plotësisht të interesuara për mbarrësimin e qëndrueshëm të tyre. Kjo duhet të shoqërohet me hartimin e planeve të integruara të menaxhimit të pasurive të fshatit, të cilat të marrin në konsideratë tokën bujqësore, pyjore e kullimore e ujërat, si dhe nevojat e banorëve. Një program i gjerë edukimi do të ndihmonte banorët të përdorin në mënyrë të qëndrueshme tokat e pjerrëta. Zhvillimi i modeleve agrosilvopastorale në disa fshatra të zgjedhura që të përdoren për demonstrim mund të konsiderohet si baza e këtij programi edukimi; (ii) Krijimi i kapaciteteve në nivel komune për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave; (iii) Shtimi i prodhimit të foragjerëve për të ekuilibruar përdorimin e pyllit dhe kullotës;



(iv) Rehabilitimi i pyjeve dhe kullotave të degraduara; si dhe (v) Investime për kontrollin e erozionit në tokat e refuzuara dhe në ish pyjet e Bogovës.

Duke i dhënë përparësi zbatimit të masave të mësipërme, është e mundur që të garantohet menaxhimi i qëndrueshëm i tokës, pyjeve dhe kullotave, si dhe të rriten brenda afatesh të arsyeshme të ardhurat nga fermat, veçanërisht në komunat që aktualisht rezultojnë me të ardhura shumë të ulta.

Zgjerimi i Zonave të Mbrojtura

Gjendja e të tri zonave të mbrojtura të qarkut është e keqe dhe ruajtja e përkujdesja për to e papërfillshme (shih 1.5). Për asnjërën prej tyre nuk janë hartuar plane menaxhimi dhe kufijtë nuk janë shënuar qartë në terren.

Drejtimet strategjike për ndryshimin e gjendjes dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura janë: (i) Rivlerësimi i zonave të mbrojtura ekzistuese dhe saktësimi i shënimit të kufijve të tyre, aty ku nuk ka konflikte të pronësisë mbi tokën; (ii) Hartimi i një propozimi të ri për parkun kombëtar të malit të Tomorit, që e zgjeron sipërfaqen e zonës së mbrojtur ekzistuese, duke përfshirë në mënyrë më të integruar peizazhet me vlerat religjioze e të biodiversitetit; (iii) Fillimi i procesit të zgjidhjes së çështjeve të pronësisë në zonat e mbrojtura, duke i shqyrtuar rast pas rasti me përfshirjen e autoriteteve vendore dhe personave të interesuar; (iv) Hartimi i planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura, ku të përfshihen edhe masat për forcimin e administrimit dhe të mirëmbajtjes së tyre, së bashku me nevojat buxhetore përkatëse; (v) Krijimi dhe forcimi i kapaciteteve të menaxhimit të zonave të mbrojtura, si dhe zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit për bashkësinë dhe strukturat e qeverisjes vendore; (vi) Nxitja e veprimtarisë së OJF-ve në fushën e mbrojtjes së burimeve natyrore; (vii) Rivlerësimi i sistemit të lejeve dhe tarifave për shfrytëzimin e zonave të mbrojtura për qëllime turistike.

Në ligjin nr. 8906, datë 6.06.2002, “Për zonat e mbrojtura”, janë përcaktuar rregullat për shpalljen, ruajtjen, administrimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe të burimeve natyrore biologjike të tyre. Ky ligj ndalon ose kufizon prerjen e drurëve dhe të shkurreve, përdorimin e kimikateve, gjuetinë, kalimin e kafshëve shtëpiake, ndërtimet e çdo lloji etj. Ligji ngarkon institucionet qendrore dhe organet e qeverisjes vendore të hartojnë planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura. Plani i menaxhimit përfshin objektivat e menaxhimit të zonës së mbrojtur, mekanizmat dhe autoritetin drejtues, veprimtaritë e lejuara dhe të ndaluara etj. Ndryshimi i statusit të zonës së mbrojtur bëhet nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrisë së Mjedisit.

Përmirësimi i daljes në treg

Drejtimet strategjike për përmirësimin e daljes në treg të fermerëve të qarkut të Beratit janë: (i) Ndërtimi i rrugës kombëtare lidhëse me qarkun e Elbasanit, për të cilën nevojitet një investim prej rreth 980 milion lekë; (ii) Përmirësimi i rrjetit të rrugëve rurale, nëpërmjet rehabilitimit të rrugëve ekzistuese dhe ndërtimit të rrugëve që aktualisht janë sezonale; (iii) Përmirësimi i administrimit të rrugëve rurale, duke e shtuar fondin e rrugëve që administrohen nga Ndërmarrjet e Rrugëve Rurale të Beratit dhe Skraparit²² nga 205 km që është aktualisht në rreth 315 km.; (iv) Përcaktimi dhe ushtrimi i përgjegjësive të administratave të komunave për rrjetin rrugor komunal; dhe (v) Përgatitja e studimit të zbatueshmërisë dhe ndërtimi i një rruge më të shkurtër lidhëse turistike të Beratit me malin e Tomorit.



²² Këto dy ndërmarrje janë në varësi të Këshillit të Qarkut.

Objektivi 1: Zbutja e varfërisë nëpërmjet nxitjes së zhvillimit ekonomik

SYNIMI 1

Përgjysmimi, brenda vitit 2015, i pjesës së popullsisë, që konsumon më pak se rreth 3,850 lekë për frymë në muaj.

Treguesi 1	Punësimi në zonën urbane	
	2003 ²³	2015
Pjesa e forcave të punës e qarkut e punësuar në sektorin p privat jobujqësor	7%	28%
Punësimi në zonën urbane nga ndërmjetësimi i zyrave të punësimit	720	2,200
Punësimi nga zhvillimi ekonomik	301	5,800
Punësimi nga programet e nxitjes së punësimit	75	1,800

Treguesi 2	Shkalla e përshtatjes me tregun e punës	
	2003	2015
Numri i të papunëve të përfshirë në kurset e formimit profesional	160	800
Numri i profesioneve që përputhen me kërkesat e tregut të punës	6	14

Treguesi 3	Shkalla e shfrytëzimit të vlerave turistike	
	2003	2015
Numri i ne tëqendrimeve të vizitorëve vendas e të huajne vit	4,000	200,000

²³ Viti 2003 është marrë si vit bazë për shumicën e treguesve.

Treguesi 4		Të ardhurat nga fermat			
		Njësia e matjes	2002	2006	2015
Rrethi i Beratit					
I	Rritja e prodhimit				
1.1	Prodhimi bimor	%	100	120	155
1.2	Prodhimi blegtoral	%	100	125	160
II	Rritja e numrit të krerëve				
2.1	Gjedhë	krere	34,620	29,240	28,300
2.2	Të leshta	krere	80,968	88,000	102,660
2.3	Të dhirta	krere	48,948	45,000	45,000
III	Shtimi i sipërfaqes				
3.1	Serra	Ha	52	65	100
3.2	Pemëtore	Ha	1210	1400	1760
3.3	Ullinj	Ha	4015	4250	4700
3.4	Vreshta	Ha	422	950	1600
IV	Impute të përdorura				
4.1	Plehra kimike	Ton	10,200	12,000	15,000
4.2	Pesticide	Ton	50	60	70
V	Përpunimi i prodhimeve				
5.1	Bujqësore	%	27	37	50
5.2	Blegtorale	%	21	30	45
Rrethi i Kuçovës					
I	Rritja e prodhimit				
1.1	Prodhimi bimor	%	100	115	142
1.2	Prodhimi blegtoral	%	100	112	138
II	Rritja e numrit të krerëve				
2.1	Gjedhë	krere	7209	7100	6500
2.2	Të leshta	krere	7990	8630	11220
2.3	Të dhirta	krere	1090	1400	1500
III	Shtimi i sipërfaqes				
3.1	Serra	Ha	27.1	40	60
3.2	Pemëtore	Ha	300.8	340	450
3.3	Ullinj	Ha	604.7	500	650
3.4	Vreshta	Ha	65	90	150
IV	Impute të përdorura				
4.1	Plehra kimike	Ton	2160	2500	2800
4.2	Pesticide	Ton	30	40	45
V	Përpunimi i prodhimeve				
5.1	Bujqësore	%	22	35	48
5.2	Blegtorale		19	26	44

synimet dhe treguesit

Rrethi i Skraparit					
I	Rritja e prodhimit				
1.1	Prodhimi bimor	%	100	118	130
1.2	Prodhimi blegtoral	%	100	110	135
II	Rritja e numrit të krerëve				
2.1	Gjedhë	krere	6300	6400	6500
2.2	Të leshta	krere	50000	60000	62000
2.3	Të dhirta	krere	30500	32100	35000
III	Shtimi i sipërfaqes				
3.1	Serra	Ha	2.4	4.0	8.0
3.2	Pemëtore	Ha	140	162	222
3.3	Ullinj	Ha	21	28	35
3.4	Vreshta	Ha	119	156	219
IV	Impute të përdorura				
4.1	Plehra kimike	Ton	1402	1406	1408
4.2	Pesticide	Ton	2	2.1	2.2
V	Përpunimi i prodhimeve				
5.1	Bujqësore	%	18	24	35
5.2	Blegtorale		12	22	35

Treguesi 5	Mundësia e daljes në treg	
Rrethi	2003	2015
Berati	67%	80%
Kuçova	53%	80%
Skrapari	39%	65%

SYNIMI 2	Zhvillimi i qëndrueshëm i mjedisit natyror	
Treguesi 6	Sipërfaqja e mbuluar me pyje	
Shtimi i sipërfaqes	2003	2004-2015
Nga ripyllëzimi i tokave të degraduara	450 ha	12,000 ha
Nga pyllëzimi i shtretërve dhe anëve të lumejve	150 ha	2,000 ha

Treguesi 7	Pjesa e pyjeve në përdorim/administrim të komunave	
	2003	2015
Pjesa e transferuar e sipërfaqes së pyjeve %	20	55

Treguesi 8	Sipërfaqja e zonave të mbrojtura	
	2003	2015
Sipërfaqja e zonave të mbrojtura	4,660 ha	8,200 ha

shtimi i mundësive për shkollim

“Kryerja universale e arsimit bazë” është Objektiv 2 i Mijëvjeçarit për Zhvillimin. Ai synon që, brenda vitit 2015, fëmijët, si djemtë ashtu edhe vajzat, kudo që janë, të kenë mundësi të kryejnë arsimin bazë. Kjo lidhet me normën e frekuentimit të arsimit bazë, përqindjen e nxënësve që fillojnë klasën e parë dhe arrijnë në klasën e pestë, si dhe me përqindjen e atyre që dinë shkrim e këndim. Sipas analizave në nivel kombëtar, del se Shqipëria mbase mund ta përmbushë këtë objektiv dhe se shkalla e mbështetjes së politikave, kuadrit ligjor, burimeve të financimit, ndërgjegjësimit të publikut etj. për ta përmbushur këtë objektiv deri në vitin 2015 është e dobët në përmirësim²⁴.

²⁴ UNDP (HDPC). “Shqipëria dhe Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit”, Tiranë, maj 2002.

2.1 Të dhëna të përgjithshme

Në qarkun e Beratit funksionojnë 133 shkolla 8-vjeçare, rreth 83% e të cilave janë në fshat. Në fshat janë, gjithashtu, 93 shkolla filllore vartëse²⁵. Në vitin akademik 2002-2003 arsimit bazë u ndoq nga rreth 30 mijë nxënës, shumica e të cilëve në fshat (shih tabelën 2.1) dhe kjo është më e theksuar në rrethin e Beratit. Në sektorin e arsimit në të gjithë qarkun janë të punësuar 1,737 mësues, nga të cilët rreth 36% punojnë në shkollat e qytetit.

Në qarkun e Beratit ka, gjithashtu, 26 shkolla të mesme, që frekuentohen nga rreth 6,900 nxënës. Nga këto, 14 shkolla janë në fshat, ku mësojnë rreth 24% e nxënësve gjithsej të shkollave të mesme. Shkolla të mesme profesionale janë 5 shkolla: tri shkolla janë në rrethin e Beratit dhe nga një shkollë përkatësisht në rrethet Kuçovë dhe Skrapar.

tabela 2.1 Të dhëna mbi arsimin 8-vjeçar në vitin shkollor 2002-2003

Rrethet	Nr. i shkollave		Numri i nxënësve			
	Filllore vartëse	8-vjeçare	Filllore vartëse	8-vjeçare	Gjithsej	Nga këto në fshat %
Berat	47	78	1,598	18,502	20,100	66.3
Kuçovë	5	14	210	5,101	5,311	46.5
Skrapar	41	41	457	3,501	3,958	51.3
Qarku	93	133	2,265	27,104	29,369	60.7

Burimi: Drejtoritë arsimore të rretheve

Pothuajse të gjitha shkollat janë publike. Vetëm në qytetin e Beratit janë 3 shkolla jo publike, nga të cilat një e ciklit të ulët, një 8-vjeçare edhe e mesme dhe një shkollë e mesme. Në shkollat jo publike mësojnë rreth 450 nxënës, nga të cilët rreth 260 janë nxënës të shkollës së mesme, dhe janë të punësuar 45 mësues.

Në nivel vendi, shpenzimet publike për arsimin në tre vitet e fundit janë rritur nga 2,3% në 3,4% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Këto shpenzime në vitin 2003 kanë zënë rreth 11% të shpenzimeve të përgjithshme publike, kundrejt 9% që zinin në vitin 2000.

Financimi i buxhetit të shtetit për arsimin në qarkun e Beratit në tre vitet e fundit është rritur. Pjesa më e madhe e këtij buxheti, rreth 81%, përdoret çdo vit për pagat dhe sigurimet shoqërore të mësuesve. Investimet zënë një pjesë shumë të vogël të buxhetit, që është zvogëluar nga 8.4% në 7.3%.

2.2 Treguesit kryesorë të arsimit bazë

Vlerësimi për mundësinë e kryerjes së arsimit bazë²⁶, si për djemtë ashtu edhe për vajzat, është mbështetur në disa tregues kryesorë, të cilët japin mundësinë e njohjes së gjendjes dhe të prirjeve

²⁵Shkollat filllore vartëse janë shkolla të ciklit të ulët të fshatrave, ku nuk ka shkolla 8-vjeçare. Ato varen nga shkolla 8-vjeçare më e afërt.

²⁶Arsimi bazë është arsimit 8-vjeçar, i cili me ligj është i detyruar për të gjithë, dhe përbëhet nga cikli i ulët (klasat 1 deri 4) dhe cikli i lartë (klasat 5 deri 8).

të këtij sektori në qarkun e Beratit. Në përzgjedhjen e bërë janë pasur parasysh treguesit e Objektivit përkatës të Mijëvjeçarit për Zhvillimin dhe ata të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në kuadrin e rishikimit të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social²⁷, si dhe tregues të tjerë, të mundshëm për t'u analizuar dhe mbikëqyrur në qarkun e Beratit.

Përfshirja në arsimin bazë - Të dhënat mbi shpërndarjen e shkollave të ciklit të ulët dhe 8-vjeçare në qarkun e Beratit tregojnë se mundësia për t'u përfshirë në arsimin bazë është përgjithësisht e kënaqshme²⁸ (shih figurën 2.1). Megjithatë, ky tregues është shumë i ndryshëm sipas rretheve. Në rrethin e Beratit dhe Kuçovës vetëm një numër i kufizuar fshatrash nuk kanë shkollë filllore, por fëmijët e kanë mundësinë të ndjekin shkollën në fshatrat fqinjë, të cilat ndodhen në largësi deri në 3 km. Në rrethin e Skraparit, 27 fshatra nuk kanë shkollë dhe, pavarësisht se largësia e shkollave më të afërta është 3-5 km, terreni shumë i thyer malor dhe fakti se shumica e rrugëve janë të kalueshme vetëm në stinën e verës, e kufizojnë mjaft mundësinë e përfshirjes së këtyre nxënësve në shkollë, veçanërisht në ciklin e lartë të arsimit 8-vjeçar.

Norma neto e regjistrimit – Kjo tregon raportin e nxënësve që ndjekin ciklin e ulët dhe atë të lartë të arsimit bazë me numrin e fëmijëve të këtyre grupmoshave. Në vitin shkollor 2001-2002 ky tregues ka qenë 96% për ciklin e ulët dhe 98% për ciklin e lartë (shih tabelën 2.2). Ai është më i lartë në zonën urbane në krahasim me zonën rurale dhe ky ndryshim është më i dukshëm për ciklin e lartë të arsimit 8-vjeçar.

tabela 2.2 Treguesit kryesorë të arsimit bazë për qarkun e Beratit

Treguesit	Cikli	Vendi 2002		Viti shkollor 2001-2002			
		Gjithsej	Fshat	Gjithsej	Femra	Fshat	Femra
Norma neto e regjistrimit	U	96.0	93.0	96	94	95	93
Norma neto e regjistrimit	L	93.0	91.0	98	96	87	88
Raporti nxënës/mësues	U	22.0	n.a	20	n.a	18	n.a
Raporti nxënës/mësues	L	16.3	n.a	16	n.a	15	n.a
Raporti nxënës/klasë	U	22.5	n.a	21	n.a	18	n.a
Raporti nxënës/klasë	L	26.0	n.a	24	n.a	22	n.a
Frekuentimi në %	U	98.0	n.a	99	99	95	99
Frekuentimi në %	L	97.0	n.a	98	98	98	99
Kalueshmëria në %	U+L	-	-	95	96	94	95

Burimi: Drejtoritë arsimore të rretheve

U- i ulët, L- i lartë

Madhësia e klasës dhe numri i mësuesve – *Raporti nxënës/mësues* në qarkun e Beratit është në nivelin e mesatares së vendit dhe është përmirësuar nga viti në vit për ciklin e ulët të arsimit 8-vjeçar, por ka mbetur i pandryshuar për ciklin e lartë (shih tabelën 2.2). Mbatja e këtij treguesi në këto nivele krijon mundësinë e përbushjes së objektivit të Ministrisë së Arsimit dhe të

²⁷Matrica e treguesve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

²⁸Mundësia e ndjekjes është quajtur e kënaqshme, kur largësia e shkollave filllore nga qendrat e banimit është më e vogël se 3 km.



Shkencës që në vitin 2006 raporti nxënës/mësues në ciklin e ulët dhe të lartë të arsimit bazë të jetë përkatësisht 23 dhe 16.5. Megjithatë, në rrethin e Beratit gjendja është më e përkeqësuar në krahasim me dy rrethet e tjera. Në 17 shkolla fillore dhe në 25 shkolla 8-vjeçare të këtij rrethi ky tregues ka vlera më të larta se mesatarja e qarkut. Në rrethin e Skraparit vlerat e këtij treguesi janë të kënaqshme, pasi numri i nxënësve në fshatrat e këtij rrethi ka pësuar rënie të ndjeshme në dhjetë vitet e fundit.


Raporti nxënës/klasë në nivel qarku është përmirësuar çdo vit, veçanërisht për ciklin e ulët të arsimit 8-vjeçar (shih tabelën 2.2). Ky tregues është më i përkeqësuar në rrethin e Beratit pothuajse në të gjitha shkollat e qyteteve dhe në rreth gjysmën e numrit të shkollave fillore e 8-vjeçare të fshatrave. Në këto shkolla numri i nxënësve për klasë është më i madh sesa mesatarja e vendit. Në rrethin e Skraparit ky tregues paraqitet problematik vetëm në shkollat e qytetit të Çorovodës dhe të Poliçanit.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Ekonomik e Social ka përcaktuar si objektiv afatgjatë që vitet mesatare të shkollës për popullsinë të jenë jo më pak se 13.5 vjet. Në Qarkun e Beratit vërehet që në vitin 2001 numri mesatar i viteve të shkollës për popullsinë mbi 15 vjeç është 8.1 vjet. Ky tregues është më i lartë në rrethin e Kuçovës me mesatarisht 8.6 vjet. Niveli i treguesve kryesorë të arsimit bazë dhe të mesëm i qarkut të Beratit dhe problematika që haset tregojnë se një objektiv i tillë është mjaft ambicioz dhe i pabazuar sa duhet në mundësitë reale.

Kjo analizë tregon, gjithashtu, se raportet nxënës/mësues dhe nxënës/klasë në nivel rrethi, siç përdoren sot nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe nga SKZHSE, nuk shprehin realisht gjendjen, sepse ato ndikohen nga vlerat shumë të ulëta që këta tregues kanë në shkollat e fshatit. Kjo i fsheh problemet shumë shqetësuese që janë krijuar në shkollat e qytetit nga numri mjaft i madh i nxënësve për klasë dhe për mësues. Për këtë arsye është më e dobishme që objektivat e vendosur të jenë të ndarë për zonën urbane dhe rurale.

Frekuentimi - Ndjekja e shkollës në nivel qarku është më e mirë se mesatarja e vendit për të dy ciklet e arsimit 8-vjeçar dhe është përmirësuar nga viti në vit (shih tabelën 2.2). Kështu, frekuentimi për ciklin e lartë në vitin shkollor 2001-2002 është rritur në 98% nga 96% që ishte në vitin shkollor 1995-1996. Për këta tregues, të paktën sipas të dhënave statistikore, nuk dalin dallime midis zonave urbane dhe rurale. Frekuentimi i djemve dhe vajzave del të jetë, gjithashtu, pa dallime të dukshme, si në qytet ashtu edhe në fshat. Vlerësimi i përgjithshëm është se, në nivel qarku, për shumicën dërrmuese të fëmijëve që regjistrohen në shkollë, quhen të kapërcyera dukuritë e viteve të para të tranzicionit në lidhje me ndjekjen e shkollës.

Figura 2.1 | Përfshirja në arsimin bazë



Kalueshmëria - Ky tregues në vitin shkollor 2001-2002 paraqitet i përmirësuar krahasuar me vitin shkollor 1995-1996 (shih tabelën 2.2). Përmirësim të dukshëm ai ka pësuar për nxënësit që ndjekin shkollën 8-vjeçare në fshat, duke u rritur nga 91% në 94%. Megjithatë, kalueshmëria në shkollat e zonës rurale mbetet më e ulët se ajo në zonat urbane.

Analfabetizmi - Norma e analfabetizmit në qarkun e Beratit është 2.2% kundrejt 1.6% në shkallë vendi²⁹ (shih tabelën 2.3). Ajo është veçanërisht e lartë në rrethin e Beratit, rreth 2.9%. Duke analizuar treguesin e analfabetizmit për popullsinë e rritur mbi 15 vjeç³⁰, rezulton se për qarkun e Beratit ai është 1.86% duke u paraqitur tepër i lartë për rrethin e Beratit. Për këtë pjesë të popullsisë, analfabetizmi nuk haset vetëm në moshat e vjetra por është i pranishëm dhe tek të rinjtë. Kështu, analfabetizmi në grupmoshën 15-24 vjeç del se është 0.84% në nivel qarku, ndërsa në nivel vendi është 0.57%.

Të dhënat mbi analfabetizmin dëshmojnë se vështirësitë e mëdha dhe krizat e herëpashershme gjatë periudhës së tranzicionit po japin efektet e tyre negative. Në rastin e arsimit këto janë efekte negative afatgjata që është shumë vështirë të ndreqen. Prandaj është e domosdoshme që probleme të tilla, veçanërisht në zonat rurale, të njihen e vlerësohen me realizëm, për të nxitur marrjen e masave të shpejta dhe rezultative.

tabela 2.3 Pjesa e popullsisë analfabete

Rrethi	Analfabetizmi në %		
	Gjithsej	Popullsia mbi 15 vjeç	Grup moshë 15-24 vjeç
Berat	2.9	2.44	1.03
Kuçovë	0.9	0.76	0.51
Skrapar	0.9	0.74	0.37
Qarku	2.2	1.86	0.84
Vendi	1.6	1.29	0.56

Burimi: HDPC

2.3 Mundësia reale për marrjen e arsimit bazë

Klasat e kombinuara

Lëvizjet e mëdha demografike të popullsisë gjatë 12 viteve të fundit e kanë zvogëluar ndjeshëm popullsinë, veçanërisht në zonën rurale (shih 1.1). Ky fenomen ka ndikuar edhe në mënyrën e organizimit të sistemit arsimor në këto zona kryesisht në dy drejtime: (i) nxënësit e fshatrave që nuk kanë shkollë fillore apo 8-vjeçare mësojnë në shkollat e fshatrave më të afërta, dhe (ii)

²⁹Ky vlerësim është bërë për popullsinë e moshës mbi 6 vjeç nga regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë i vitit 2001.

³⁰Sipas standardeve ndërkombëtare norma e analfabetizmit shpreh përqindjen e popullsisë mbi 15 vjeç që nuk mund të shkruajë dhe të lexojë një fjali të shkurtër.

në rastet kur numri i nxënësve është më i vogël se ai i parashikuar në standardet e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, mësimi zhvillohet në klasa të kombinuara.

Dispozitat normative të arsimit parauniversitar përcaktojnë që në shkolla të zonave rurale, për shkak të numrit të vogël të nxënësve për çdo klasë, puna mësimore-edukative mund të realizohet edhe në klasa të kombinuara. Formimi i klasave të kombinuara bëhet në varësi të numrit të nxënësve. Në ciklin e ulët zakonisht bashkohen klasa e parë me klasën e tretë dhe klasa e dytë me klasën e katërt. Nëse numri i nxënësve në të katër klasat është më i vogël se 25, atëhere formohet vetëm një klasë e kombinuar. Zhvillimi i mësimin në klasa të kombinuara në mjaft shkolla 8-vjeçare dhe të ciklit të ulët në qarkun e Beratit kufizon ndjeshëm mundësinë reale të fëmijëve për marrjen e arsimit bazë.

Në vitin shkollor 2003-2004 në 141 shkolla të zonës rurale të qarkut të Beratit, nga 205 që janë gjithsej, ka 274 klasa të kombinuara si në ciklin e ulët ashtu dhe në ciklin e lartë të arsimit 8-vjeçar (shih tabelën 2.4). Në këto klasa mësojnë 4,149 nxënës, të cilët përbëjnë 23.3% të numrit të përgjithshëm të nxënësve të shkollave të fshatit. Ky fenomen është veçanërisht i pranishëm në fshatrat e rrethit të Skraparit ku, për shkak të migrimit më të madh të popullsisë, 71.6% e nxënësve e zhvillojnë mësimin në klasa të kombinuara, çka e ul ndjeshëm mundësinë e këtyre nxënësve për t'u arsimuar në mënyrë cilësore.

Struktura demografike e popullsisë provon se numri i klasave të kombinuara dhe i nxënësve që mësojnë në to do të rritet nëse nuk gjenden zgjidhje alternative për zhvillimin e mësimin në kushte normale. Kështu, në 64% të fshatrave të rrethit të Skraparit në vitin 2001 kishte më pak se 50 fëmijë të grupmoshës 0-15 vjeç, ndërkohë që largimi i familjeve nga fshati drejt zonave urbane është një prirje e vazhdueshme. Zvogëlimi i numrit të nxënësve në shkollat e fshatit dhe rritja e numrit të nxënësve në shkollat e qytetit ka çuar në të dy rastet në uljen e cilësisë së mësimdhënies dhe të shkallës së marrjes së dijeve nga nxënësit.

tabela 2.4 Numri i nxënësve në klasa të kombinuara (2003-2004)

Rrethi	Shkolla në fshat gjithsej	Nga këto, me klasa të kombinuara	Klasa të kombinuara gjithsej	Nxënës në klasa të kombinuara	
				Gjithsej	%
Berat	113	61	138	2,568	19.3
Kuçovë	14	5	8	128	5.2
Skrapar	78	75	128	1,453	71.6
Qarku	205	141	274	4,149	23.3

Burimi: Këshilli i Qarkut



Kualifikimi i mësuesve

Në ciklin e ulët dhe të lartë të arsimit 8-vjeçar të qarkut të Beratit janë përkatësisht 146 dhe 1,551 mësues gjithsej. Pak më shumë se gjysma e tyre janë femra. Në shumë shkolla vartëse dhe 8-vjeçare ka mësues që nuk e kanë arsimin e nevojshëm për të ushtruar këtë profesion. Në shkollat fillore vartëse të rrethit të Beratit këta përfaqësojnë rreth 22% të mësuesve, ndërsa në shkollat 8-vjeçare të fshatrave të rrethit të Skraparit rreth 39% të mësuesve (shih tabelën 2.5).

Përputhja e nivelit arsimor të mësuesit me atë që kërkon vendi i punës është vetëm njëri aspekt i mësimdhënies. Aspekti tjetër po kaq i rëndësishëm është kualifikimi i vazhdueshëm i mësuesve. Vlerësimi i përgjithshëm është se kualifikimit i kushtohet pak vëmendje, megjithë angazhimin, veçanërisht dy vitet e fundit, të Institutit të Studimeve Pedagogjike dhe Drejtorive Arsimore të rretheve në veprimtari kualifikuese. Nga ana tjetër, kualifikimi i mësuesve nuk është i lidhur drejtpërdrejt me një vend pune më të mirë dhe me një pagë më të lartë, sepse politika e emërimit të kuadrit vazhdon të mos mbështetet në kritere të qarta nxitëse. Mungojnë standardet e vlerësimit, që e motivojnë dhe e detyrojnë mësuesin të rrisë kualifikimin e tij dhe të përballet me konkurrencën, njëlloj siç veprohet në fusha të tjera.

tabela 2.5 **Niveli arsimor i mësuesve**

Rrethi	Nr. i mësuesve ne arsimin baze	Mësues me arsimin përkatës në shkollat fillore vartëse %	Mësues me arsimin përkatës në shkollat 8-vjeçare %	
			Qytet	Fshat
Berat	1,119	78.2	94.6	76.8
Kuçovë	277	100.0	97.7	92.5
Skrapar	301	89.1	90.5	61.3

Burimi: Këshilli i Qarkut

Gjendja fizike e shkollave

Gjendja fizike e shumicës së shkollave në mjaft raste përbën një pengesë serioze për zhvillimin normal të procesit mësimor në qarkun e Beratit. Nga 226 shkolla fillore e 8-vjeçare që ka qarku, në dhjetë vjetët e fundit vetëm 10 shkolla janë ndërtuar të reja dhe 56 shkolla janë rehabilituar (shih tabelën 2.6).

Në vitin 2002 në nivel vendi u investua në 132 objekte shkollore, nga të cilat 92 rehabilitime dhe 40 ndërtime të reja. Në vitin 2003 u investua në 163 objekte shkollore, nga të cilat 126 rehabilitime dhe 37 ndërtime të reja. Në shkallë vendi del se rreth 48 % e shkollave kanë nevojë për rehabilitime dhe në to mësojnë rreth 30 % e nxënësve gjithsej.

Ndërtimi i shkollave të reja është bërë kryesisht me fonde nga buxheti i shtetit, me përjashtim të një shkolle të ndërtuar në rrethin e Kuçovës me fonde të donatorëve të huaj. Investimet për rehabilitimin e shkollave janë përballuar si me fondet e buxhetit të shtetit, ashtu dhe me fonde të donatorëve të huaj. Vihet re mungesa thuajse e plotë e kontributit të donatorëve të huaj në zonën rurale të rrethit të Skraparit. Ndërsa në rrethin e Beratit kontributi i buxhetit të shtetit dhe i donatorëve për rehabilitimin e shkollave është pothuajse në të njëjtën masë.

tabela 2.6 **Gjendja fizike e shkollave të fshatit**

Rrethi	Shkolla gjithsej	Shkolla të reja			Shkolla të rehabilituara			Shkolla të mbetura	Në gjendje jo të mirë
		Nr.	Shteti	Donatorët	Nr.	Shteti	Donatorët		
Berat	113	5	5	-	29	16	13	79	49
Kuçovë	14	3	2	1	10	4	6	1	1
Skrapar	78	2	2	-	17	16	1	59	39
Qarku	205	10	9	1	56	36	20	139	89

Burimi: Drejtoritë arsimore të rretheve

Me gjithë investimet e kryera, nevojat për financime me përparësi janë shumë të mëdha, sepse një numër i konsiderueshëm shkollash janë në gjendje të keqe. Këto përfaqësojnë rreth 44% të shkollave në fshatrat e rrethit të Beratit dhe rreth 50% të shkollave në fshatrat e rrethit të Skraparit. Aktualisht 34.2% e nxënësve të fshatrave të rrethit të Beratit dhe 53.4 % e nxënësve të fshatrave të rrethit të Skraparit mësojnë në shkolla që janë në gjendje jo të mirë fizike, ndërkohë që janë mjaft shkolla të ndërtuara të reja ose të rehabilituara në fshatra, ku numri i nxënësve është shumë i vogël ose nuk ka nxënës fare.

2.4 Nevoja për përqëndrimin e shkollave

Rrjeti ekzistues i shkollave në zonën rurale të qarkut mbështetet në strategjinë e zhvillimit të sektorit të arsimit të periudhës para vitit 1990, sipas së cilës në çdo fshat duhej të kishte një shkollë. Kjo strategji i përket kohës kur popullsia e fshatrave ishte e stabilizuar dhe lëvizja e lirë nuk ishte e lejuar. Ndryshimet demografike kanë sjellë një shpërndarje të re e mjaft të ndryshme të numrit të nxënësve, e cila paraqitet në figurën 2.1. Kjo ka sjellë që në 104 shkolla të zonës rurale, nga 205 gjithsej, numri aktual i nxënësve të jetë nga 5 në 50 nxënës. Në 74 prej tyre ka deri në 25 nxënës. Numri i vogël i nxënësve është më tipik në shkollat e rrethit të Skraparit, ku, nga 78 shkolla gjithsej, 23 shkolla kanë më pak se 10 nxënës. Vlerësohet se kjo prirje ndryshimesh do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Në figurën 2.2 jepet një parashikim se si do të ndryshojë numri i nxënësve për çdo fshat deri në vitin 2013. Shihet qartë se numri i nxënësve parashikohet të rritet vetëm në 47 shkolla, ndërsa në shkollat e tjera parashikohet një zvogëlim i numrit të nxënësve nga 1% deri në 100% të numrit të sotëm. Kjo do të thotë se në vitin 2013 në 132 shkolla numri i nxënësve do të jetë nga 5 në 50. Numri më i madh i shkollave të tilla parashikohet të jetë në rrethin e Skraparit.



Deri më sot, drejtoritë arsimore të rretheve i janë përshtatur kësaj gjendjeje të re me shtimin e numrit të klasave kolektive dhe me mbylljen e disa shkollave. Kështu që, në të ardhmen, numri i vogël i nxënësve parashikohet të rrisë më tej numrin e klasave kolektive dhe të krijojë kufizime akoma më të mëdha për frekuentimin e ciklit të lartë të arsimit 8-vjeçar. Këto do të ndikojnë shumë më tepër se deri tani në uljen e cilësisë së mësimdhënies dhe të shkallës së marrjes së dijeve nga nxënësit.

Shpërndarja aktuale e shkollave kufizon, gjithashtu, mundësitë për përmirësimin e shpejtë të gjendjes fizike të pajisjeve të shkollave, përfshirë mjetet e domosdoshme të mësimdhënies. Në përgjithësi, investimet që bëhen për këtë qëllim nuk mbështeten në një perspektivë të qartë afatgjatë.

Të gjitha këto arsye e bëjnë të pashmangshëm një konceptim të ri të shpërndarjes së shkollave, që ka si bazë përqendrimin e tyre. Realizimi i një studimi zbatueshmërie, që shfrytëzon të gjithë treguesit e këtij dokumenti, është plotësisht i mundur. Numri i nxënësve, numri i mësuesve dhe kualifikimi i tyre, gjendja fizike e shkollave dhe e pajisjeve dhe mundësitë për investime në to, gjendja e infrastrukturës rrugore dhe perspektiva e përmirësimit të saj, kostot e transportit të mësuesve dhe nxënësve, do të ishin kriteret më kryesore për përcaktimin e rrejtit të ri të shkollave në zonën rurale. Krijimi i drejtorisë rajonale të arsimit dhe riorganizimi i drejtorive arsimore të rretheve e rrit mundësinë e përgatitjes së një studimi të tillë.


2.5 Dukuria e braktisjes së shkollës

Largimet nga shkolla

Në qarkun e Beratit dhe në secilin rreth të tij numri i nxënësve që kanë braktisur shkollën në tre vitet e fundit është ulur. Në vitin shkollor 2000-2001 e braktisën shkollën 739 nxënës, ndërsa në vitin shkollor 2002-2003 ky numër u ul në 324 nxënës (shih tabelën 2.7). Të dhënat tregojnë se braktisja e shkollës është një dukuri rurale.

Në nivel vendi, braktisja e shkollës ka ardhur duke rënë. Në vitin shkollor 1998-1999 ajo ka qenë 3.2%. Në vitin shkollor 1999 - 2000 u ul në 2.8%, kurse në vitin shkollor 2001 -2002 zbriti në 2.4%. Në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social është parashikuar që në periudhën 2004-2006 ky tregues të zvogëlohet deri në 1.5% dhe synohet që deri në vitin 2015 të jetë zero.

Figura 2.2 | Ndryshimi i numrit të nxënësve deri në vitin 2013



Pjesa më e madhe e nxënësve e braktisin shkollën në ciklin e lartë të shkollës 8-vjeçare. Ky tipar nga viti në vit është bërë më i dukshëm. Kështu, në vitin shkollor 2000-2001 rreth 70% e numrit të përgjithshëm të nxënësve braktisës janë larguar pas përfundimit të ciklit të ulët, ndërsa në vitin shkollor 2002-2003 kjo përqindje është rritur në 78%.

tabela 2.7 **Braktisja e shkollës në arsimin 8-vjeçar**

Rrethi	2000-2001		2001-2002		2002-2003	
	Braktisin shkollën	Në ciklin e lartë %	Braktisin shkollën	Në ciklin e lartë %	Braktisin shkollën	Në ciklin e lartë %
Berat	605	69.4	357	77.9	249	80.3
Kuçovë	97	74.2	91	69.2	63	68.3
Skrapar	37	62.1	32	78.1	12	91.6
Qarku	739	69.7	480	76.3	324	78.4

Burimi: Drejtoritë arsimore të rretheve

Shkaku më kryesor i braktisjes së shkollës është gjendja e vështirë ekonomike dhe sociale e familjes (shih tabelën 2.8). Kjo lidhet me kushtet e vështira ekonomike, që i shtynjë prindërit t'i fusin fëmijët në punë për t'i ardhur në ndihmë familjes. Një pjesë e konsiderueshme e fëmijëve del se janë me prindër në emigracion apo me prindër të divorcuar.

Nxënësit që braktisin shkollën zakonisht nuk rikthehen për ta vazhduar atë. Kështu, nga numri i nxënësve që kanë braktisur shkollën në rrethin e Beratit në tre vitet e fundit (shih tabelën 2.7), u rikthyen përkatësisht vetëm 16, 23 dhe 2 nxënës. Kjo tregon se shkaqet e braktisjes janë shumë të forta dhe të qëndrueshme. Nga ana tjetër, edhe kuadri ligjor ekzistues nuk e pengon sa duhet këtë fenomen. Vendimet për penalizimin e prindërve nuk zbatohen, pasi mungon hallka ekzekutuese e tyre.

tabela 2.8 **Shkaqet e braktisjes së shkollës**

Shkaqet e braktisjes	Shkalla e ndikimit sipas rretheve (në %)		
	Berat	Kuçovë	Skrapar
Gjendja ekonomike dhe sociale	57.8	87.3	50.0
Emigrimi	10.4	7.9	25.0
Mungesë rendi	15.3	-	-
Infrastruktura dhe mjedisi shkollor i papërshtatshëm	16.5	4.8	16.7

Burimi: HDPC

Trajtimi i diferencuar i fëmijve që braktisin shkollën është bërë objekt i punës së disa shoqatave jo fitimprurëse vendase dhe të huaja në qarkun e Beratit, të cilat janë aktive në këtë drejtim, duke dhënë rezultate pozitive. Por veprimtaria e tyre është përqendruar në zonat urbane dhe nuk është shtrirë në fshat, ku edhe nevojat janë më të mëdha.

Prapambetja e theksuar

Prapambetja e theksuar në mësim apo fenomeni i quajtur “braktisja e fshehtë” është e pranishme në shkollat e qarkut të Beratit. Rreth 1,830 nxënës (shih tabelën 2.9), shumica e të cilëve në rrethin e Beratit, megjithëse vijojnë rregullisht ciklin e ulët dhe të lartë të shkollës 8-vjeçare kanë vështirësi në njohjen e tingujve, në bashkimin e tyre në rrokje, në formimin e fjalëve apo të fjalive. Ky është më shumë një fenomen rural dhe lidhet si me interesimin e pakët të familjeve për nivelin e nxënies së fëmijëve ashtu edhe me numrin e madh të klasave të kombinuara apo me faktin se ka mësues pa arsimin përkatës. Nga një vlerësim i përafërt del se nxënësit me prapambetje të theksuar në mësim përbëjnë rreth 10% të numrit të përgjithshëm të nxënësve të shkollave të fshatit. Rreth 61% e tyre ndjekin mësimin në ciklin e ulët të shkollës 8-vjeçare. Djemtë përbëjnë shumicën e nxënësve me prapambetje të theksuar në mësim.

tabela 2.9 Nxënës me prapambetje të theksuar në arsimin 8-vjeçar, 2002-2003

Rrethi	Gjithsej	Femra %	Cikli i ulët %	Fshat %
Berat	1,109	34.4	51.7	88.3
Kuçovë	528	41.7	69.5	89.2
Skrapar	197	34.5	87.8	94.9
Qarku	1,834	36.5	60.7	89.3

Burimi: HDPC

Megjithëse braktisja e fshehtë është një dukuri e përhapur, nuk bëhen përpjekje serioze e sistematike për ta njohur, evidentuar, analizuar dhe monitoruar këtë fenomen, si dhe për të përcaktuar rrugët më të shpejta dhe frytdhënëse për parandalimin e tij. Si rrjedhim, shumica e këtyre nxënësve më pas përfshihet në grupin e analfabetëve.

2.6 Arsimi i mesëm

Objektivi i përcaktuar në SKZHES për arsimin e mesëm është që, deri në vitin 2006, rreth 72% e nxënësve që mbarojnë arsimin bazë të vazhdojnë arsimin e mesëm, me synimin afatgjatë që deri në vitin 2015 kjo shifër të arrijë në 90%. Arritja e këtij treguesi lidhet ngushtë me masat që do të merren për rritjen e mundësisë së përfshirjes në arsimin e mesëm të nxënësve që jetojnë në fshat.

Në qarkun e Beratit funksionojnë 25 shkolla të mesme të përgjithshme, në të cilat mësojnë 6,872 nxënës, nga të cilat 16 shkolla janë në rrethin e Beratit (shih tabelën 2.10 dhe figurën 2.3). Treguesit e arsimit të mesëm në nivel qarku përgjithësisht kanë ardhur duke u përmirësuar (shih tabelën 2.11).

tabela 2.10 **Arsimi i mesëm i përgjithshëm në qarkun e Beratit**

Rrethi	Nr. i shkollave	Nr. i nxënësve 2002-2003		% e nxënësve që thithen nga arsimi mesëm	% e nxënësve të rregjistruar që përfundojnë arsimin e mesëm	% e mësuesve me kualifikimin përkatës
		Gjithsej	Fshat (%)			
Berat	16	4,568	27.7	67.5	85	n.a
Kuçovë	4	1,178	26.1	83	80	95
Skrapar	5	1,126	9.0	81	96	88

Burimi: Këshilli i Qarkut

Shkalla e thithjes së nxënësve që mbarojnë arsimin 8-vjeçar dhe regjistrohen në arsimin e mesëm është më e lartë në rrethin e Kuçovës dhe më e ulët në rrethin e Beratit. Raporti neto i regjistrimit në shkollat e mesme në qarkun e Beratit për vitin shkollor 2001-2002 është 40% dhe është veçanërisht i ulët për fshatin, vetëm 19% (shih tabelën 2.11). Megjithatë, të dhënat e raportuara për rrethin e Skraparit që paraqiten në tabelën 2.10 dhe 2.11 nuk përputhen sa duhet me numrin e paktë të shkollave të mesme në këtë rreth. Numri i vogël i shkollave të mesme në këtë rreth, vështirësia më e madhe për të arritur me transport shkollat për shkak të terrenit të vështirë dhe mungesës së rrugëve, janë arsye që e frenojnë rritjen e numrit të nxënësve që ndjekin arsimin e mesëm në rrethin e Skraparit dhe që i bëjnë të diskutueshme këto të dhëna.

tabela 2.11 **Treguesit e arsimit të mesëm në qarkun e Beratit**


Treguesit	1995-1996				2001-2002			
	Gjithsej	Femra	Fshat	Femra	Gjithsej	Femra	Fshat	Femra
Frekuentimi në %	93	95	93	94	95	99	87	99
Raporti nxënës/mësues	13		13		17		18	
Raporti bruto i regjistrimit në %	n.a	n.a	n.a	n.a	40	35	16	17
Raporti neto i regjistrimit në %	n.a	n.a	n.a	n.a	40	35	19	19
Kalueshmëria në %	92	94	90	93	90	93	94	91

Burimi: Drejtoritë arsimore të rretheve

Jo të gjithë nxënësit që regjistrohen në arsimin e mesëm, e përfundojnë atë. Janë më shumë meshkujt sesa femrat ata që i ndërpresin mësimet në shkollën e mesme. Shkaku kryesor i ndërprerjes së shkollës për meshkujt është emigracioni për nevoja ekonomike dhe për femrat martesat e hershme apo emigracioni i familjes. Vihet re, gjithashtu, se një numër mësuesish të shkollave të mesme nuk kanë arsimin e nevojshëm për të ushtruar këtë profesion dhe kjo është më e dukshme në shkollat e mesme të bashkuara të fshatit. Në këto shkolla, edhe midis mësuesve me nivelin e duhur arsimor, ka mjaft me nivel profesional që nuk u përgjigjet kërkesave të kohës. Kjo ndodh ngaqë puna për kualifikimin e mësuesve është ende formale e sipërfaqësore dhe interesi i vetë mësuesve për rritjen e nivelit profesional është i paktë.

Një aspekt i rëndësishëm është përhapja jo shumë e gjerë e teknologjisë së informacionit, e cila krijon mundësi të mëdha për thithje informacioni të përditësuar në fusha të ndryshme. Megjithatë, vlerësohet se të rinjtë i shfrytëzojnë në një shkallë të lartë mjetet ekzistuese të informimit, ndërsa mësuesit në një shkallë shumë më të ulët.

Figura 2.3 | Përfshirja në arsimin e mesëm



Arsimi i mesëm profesional

Struktura e tregut të punës në Shqipëri ka pësuar ndryshime thelbësore dhe pjesa më e madhe e industrive tradicionale prodhuese është zëvendësuar me lloje të ndryshme të shërbimeve (një analizë e hollësishme e tregut të punës për qarkun e Beratit është bërë në kapitullin 1.2). Për shkak të kësaj, disa prej aftësive “të vjetra” të punës janë duke u zhdukur dhe të tjera shprehi pune po kërkohen shumë në treg. Në këtë kontekst, arsimi profesional po synon t’i përgjigjet situatës aktuale dhe të ardhshme, nëpërmjet ndryshimeve reformuese. Duke patur parasysh se ky ka një karakter më kompleks sesa format e tjera të arsimit, pasi lidhet me interesat e faktorëve të ndryshëm socialë: ndërmarrjeve, sindikatave, shtetit, shkollave, edhe përpjekjet për ndryshimin dhe ristrukturimin e tij janë më të vështira dhe kërkojnë mirëkuptimin e të gjithë këtyre aktorëve. Ajo çka tërheq më tepër vëmendjen është fakti se në përbërje të arsimit të mesëm, pesha që zë arsimi profesional është vetëm 18% (këtu përfshihet edhe grupimi i shkollave të quajtura social-kulturore)³¹. Treguesit e ulët të arsimit profesional në vendin tonë sigurisht që kanë efekte të ndjeshme negative në zhvillimin ekonomik dhe në tregun e punës.

Arsimi profesional në Shqipëri ofron kualifikime profesionale afatgjata 3 vjeçare për nivelin e punëtorit të kualifikuar dhe 5 vjeçare për nivelin e teknikut. Në vitin shkollor 2002-2003, në arsimin e mesëm u regjistruan 66% e atyre që mbaruan arsimin e detyruar. Raporti i Regjistrimit Neto në këtë vit shkollor llogaritet 42% dhe ka ndryshime të theksuara midis zonave urbane dhe rurale. Fushat kryesore që ofron arsimi profesional janë degë industriale, shërbimet, ndërtimi dhe bujqësia. Shpërndarja gjeografike e arsimit profesional është mjaft e përafërt me shpërndarjen e popullsisë. Arsimi profesional është më i përqendruar në qytetet e mëdha si Tirana, Shkodra, Durrësi, Elbasani, Korça, Fieri e Vlora dhe vetëm dy shkolla profesionale janë në zona rurale. Vihet re, gjithashtu, një përputhje e ofertës (numrit të nxënësve që ndjekin këtë arsim) me nivelin e zhvillimit ekonomik rajonal, ndoshta edhe për faktin se përqendrimi i popullsisë ka ndjekur këtë të fundit. Krahasuar me strukturën e ekonomisë në nivel kombëtar, rezulton se nuk ka një raport të drejtë midis numrit të nxënësve në profesione të caktuara dhe peshës që kanë në ekonominë kombëtare sektorët përkatës. Kështu, ndërsa bujqësia siguron rreth 50% të të ardhurave kombëtare, numri i nxënësve në këtë fushë është vetëm 11,9 % e totalit.

Arsimi profesional në qarkun e Beratit shfaq të njëjtat tipare që vihen re në nivel vendi. Aktualisht janë 5 shkolla të tilla, nga të cilat tri në qytetin e Beratit, një në Kuçovë dhe një në Poliçan. Në vitin

³¹Në vendet e OECD-së ky tregues është rreth 50% dhe në disa vende të zhvilluara perëndimore edhe më i lartë.

shkollor 2003-2004 në to mësojnë 1,576 nxënës të ndarë në 9 specialitete³² apo rreth 10% më shumë se viti i kaluar (shih tabelën 2.12). Nga këto 36.6% janë vajza. Numri më i madh është i nxënësve të degës së mësuesisë. Më pas vijnë nxënësit e profesioneve të bujqësisë, si dhe ata të specialiteteve të tjera të prodhimit të vogël dhe shërbimeve si mekanik automobili, mekanik i përgjithshëm, elektrik etj.

Numri i nxënësve i krahasuar me atë të arsimit të mesëm të përgjithshëm është i ulët, veçanërisht në rrethin e Skraparit dhe të Beratit. Në vitin shkollor 1995-1996 dhe 2001-2002 ky raport ka qenë përkatësisht 80/20 dhe 84/16, çka provon rritjen e numrit të nxënësve në arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe interesin e paktë për të ndjekur shkollat e mesme profesionale. Ky raport është shumë më i përkeqësuar me nxënësit e fshatit. Në dy vitet shkollore të mësipërme ai ka ndryshuar nga 85/15 në 98/2, çka provon një rënie të ndjeshme të numrit të nxënësve nga fshati që ndjekin arsimin e mesëm profesional. Në nivel vendi, në vitin shkollor 2001-2002 numri i nxënësve që vazhduan shkollat e mesme të arsimit profesional ishte 15.4% e nxënësve gjithsej të shkollave të mesme. Në vitin shkollor 2002-2003 ky numër u rrit në 16% dhe për periudhën afatmesme 2003-2006 objektivi është 30%.

tabela 2.12 **Arsimi profesional në qarkun e Beratit**

Nr.	Emërtimi	2002-2003				2003-2004	
		Gjithsej	Femra	Fshati	Femra	Gjithsej	Femra
	Berat	1084	475	609	303	1241	577
1	Elektrike	0	0	0	0	109	0
2	Mekanik auto	0	0	0	0	112	0
3	Mek. i përgj.	306	0	108	0	110	0
4	Pikturë	0	0	0	0	60	20
5	Muzikë	97	28	0	0	44	13
6	Bujqësi	111	11	95	99	134	8
7	Pedagogjike	570	436	406	294	605	474
8	Gjuhët e huaja	0	0	0	0	67	62
	Kuçovë	262	0	0	0	257	0
1	Motorist xhenerik	87	0	0	0	87	0
2	Hidrosanitar	92	0	0	0	89	0
3	Elektrik (3 vj.)	83	0	0	0	47	0
4	Elektrik (5 vj.)	0	0	0	0	34	0
	Skrapar	66	0	0	0	78	0
1	Mek. i përgj.	9	0	0	0	0	0
2	Hidrosanitar	57	0	0	0	47	0
3	Elektrik (3 vj.)	0	0	0	0	9	0
4	Elektrik (5 vj.)	0	0	0	0	22	0
	Qarku	1412	475	609	303	1576	577

Burimi: Këshilli i Qarkut

³²Këtu përfshihen edhe specialitetet e shkollave social-kulturore, si degët e mësuesisë, artit dhe të gjuhëve të huaja.



Arsyet e kësaj gjendjeje janë të shumta. Sistemi arsimor i mesëm profesional nuk është mjaftueshmërisht elastik përsa u përket degëve. Aktualisht ka degë të tilla si pedagogjia, e cila është hapur dhe mbyllur disa herë në qytetin e Beratit, apo gjuhët e huaja, për të cilat ka kërkesa për regjistrim, por ato konkurrohen lehtësisht nga ata që përfundojnë arsimin e lartë apo nga ata që përfundojnë arsimin e lartë dhe gjuhën e huaj e mësojnë në mënyrë autodidakte. Edhe struktura e degëve, gjithashtu, nuk u përgjigjet si duhet kërkesave të tregut të punës, ku kërkohen më shumë profesione të tilla si hotelieri, bar-restorant, elektroauto, riparim radio-tv, riparim pajisjesh elektrike, saldator, termohidraulik, kuzhinier, përpunim druri e duralumini, që përfaqësojnë profesione të kërkuara nga biznesi lokal.

Niveli i përvetësimit të kompetencave profesionale nga nxënësit në këto shkolla, gjithashtu, nuk përputhet ende me kërkesat e tregut të punës. Ka një sërë faktorësh që ndikojnë drejtpërdrejt në këtë nivel, të tilla si: (i) Niveli i nxënësve që regjistrohen në arsimin profesional është shumë më i ulët sesa niveli i nxënësve të regjistruar në arsimin e mesëm të përgjithshëm; (ii) Rezultatet e nxënësve në shkollat profesionale janë përgjithësisht të ulëta, si për lëndët teorike, ashtu edhe për praktikat profesionale. Për këto të fundit, ka mjaft fiktivitet në vlerësime; (iii) Gjendja fizike e shkollave lë shumë për të dëshiruar, baza materiale didaktike është e pamjaftueshme dhe nxënësit nuk kanë ku të zhvillojnë praktikën pranë shkollave të tyre, ndërkohë që bizneset nuk janë miqësore dhe mbështetëse për ta, mbasi nuk kanë asnjë stimul; (iv) Niveli i mësuesve specialistë dhe instruktorëve të praktikave, përgjithësisht është i ulët, si përsa i përket zotërimit të profesionit që trajtojnë, ashtu edhe nga pikëpamja didaktike. Kualifikimi paraprak si mësues nuk ekziston dhe trajnimi i vazhduar është i dobët; (v) Proçesi i vlerësimit përfundimtar të aftësive të nxënësve kryhet me fiktivitet të theksuar, duke bërë që certifikatat që ofrojnë shkollat profesionale të mos kenë reputacionin e duhur; dhe (vi) lidhjet e arsimit profesional me tregun e punës vazhdojnë të jenë ende mjaft të dobëta.

Përgjithësisht shkollat profesionale janë të vogla dhe, në mjaft raste, ato janë të inkuadruara në shkolla të tjera, duke mos patur as mjediset e nevojshme për praktikat profesionale. Veç faktorëve të tjerë, edhe kjo ka ndikuar që reputacioni i tyre të jetë në rënie të vazhdueshme. Opinioni i krijuar për mjaft degë të shkollave profesionale është se “janë pa perspektivë” dhe se “së shpejti do të mbyllen”. Përvoja e viteve të fundit e ka vërtetuar këtë. Duke qenë me potenciale të pakta materiale e njerëzore, shkollat e vogla e kanë të vështirë t’i përshtaten nevojave të tregut të kualifikimeve, gjithmonë në ndryshim, e kanë të vështirë të ndryshojnë specialitetet që ofrojnë, të krijojnë mekanizma për kërkim të nevojave në treg, përmirësim programesh të lëndëve, zhvillim të burimeve njerëzore, etj. Po kështu, në shkollat e vogla, raportit midis personelit ndihmës dhe atij mësimdhënës, është i lartë.

2.7 Masat me përparësi në arsim

Arsimi bazë

Drejtimet strategjike për zhvillimin e mëtejshëm të arsimit bazë janë: (i) Krijimi i kushteve për të rritur përfshirjen në arsimin bazë në zonën rurale, duke i dhënë përparësi përmirësimit të këtij treguesi në rrethin e Skraparit; (ii) Përmirësimi i raportit nxënës/mësues dhe nxënës/klasë në

shkollat e zonave urbane; (iii) Studimi i shpërndarjes optimale të shkollave dhe marrja e tij për bazë në përcaktimin e prioriteteve për investime; dhe (iv) Reformimi i sistemit të kualifikimit të mësuesve dhe motivimi i tyre, duke vendosur standarde të vlerësimit profesional.

Arsimi i mesëm

Drejtimet strategjike për zhvillimin e mëtejshëm të arsimit të mesëm të përgjithshëm janë: (i) Rritja e shkallës së përfshirjes së nxënësve që mbarojnë arsimin bazë, veçanërisht e nxënësve nga zonat rurale, dhe e shkallës së frekuentimit; (ii) Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies; (iii) Rritja e nivelit të kualifikimit të mësuesve dhe motivimi i tyre në përputhje me kualifikimin; dhe (iv) Përmirësimi i bazës materiale didaktike për disiplinat më kryesore.

Zhvillimi i mëtejshëm dhe konsolidimi i arsimit profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës mbetet një nga përparësitë më të rëndësishme të qarkut të Beratit. Për të realizuar objektivat strategjike të zhvillimit të arsimit profesional, shkollat profesionale të qarkut duhet të arrijnë t'i pajisin nxënësit me njohuri dhe aftësi të plota profesionale, të cilat do t'i lejojnë ata që të gjejnë vendin që u takon në një mjedis vazhdimisht në ndryshim. Sfidat kryesore për realizimin e këtyre objektivave mbeten rritja e tërheqjes së të rinjve në shkollat profesionale dhe rritja e shkallës së përvetësimit të shprehive të punës nga nxënësit.

Drejtimet strategjike për zhvillimin e mëtejshëm të arsimit të mesëm profesional³³ janë:

Optimizimi i arsimit profesional

Një nga drejtimet e mundshme të rritjes së frytshmërisë së arsimit profesional është rishpërndarja e institucioneve dhe e burimeve përkatëse me prirje drejt përqendrimit të shkollave profesionale. Ulja e numrit të shkollave dhe rritja e madhësisë mesatare të tyre do të sillte këto përfitime:

- (i) **Shfrytëzimin më të frytshëm të burimeve njerëzore.** Në një shkollë të madhe, shkalla e shfrytëzimit të ngarkesave mësimore të personelit mësimdhënës (mësues dhe instruktorë) është më e lartë sesa në shkollat e vogla. Po kështu, shkollat e mëdha krijojnë dhe mundësi më të mira për rritjen e numrit mesatar të nxënësve për klasë;

³³Duke qenë se kompetencat për disa prej masave që propozohen i tejkalojnë mundësitë e drejtorive arsimore të rretheve, zbatimi i tyre do të kërkonte mirëkuptimin dhe mbështetjen e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.



- (ii) **Shfrytëzimin më eficient të burimeve materiale.** Në shkollat e mëdha, mjediset mësimore teorike dhe praktike mund të shfrytëzohen plotësisht;
- (iii) **Rritjen e fleksibilitetit të shkollave.** Duke patur burime të konsiderueshme njerëzore e materiale, shkollat e mëdha e kanë më të lehtë të ndryshojnë shpejt orientimin (profilin apo specialitetin), në përputhje me ndryshimet e kërkesave të tregut lokal të punës;
- (iv) **Rritjen e mundësive për një integrim funksional të arsimit profesional me formimin profesional të të rriturve.** Shkollat profesionale rajonale, me bazë të fuqishme materiale e njerëzore, kanë kushte më të mira për hapjen dhe funksionimin e kurseve profesionale afatshkurtra për të rriturit. Këto shkolla do të luanin edhe rolin e qendrave të formimit. Kështu, do të krijoheshin një kategori nxënësish me kohë të pjesshme dhe koeficienti i shfrytëzimit të mjediseve dhe personelit do të rritej. Do të krijoheshin dhe burime financiare shtesë nga pagesat e kursantëve, të cilat do të përdorreshin për zhvillimin e infrastrukturës së shkollës, si dhe për kualifikimin e motivimin e personelit mësimdhënës e drejtues;
- (v) **Rritjen e mundësive për kryerjen e aktiviteteve ekonomike.** Një shkollë e madhe dhe e fuqishme, e ka më të lehtë të krijojë mundësi për realizim prodhimesh e shërbimesh të ndryshme, gjithmonë në kuadrin e përgatitjes profesionale të nxënësve. Kjo do të fuqizonte kompetencat e nxënësve, do të njëjtohej me zhvillimet e fundit në profesion, do të përmirësonte programet e lëndëve dhe mësimdhënien, si dhe do të forconte lidhjet e shkollës me partnerët dhe vetë tregun e punës. Kryerja e aktiviteteve ekonomike do të kontribuonte në gjenerimin e të ardhurave financiare.

Të gjitha këto do të krijonin mundësi që edhe elementet e tjera të reformës si: rritja e vëllimit të praktikave profesionale, integrimi i teorisë me praktikën etj, të zbatoheshin më me lehtësi. Po kështu, reputacioni i shkollave profesionale dhe tërheqja e nxënësve në to, do të ishte në rritje.

Një reformë e tillë mund të fillojë me rivlerësimin e gjendjes në shkollat ekzistuese profesionale dhe diskutimin e mundësisë dhe frytshmërisë të marrjes së këtyre masave: bashkimi i shkollës bujqësore “K. Isak” me shkollën profesionale “S. Bandilli”, veçimi i degës së Pedagogjisë, që aktualisht është në shkollën bujqësore; rikonstruksioni i ndërtesës së shkollës “K. Isak” dhe pajisja e saj; zgjerimi dhe rikonstruksioni i konviktit që të përdoret për të dy shkollat; rikonstruksioni i shkollës profesionale “M. Kepi” të Kuçovës dhe rikonstruksioni dhe pajisja e repartëve të punës për specialitetet e shërbimeve; rikonstruksioni dhe pajisja e konviktit; dhe mbyllja e shkollës profesionale në Poliçan, efektiviteti i së cilës është vënë në diskutim. Ky përqendrim do të kërkonte krijimin e konvikteve të përqendruara mbi bazë qarku, të cilat krijojnë mundësi për ulje të kostove dhe rritje të numrit të nxënësve, sidomos nga zonat rurale. Për shkak të largësive të konsiderueshme të zonave rurale nga shkollat profesionale dhe të vështirësive e kostove të transportit, aktualisht e vetmja mundësi për rritjen e tërheqjes së nxënësve nga fshati, është krijimi i konvikteve me kushte të përshtatshme, shoqëruar me dhënie bursash për fëmijët e familjeve të varfëra, që në fshat konsiderohen rreth 50% e totalit.

Rritja e llojshmërisë së ofertave për kualifikime profesionale

Është i njohur fakti që arsimi profesional është lloji i arsimimit kryesor të shtresave me nivel të ulët ekonomik dhe social. Por kohëzgjatja relativisht e madhe e kualifikimeve profesionale 3 dhe 5 vjeçare, bën që familjet e varfëra (sidomos në zonat rurale) të parapëlqejnë hyrjen e të rinjve në punë qoftë dhe me të ardhura minimale, se sa t'i dërgojnë të përvetësojnë një profesion në shkollën profesionale. Në fshat është rikthyer masivisht “çirakëria” familjare, ku të rinjtë që mbarojnë arsimin e detyruar ndihmojnë prindërit në punët e bujqësisë për të siguruar bukën e gojës. Ndaj, ulja e kohëzgjatjes së shkollimit dhe shtimi i niveleve për çdo specialitet, do të ndikojë për rritjen e tërheqjes në arsimin profesional. Shkollat profesionale, që aktualisht ofrojnë kualifikime të niveleve 3 dhe 5 vjeçare, duhet të ofrojnë dhe nivele të tjera me kohëzgjatje më të vogël, 1 dhe 2 vjeçare, pa përfshirur këtu kurset speciale, akoma më të shkurtra. Një mundësi tjetër akoma e pashfrytëzuar është dhe krijimi në shkollat profesionale të niveleve pas-sekondare (1-2 vjeçare) për ata që mbarojnë arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe që nuk vazhdojnë shkollimin universitar. Në nivel vendi, këta përbëjnë rreth 25% të grup-moshës përkatëse dhe përballen me kërkesat e tregut të punës pa patur asnjë lloj kualifikimi profesional të njohur zyrtarisht. Fakti që e kanë marrë dëftesën e pjekurisë, u jep atyre mundësinë që, me një shkollim profesional të posaçëm 1-2 vjeçar, të mund të fitojnë dhe një certifikatë kualifikimi profesional të njohur zyrtarisht, që rrit mundësitë e tyre për punësim.

Aktualisht, shkollimi profesional 3 vjeçar nuk ofron dëftesë pjekurie, pra nuk njihet si shkollim i nivelit të mesëm dhe kjo ka një efekt psikologjik mjaft negativ në shumicën e popullsisë. Në shumë punësime, sidomos në sektorin shtetëror, kërkohet dëftesa e pjekurisë. Në një farë mase, kjo shpjegon dhe pjesëmarrjen e ulët në shkollimet tre-vjeçare. Kohët e fundit, hapja e specialitetit të agrobiznesit 5 vjeçar në shkollat bujqësore, bëri që këto të rigjallëroheshin. Kjo nuk do të thotë që duhet të hapen vetëm specialitete 5 vjeçare, por duhet të krijohet mundësia që edhe ata që përfundojnë shkollimet profesionale 3 vjeçare të marrin dëftesën e pjekurisë.

Po kështu, ndikim pozitiv do të ketë dhe futja e specialiteteve të reja, në përgjigje të zhvillimeve në tregun e punës. Në listën aktuale të kualifikimeve profesionale, ka nevojë për integritime apo ndarje të specialiteteve, psh, kualifikimi profesional “mekanik automobilash”, 3 vjeçar, mund të ndahet në tre specialitete më të ngushta 3 vjeçare: “motorist”, “xhenerik” dhe “elektroauto”. Njëkohësisht, mund të hapen specialitete të reja si tregti, hoteleri, turizëm, kopshtari, etj. Sigurisht, këto kërkojnë një analizë më të detajuar nga ana e specialistëve të fushave përkatëse. Konkluzion i përgjithshëm është që arsimi profesional në nivel qarku ka nevojë ta shtojë gamën e kualifikimeve profesionale që ofron, në drejtime të tilla që përputhen edhe me prirjet e zhvillimit ekonomik e shoqëror të qarkut të përcaktuara në kapitullin 1.7. Në mënyrë të veçantë, ky zgjerim duhet të marrë në konsideratë :

- (i) Shfrytëzimin e vlerave turistike, ku përparësi të veçantë kërkohet t'u jepet investimeve për infrastrukturën rrugore, restaurimet, hotelet dhe turizmin familjar, si dhe zhvillimit të një sistemi informacioni bashkëkohor për rritjen disa herë të numrit të turistëve;



- (ii) Shtirirjen e sektorit të shërbimeve edhe në zonat rurale. Aktualisht në këto zona, rreth 60% e familjeve kanë televizorë me ngjyra, rreth 65% frigoriferë, 15% makina larëse, 30% stufa elektrike dhe 5% kanë automobila. Pritet një rritje e përdorimit të mjeteve të tilla për shkak të urbanizimit të mënyrës së jetesës dhe rritjes graduale të nivelit të saj, e për pasojë pritët një rritje e kërkesës për shërbimet e riparimit të pajisjeve elektroshtëpiake dhe automobilave;
- (iii) Futjen graduale të proceseve bujqësore të mekanizuara, që do të rikthejnë nevojën për shërbimet e riparimit dhe mirëmbajtjes së makinave bujqësore;
- (iv) Prirjen për shtimin e bizneseve të vogla që veprojnë në fushën e përpunimit të produkteve bujqësore.
- (v) Zhvillimin e shpejtë të ndërtimeve në zonat urbane dhe rurale në sasi e cilësi. Kjo do të rrisë nevojën për specialistë të punimeve të ndryshme të ndërtimit, sidomos për elektriciqistë, instalues hidraulikë, shtrues pllakash, prodhues të dyerve, dritareve e orendive shtëpiake.

Rritja e autonomisë financiare

Rritja e autonomisë financiare është një masë parësore që do të ndihmonte zhvillimin e shpejtë të arsimit profesional. Kjo kushtëzohet nga disa ndryshime në legjislacionin ekzistues, për t'u dhënë shkollave profesionale një status të ri, të ngjashëm në shumë aspekte me organizmat e biznesit.

Objektivi 2: Shtimi i mundësive për shkollim

SYNIMI 3 Të sigurohet që brenda vitit 2015, të gjithë fëmijët të kenë mundësi të kryejnë arsimin bazë.

Treguesi 9 Norma neto e regjistrimit

	2002		2006	
	Gjithsej	Fshat	Gjithsej	Fshat
Cikli i ulët %	96	95	97	96
Cikli i lartë %	98	87	99	92

Treguesi 10 Raporti nxënës / mësues

	2002		2006	
	Gjithsej	Fshat	Gjithsej	Fshat
Cikli i ulët	20	18	20	18
Cikli i lartë	16	15	16	15

Treguesi 11 Raporti nxënës / klasë

	2002		2006	
	Gjithsej	Fshat	Gjithsej	Fshat
Cikli i ulët	21	18	20	16
Cikli i lartë	24	22	22	18

Treguesi 12 Shkalla e frekuentimit

	2002		2006	
	Gjithsej	Fshat	Gjithsej	Fshat
Cikli i ulët %	99	98	99	98
Cikli i lartë %	98	98	98	98

Treguesi 13 Kalueshmëria

	2002		2006	
	Gjithsej	Fshat	Gjithsej	Fshat
Arsimi bazë %	94	95	95	95

Treguesi 14 Nxënës në klasa të kombinuara në fshat

	2003	2006
Berat %	19.3	10.0
Kuçovë %	5.2	2.5
Skrapar %	71.6	45.0

Treguesi 15 Mësues me arsimin përkatës në shkollat 8 vjeçare

	2003		2006	
	Qytet	Fshat	Qytet	Fshat
Berat %	94.6	76.8	100.0	88.0
Kuçovë %	97.7	92.5	100.0	100.0
Skrapar %	90.5	61.3	100.0	85.0

synimet dhe treguesit

Treguesi 16	Nxërës që braktisin shkollën në arsimin bazë	
	2003	2006
Berat	249	100
Kuçovë	63	10
Skrapar	12	12

Treguesi 17	Nxërës me prapambetje të theksuar në arsimin bazë			
	2003		2006	
	Qytet	Fshat	Qytet	Fshat
Berat%	1.9	7.3	0.0	3.0
Kuçovë %	2.0	19.0	0.0	10.0
Skrapar%	0.5	9.2	0.0	5.0

SYNIMI 4 Të sigurohet rritja e përfshirjes të nxënësve në arsimin e mesëm

Treguesi 18	Shkalla e përfshirjes në arsimin mesëm	
Rrethi	2003	2006
Berati %	67.5	72
Kuçova %	83.0	83
Skrapari %	81.0	81

Treguesi 19	Nxërës të regjistruar që përfundojnë arsimin e mesëm	
Rrethi	2003	2006
Berati %	85	90
Kuçova %	80	86
Skrapari %	96	96

Treguesi 20	Mësues me arsimin përkatës në arsimin mesëm	
Rrethi	2003	2006
Berati %	n.a	100
Kuçova %	95	100
Skrapari %	88	95

SYNIMI 5 Përmirësimi i raportit të arsimit të mesëm të përgjithshëm me atë profesional

Treguesi 21	Raporti arsim mesëm i përgjithshëm/ arsim i mesëm profesional	
	2003	2015
Përfshirja në arsimin profesional e nxënësve të zonës urbane %	16	35
Përfshirja në arsimin profesional e nxënësve të zonës rurale %	2	18

Nxitja e barazisë gjinore

“Nxitja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i rolit të gruas” është Objektiv i tretë i Mijëvjeçarit për Zhvillimin. Eliminimi mundësisht deri në vitin 2005, i dallimeve gjinore në arsimin fillor e të mesëm, dhe deri në vitin 2015 në të gjitha nivelet e arsimit, është synimi më kryesor i këtij objektiv. Ky synim lidhet me raportin e vajzave me djemtë në arsimin fillor, tetëvjeçar e të mesëm, si dhe me punësimin dhe rolin e gruas në vendimmarrje. Sipas analizave në nivel kombëtar, del se Shqipëria mundet ta përmbushë këtë objektiv dhe se shkalla e mbështetjes së politikave, kuadrit ligjor, burimeve të financimit, ndërgjegjësimit të publikut etj. për ta përmbushur atë deri në vitin 2015 është normale.

3.1 Treguesit gjinorë

Femrat zënë 49.5% të popullsisë së qarkut të Beratit. Pjesa e popullsisë së qarkut që banon në zonën rurale është më e madhe krahasuar me strukturën e popullsisë në shkallë vendi. Kështu, 60.2% e popullsisë së qarkut jeton në fshat krahasuar me 57.8% që është mesatarja e popullsisë fshatare në shkallë vendi. Rrethi i Beratit dhe Skraparit dallohen për përqindjen më të lartë të popullsisë rurale krahasuar me dy rrethet e tjera. Si rrjedhim, edhe pjesa më e madhe e femrave të këtyre rretheve jeton në fshat.

Jetëgjatësia mesatare në shkallë qarku është 74.5 vjeç ndërsa për femrat 76.2 vjeç. Përgjithësisht nuk ka ndryshime të mëdha në treguesin e jetëgjatësisë së tre rretheve të qarkut. Jetëgjatësia më e lartë për femrat vërehet në rrethin e Beratit dhe është 76.3 vjeç.

Indeksi i Zhvillimit Gjinor mat pabarazinë midis grave dhe burrave, nga këndvështrimi i aftësive bazë dhe të kushteve të jetesës, duke u mbështetur në ndryshore të tilla si jetëgjatësia, arsimimi dhe të ardhurat. Sipas llogaritjeve, Indeksi i Zhvillimit Gjinor në shkallë vendi, i bazuar në të dhënat e vitit 2001, është 0.758 dhe Shqipëria renditet e 61-ta në klasifikimin e Kombeve të Bashkuara për 173 vende që e llogarisin këtë indeks, duke u përfshirë në grupin e vendeve me nivel të mesëm zhvillimi gjinor. Ndërsa Indeksi i Fuqizimit Gjinor fokusohet në mundësitë që u janë krijuar grave për të treguar aftësitë e tyre dhe për të marrë pjesë gjallërisht në jetën politike, ekonomike dhe në vendimmarrje, duke shqyrtuar veçanërisht pjesëmarrjen e tyre në jetën politike, ekonomike dhe profesionale. Ky tregues përqendrohet në tre ndryshore që pasqyrojnë pjesëmarrjen e gruas në vendimmarrjen politike, mundësia për të ushtruar aftësitë profesionale dhe të ardhurat që ato kanë. Sipas llogaritjeve, Indeksi i Fuqizimit Gjinor në shkallë vendi, i bazuar në të dhënat e vitit 2001, është 0.422 dhe Shqipëria renditet e 58-ta në klasifikimin e Kombeve të Bashkuara për 173 vende që e llogarisin këtë indeks, duke u përfshirë në grupin e vendeve me nivel të mesëm zhvillimi gjinor.³⁴

³⁴ UNDP (HDPC), Raporti i Zhvillimit Njerëzor-Shqipëria 2002.

Qarku i Beratit e ka Indeks të Zhvillimit Gjnjor 0.762, duke u renditur në vendin e pestë ndër 12 qarqet e vendit, ndërsa Indeks të Fuqizimit Gjnjor e ka 0.545 dhe renditet në vendin e katërt. Sipas këtyre vlerave, qarku konsiderohet me nivel të mesëm të zhvillimit dhe fuqizimit gjnjor.

3.2 Arsimimi i femrave

Berati dallohet për tradita në fushën e arsimit dhe të kulturës. Kjo lidhet si me historinë mijëvjeçare të qytetit të Beratit, ashtu edhe me karakteristikat e zhvillimit ekonomik të qarkut, që kanë diktuar nevojën për specialistë të mesëm dhe të lartë të profesioneve të ndryshme.

Kultura arsimdashëse e qarkut shprehet edhe në shkollën e lartë të përfshirjes së nxënësve në arsim dhe veçanërisht të femrave. Kështu, në shkollë qarku, në arsimin bazë mësojnë 14,344 vajza, nga të cilat rreth 59.2% në fshat. Në shkollat e mesme mësojnë 4,476 vajza ose 53.2% e numrit të përgjithshëm të nxënësve të regjistruar në shkollën e mesme.

Anketimi Kombëtar për Matjen e Nivelit të Jetesës i vitit 2002 i përgatitur nga Banka Botërore dhe INSTAT konkludoi se në nivel vendi nuk ka dallime të ndjeshme gjnjore në normat e regjistrimit në shkollë të fëmijëve. Në Shqipëri, Ligji mbi Arsimin u garanton të drejtën e barabartë për shkollim si djemve ashtu edhe vajzave. Arsimi fillor është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët, pavarësisht nga gjinia, dhe nuk ekzistojnë ndryshime të mëdha në ndjekjen e shkollës mes dy sekseve. Numri total i nxënësve që ndoqën shkollën gjatë vitit akademik 2000-2001 ishte 684,270 dhe nga këta 49.4% ishin vajza.

Femrat japin një kontribut të rëndësishëm në sistemin arsimor të qarkut. Ato përfaqësojnë rreth 54% të mësuesve në shkollat fillore vartëse, rreth 59% të mësuesve në shkollat 8 vjeçare dhe rreth 52% të mësuesve në shkollat e mesme. Femrat zënë pjesën më të madhe të numrit të mësuesve në shkollat e qyteteve, ndërsa në shkollat e fshatit numri i mësuesve femra dhe meshkuj është pothuaj i barabartë. Në pesë qytetet e qarkut, rreth 75% e mësuesve janë femra, ndërsa në shkollat e zonës rurale janë femra rreth 50% e mësuesve. Numri më i vogël i femrave mësuese në shkollat e zonave rurale lidhet me numrin e kufizuar të femrave me banim në fshat që studiojnë për mësuesi dhe me numrin e vogël të femrave me banim në qytet që shkojnë të punojnë në shkollat e fshatit.

Në shkollë qarku, norma neto e regjistrimit në ciklin e lartë të shkollës 8-vjeçare është përkatësisht 96% dhe 98%. Për femrat, ky tregues është rreth 94% dhe 96% dhe ndikohet shumë nga norma më e ulët e regjistrimit të femrave në fshat në ciklin e lartë të shkollës 8-vjeçare, që është rreth



88%. Treguesi i frekuentimit të nxënësve në arsimin bazë (cikli i lartë) në shkallë qarku është 98%, si për fshatin ashtu edhe për qytetin dhe nuk ka dallime të dukshme midis meshkujve dhe femrave. Ndërsa në arsimin e mesëm, norma e frekuentimit në fshat është më e ulët, rreth 87%, por norma e frekuentimit të femrave është e lartë (shih tabelën 3.1). Në rastin e femrave, arsyeve të përgjithshme të dallimit midis fshatit dhe qytetit u shtohen edhe mentaliteti kufizues i familjeve për vajzat dhe martesat e hershme të vajzave.

tabela 3.1 Tregues të arsimit në qarkun e Beratit, 2001-2002

	Gjithsej	Femra	Fshat	Femra
Frekuentimi në arsimin bazë (%)	98	98	98	99
Frekuentimi në arsimin e mesëm (%)	95	99	87	99
Raporti neto i regjistrimit CU (%)	96	94	95	93
Raporti neto i regjistrimit CL (%)	98	96	87	88
Kalueshmëria në arsimin 8 vjeçar (%)	95	96	94	95

Fenomeni i braktisjes së shkollës haset më shumë tek djemtë sesa tek vajzat. Kështu, në rrethin e Skraparit, nga nxënësit braktisës të vitit shkollor 2002-2003, të cilët janë pothuajse të gjithë nga fshati, vetëm 25% kanë qenë vajza. Në vitin shkollor 2000-2001, femrat zinin rreth 33% të numrit të nxënësve braktisës, gjë që tregon se numri i vajzave që braktisin shkollën është zvogëluar nga viti në vit.

Prapambetja e theksuar në mësim është gjithashtu një fenomen i hasur më shumë tek djemtë sesa tek vajzat. Në shkallë qarku, në vitin shkollor 2002-2003, vetëm 36.5% e nxënësve që shfaqën prapambetje të theksuar në mësim ishin femra dhe nuk ka ndryshime të dukshme ndërmjet rretheve.

tabela 3.2 Nxënës me prapambetje të theksuar në arsimin 8 vjeçar

	Nxënës me prapambetje	
	Gjithsej	Femra %
Berat	1,109	34.4
Kuçovë	528	41.7
Skrapar	197	34.5
Qarku	1,834	36.5

Përfundime të ngjashme nxirren edhe nga analiza e fenomenit të analfabetizmit, i cili pothuajse u zhduk deri në fillim të vitit 1990, por ka filluar të rishfaqet gjatë viteve të tranzicionit, veçanërisht në zonat e thella rurale. Analfabetizmi në qarkun e Beratit nuk mund të quhet fenomen gjinor. Ai më shumë sesa me gjininë lidhet me kushtet social-ekonomike të familjes, si dhe me mundësinë praktike të ndjekjes së shkollës, pavarësisht që në zona të veçanta ka filluar të dallohen shenja konservatorizmi dhe mentaliteti frenues ndaj shkollimit të vajzave. Zhvillimi i mësimin në klasa të kombinuara, si dhe fenomenet e braktisjes së shkollës dhe të prapambetjes së theksuar në mësim, janë faktorë që bëhen shkak për të shtuar numrin e popullsisë analfabete.

Megjithatë, shifrat e analfabetizmit në popullsinë mbi 15 vjeç si dhe grupmoshën 15-24 vjeç në shkallë qarku janë pak më të larta për femrat krahasuar me meshkujt (shih tabelën 3.3). Ndryshimi më i madh midis meshkujve dhe femrave vihet re në rrethin e Beratit, ku analfabetizmi tek femrat e moshës mbi 15 vjeç është rreth 3.3%, nga rreth 2.5% që është mesatarja e rrethit. Vlerat më të ulëta të këtij treguesi janë në rrethin e Kuçovës.

Për grupmoshën 15-24 vjeç, niveli i analfabetizmit në përgjithësi është më i ulët, si në shkallë qarku, ashtu edhe në secilin rreth. Në këtë grupmoshë, numri i femrave analfabete është më i vogël se ai i meshkujve.

tabela 3.3 Popullsia që nuk di shkrim dhe këndim

Rrethi	Analfabetizmi në %					
	Gjithsej	Femra	Në popullsinë mbi 15 vjeç		Në popullsinë 15-24 vjeç	
			Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Berat	2.9	3.6	2.44	3.31	1.03	0.90
Kuçovë	0.9	1.1	0.76	0.99	0.51	0.36
Skrapar	0.9	1.1	0.74	1.01	0.37	0.31
Qarku	2.2	2.7	1.86	2.52	0.84	0.71
Vendi	1.6	1.9	1.29	1.75	0.56	0.50

Burimi: HDPC mbështetur në të dhënat e Repoba 2001

3.3 Punësimi i femrave

Specifikat e zhvillimit ekonomik të qarkut të Beratit, si para ashtu edhe pas vitit 1990 (shih kapitullin 1.2), kanë ndikuar në shkallën e punësimit të femrave. Rrethi i Beratit, përpara viteve '90, ka patur tradita në industrinë e tekstitit dhe atë të përpunimit të frutave dhe perimeve, ku numri më i madh i të punësuarve ishte femra. Rrethi i Kuçovës dhe rrethi i Skraparit, përveç industrisë së naftës dhe industrisë mekanike, janë karakterizuar nga tradita të hershme në kultivimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale, frutave dhe perimeve. Si rrjedhim, në këtë periudhë, shkalla e pjesëmarrjes së femrave në veprimtaritë prodhuese ka qenë e lartë. Pas vitit 1990, pothuajse të gjitha këto ndërmarrje e ndërprejnë punën, duke sjellë një papunësi masive, veçanërisht tek femrat.

Në tregun e punës në shkallë qarku, femrat përfaqësojnë rreth 42.8% të forcave të punës, pak më shumë se vlera mesatare e këtij treguesi në shkallë vendi (shih tabelën 3.4). Papunësia për femrat është shumë më e lartë se për meshkujt, si për qarkun, ashtu edhe për secilin rreth të tij. Papunësia më e lartë për femrat është në rrethin e Kuçovës, rreth 34.2%, gjë që shpjegohet nga njëra anë me shkallën e lartë të urbanizimit të këtij rrethi dhe nga ana tjetër, me zhvillimin e paktë të sektorit privat, pas ndërprerjes së punës nga ndërmarrjet shtetërore. Kjo tendencë përgjithësisht është e njëjtë me atë të rajoneve të tjera të vendit, gjë që shprehet qartë në vlerat e këtyre treguesve në shkallë vendi. Anketimi kombëtar për matjen e nivelit të jetesës i vitit 2002 provon që, ka ndryshime të ndjeshme gjinore në tregun e punës. Vetëm 23% e femrave të punësuar raportojnë se kanë punë të përhershme, krahasuar me 45% tek burrat.



tabela 3.4 Aspekti gjinor në tregun e punës

	Berat	Kuçovë	Skrapar	Qarku	Vendi
Forca e punës (000)	62.9	16.2	15.3	94.4	1,347.3
Femra %	42.7	41.2	44.9	42.8	40.6
Punësimi (000)	51.4	12.1	12.7	76.2	1,041.8
Femra %	39.9	36.3	42.5	39.8	37.6
Papunësia %	18.3	25.4	16.9	19.3	22.7
Femra %	22.0	34.2	21.3	25.0	28.4

Burimi: Repoba 2001

Përqindja e grave të punësuar në sektorin jobujqësor është një nga treguesit që lidhet me objektivin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e rolit të gruas. Një pjesëmarrje e madhe dhe aktive e gruas në sektorin jobujqësor, jo vetëm lejon shfrytëzimin e potencialeve të saj, por ndikon ndjeshëm në rritjen e kontributit dhe pavarësisë së saj në familje dhe shoqëri. Në qarkun e Beratit përqindja e grave që punojnë në bujqësi në zonat rurale është shumë më e lartë se përqindja e grave që punojnë në sektorët jobujqësorë në zonat urbane. Aktualisht në sektorët bujqësorë punojnë rreth 60% e femrave, ndërsa rreth 40% janë të punësuar në sektorin jobujqësor.

Në zonën urbane, femrat përfaqësojnë rreth 46.8% të popullsisë aktive. Papunësia e femrave në 5 qytetet e qarkut është 45.7%, nga 35.7% që është vlera mesatare e papunësisë së këtyre qyteteve (shih tabelën 3.5). Papunësia më e lartë e femrave vihet re në qytetin e Urës Vajgurore dhe të Kuçovës, përkatësisht 62.2% dhe 49.8%, ku mundësitë e punësimit në përgjithësi janë shumë të kufizuara.

tabela 3.5 Treguesit e punësimit në qytetet kryesore

	Berat	Ura Vajgurore	Kuçovë	Çorovodë	Poliçan
Papunësia %	35.6	43.2	36.9	32.3	30.8
Femra	46.9	62.2	49.8	46.2	38.4
Meshkuj	25.6	26.2	25.2	20.4	24.0

Burimi: Repoba 2001

Femra ka të punësuar në të gjithë sektorët (shih tabelën 3.6). Ato luajnë një rol të rëndësishëm në sektorin bujqësor, ku në shkallë qarku përfaqësojnë 41.3% të të punësuarve në këtë sektor. Femrat mbizotërojnë në arsim dhe shëndetësi, ku zënë përkatësisht 60.9% dhe 77.1% të të punësuarve gjithsej. E njëjta prirje vihet re në secilin nga rrethet përbërëse të qarkut. Shumë më pak femra janë të punësuar në sektorët jobujqësorë prodhues, të tillë si industri e sidomos ndërtim.

tabela 3.6 Punësimi i femrave sipas sektorëve³⁵

Rrethi	Bujqësi	Industri	Ndërtim	Tregti	Hotele	Transport	Arsim	Shëndetësi	Të tjera
Berat gjithsej	32,777	1,328	478	1,130	272	750	1,669	895	12,132
Femra %	41.1	26.1	4.6	33.0	36.4	15.7	60.1	77.4	63.8
Kuçovë gjithsej	5,865	1,345	120	332	85	182	449	221	3,478
Femra %	37.1	15.9	3.3	40.1	55.3	21.4	73.7	73.8	36.9
Skrapar gjithsej	7,387	1,045	50	214	98	195	559	335	2,841
Femra %	45.3	37.0	10.0	36.9	40.8	22.6	52.8	78.5	33.5
Qarku gjithsej	46,029	3,718	648	1,676	455	1,127	2,677	1,451	18,451
Femra %	41.3	25.5	4.8	34.9	40.8	17.8	60.9	77.1	35.9

Burimi: HDPC mbështetur në të dhënat e Repoba 2001

³⁵Të dhënat u referohen vetëm të punësuarve që e kanë deklaruar se në cilin sektor punojnë.

Profesionet, ku punësimi i femrave është në nivele të përafërta me meshkujt, janë nëpunës i thjeshtë, punëtorë të shërbimeve, shitblerjeve dhe dyqaneve, si dhe punëtorë të zanateve të ndryshme (shih tabelën 3.7). Profesionet, ku femrat kanë nivel mjaft të ulët punësimi janë ligjvënës, nëpunës të lartë dhe drejtues, si dhe teknikë dhe ndihmës specialistë, ku femrat zënë përkatësisht 2.7% dhe 8.7% të të punësuarve gjithsej.

tabela 3.7 Niveli i punësimit te femrave në profesionet kryesore

Profesioni	Të punësuarit femra %
Ligjvënës, nëpunës të lartë dhe drejtues	2.7
Specialistë	26.4
Teknikë dhe ndihmës specialistë	8.7
Nëpunës të thjeshtë	53.2
Punëtorë të shërbimeve, shitblerjeve dhe dyqaneve	44.8
Punëtorë të kualifikuar të bujqësisë dhe peshkimit	36.9
Zejtarë dhe punëtorë të zanateve të ndryshme	41.3
Operatorë të makinave dhe montues në uzina	29.6
Punëtorë të pakualifikuar	26.0
Mbrojtja	39.9
Gjithsej	39.8

Burimi: Këshilli i Qarkut

Përgjithësisht mund të thuhet se ekziston një lidhje e fortë ndërmjet nivelit të shkollimit dhe sektorit të punësimit të femrave (shih tabelën 3.8). Kështu 81.6% e të punësuarve gjithsej në bujqësi janë me shkollë fillore dhe 43.3% e tyre janë femra. Po kështu, 57.2% e të punësuarve në industri dhe 91% e të punësuarve në administratën publike janë me shkollë të mesme dhe të lartë dhe përkatësisht 50% dhe 24% e tyre janë femra.

Megjithëse femrat punojnë në të gjithë sektorët, për të gjitha nivelet e shkollimit ato zënë një peshë specifike më të vogël sesa meshkujt.

SKZHES parashikon zbatimin e politikave aktive për punësimin. Në këto politika përfshihen vazhdimi i programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet trajnimeve profesionale, si dhe përmirësimi i shërbimeve të ndërmjetësimit të punësimit. Strategjia përcakton si synim të saj që nga programet aktive të punësimit do të përfshihen të papunët e varfër dhe



të papunët e rrezikuar, si gratë dhe të rinjtë. Megjithatë, SKZHES mbetet në një shkallë të gjerë në nivelin konstatues lidhur me çështjet gjinore dhe ende nuk përmban masa konkrete që trajtojnë punësimin e femrës. Raporti i progresit i SKZHSE ka treguar shenjat e para të vëmendjes ndaj aspekteve gjinore lidhur me disa çështje të trajtuara në të. Por, pavarësisht nga përpjekjet për të përfshirë organizatat jo qeveritare të grave në procesin e konsultimeve rajonale, SKZHES i mungon përmasa gjinore dhe nuk ka asnjë tregues gjinor që lidhet me problematikën aktuale të gruas.

tabela 3.8 Punësimi sipas sektorëve dhe nivelit të shkollimit

Degët e Ekonomisë	Niveli i shkollimit						Gjithsej
	Pa diplomë	Filllore	8-vjeçare	E mesme e përgjithshme	E mesme profesionale	Universitare/pasuniversitare	
Gjithsej	1,201	48,650	2,731	12,105	7,442	4,103	76,232
<i>Femra (%)</i>	44.5	41.7	32.6	38.8	31.2	39.5	39.8
Bujqësi	729	37,571	915	4,934	1,720	161	46,030
<i>Femra (%)</i>	50.6	43.3	27.9	32.3	28.7	18.0	41.3
Aktivitete të tjera	32	1,122	250	774	879	195	3,252
<i>Femra (%)</i>	34.4	40.1	26.4	37.1	21.8	16.4	31.9
Industri	232	5,161	909	3,469	2,659	2,297	14,727
<i>Femra (%)</i>	35.3	36.7	40.7	50.0	40.5	48.4	42.6
Tregti	144	3,232	434	1,559	1,234	309	6,912
<i>Femra (%)</i>	34.7	37.9	35.0	42.5	28.3	30.7	36.7
Transport dhe Komunikacion	60	1,403	187	733	529	158	3,070
<i>Femra (%)</i>	35.0	29.7	23.5	35.3	22.3	36.1	29.8
Kredit dhe Sigurime	1	8	1	30	21	69	130
<i>Femra (%)</i>	0	38	0	70	67	54	58
Administratë Publike	3	153	35	606	400	914	2,111
<i>Femra (%)</i>	66.7	16.3	11.4	21.3	19.5	28.3	23.5

Femrat në pozicione drejtuese

Numri i femrave në pozicione drejtuese është i vogël si në shkallë qarku ashtu edhe për secilin rreth (shih tabelën 3.9). Kështu, në shkallë qarku vetëm 14% e të punësuarve në pozicione drejtuese janë femra dhe shifrat janë pothuaj në të njëjtat nivele në të tre rrethet. Shifrat janë disi më të larta për femrat në pozicione punëdhënëse dhe të vetëpunësuarra, të cilat në shkallë qarku përfaqësojnë përkatësisht rreth 37.4% dhe 37.8% të punonjësve gjithsej që ndodhen në këto pozicione.

tabela 3.9 Femra në pozicione drejtuese

në %

	Femra në pozicione drejtuese	Femra punëdhënëse	Femra të vetëpunësuar
Berat	14.1	37.8	37.4
Skrapar	14.3	36.0	44.0
Kuçove	17.5	37.4	31.6
Qarku	14.0	37.4	37.8
Vendi	20.9	25.4	37.6

Burimi: HDPC mbështetur në të dhënat e Repoba 2001

3.4 Femrat në strukturat vendimmarrëse

Pjesëmarrja e gruas si në politikë ashtu edhe në organet vendimmarrëse në shkallë vendi është mjaft e ulët dhe kjo pasqyrohet edhe në të dhënat e qarkut të Beratit. Në të tre rrethet e qarkut, femrat që militojnë në partitë politike kryesore përfaqësojnë nga 16% në 32% të anëtarësisë gjithsej dhe më e madhe kjo shifër është në rrethin e Beratit. Numri i femrave të zgjedhura në strukturat drejtuese të degëve të partive politike kryesore parlamentare në këto rrethe ndryshon nga 22% në 28% e të zgjedhurve gjithsej. Në përgjithësi ndihet një rezistencë e madhe në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes së gruas në nivele të ndryshme të përfaqësimit politik dhe sidomos në drejtim të përcaktimit të kuotave detyruese për strukturat partiake në lidhje me pjesëmarrjen e femrave. Një propozim i bërë në një nga partitë kryesore për vendosjen e kuotës së përfaqësimit prej 30%, mbështetur me tezën “një parti pa femra është një gjysmëparti”, u hodh poshtë jo vetëm nga meshkujt, por edhe nga shumica e femrave të zgjedhura në forumet drejtuese të kësaj partie.

tabela 3.10 Femrat në organet e pushtetit vendor

	1992		1996		2000		2003	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Kryetarë bashkie	5	0	5	1	5	0	5	0
Kryetarë të këshillit bashkiak	5	1	5	0	5	0	5	0
Kryetarë komune	20	0	20	0	20	0	20	0
Kryetarë të këshillit të komunës	20	0	20	0	20	0	20	0
Drejtues fshati	233	1	233	1	232	1	232	1
Këshilli bashkiak	67	6	73	7	111	17	109	16
Këshilli i komunës	246	4	261	6	289	11	287	18
Totali	606	12	627	15	692	29	688	35

Burimi: HDPC

Gjendja është e njëjtë edhe në strukturat e zgjedhura të pushtetit vendor (shih tabelën 3.10). Në qarkun e Beratit asnjë kryetar bashkie, kryetar i këshillit bashkiak, kryetar komune dhe kryetar i këshillit të komunës nuk është femër. Kjo gjendje vihet re pothuajse në të gjitha legjislaturat që nga viti 1992 dhe deri në zgjedhjet vendore të vitit 2003. Nga 232 kryetarë fshati që ka qarku,



vetëm një është grua. Niveli i përfaqësimit, megjithëse mbetet shumë i ulët, ka ardhur duke u rritur në këshillat bashkiake dhe ato të komunës. Kështu, në zgjedhjet vendore të vitit 1992, 3.2% e këshilltarëve gjithsej ishin femra, ndërsa në zgjedhjet vendore të vitit 2003 kjo shifër u rrit në 8.5% dhe është më e larta në të gjitha zgjedhjet vendore.

Anketimi në shkallë vendi i kryer në kuadrin e projektit “Gruaja në drejtim” mbi pozicionin e gruas në jetën politike dhe sociale të vendit tregoi që sistemi i kuotës për pjesëmarrjen e gruas në politikë dhe vendimmarrje është një instrument i rëndësishëm, megjithëse jo i vetmi. Konkretisht, në qarkun e Beratit, 34.9% e të anketuarve mendojnë që kuota është mënyra e duhur, 48.8% mendojnë që kjo është një nga mënyrat dhe vetëm 9.3% mendojnë që kuota është element diskriminimi ndaj gruas.

Përfaqësimi i femrës është më i lartë në këshillat bashkiake sesa në këshillat e komunave. Kjo lidhet në radhë të parë me mentalitetin në zonat rurale mbi rolin e femrës. Lidhet, gjithashtu, me numrin gjithnjë e më të vogël të femrave të arsimuara në fshatrat e qarkut, si rezultat i largimit masiv të njerëzve. Kështu, në rrethin e Skraparit, asnjë komunë nuk ka më shumë se 51 banorë me arsim të lartë ndërsa ka fshatra të tëra të cilët nuk kanë asnjë person me arsim të lartë (shih tabelën 3.11). Gjithashtu, në rrethin e Beratit vetëm 50% e komunave kanë më shumë se 51 banorë me arsim të lartë. Ulja e numrit të banorëve të arsimuar sjell edhe uljen e cilësisë së kandidatëve për organet drejtuese vendore, si dhe një shkallë gjithnjë e më të ulët të femrave në to.

Niveli i ulët i pjesëmarrjes së femrave në strukturat drejtuese të pushtetit vendor në shkallë qarku vihet re edhe në shkallë vendi. Në kabinetin qeveritar ka vetëm një femër ministër. Në Parlamentin Shqiptar ka vetëm nëntë femra deputete, dy prej të cilave janë nënkryetare të Kuvendit Popullor, ndërsa asnjë kryetar i grupeve parlamentare apo kryetar i komisioneve parlamentare nuk është femër. Shifrat tregojnë që nga njëra anë, përfaqësimi i femrës në politikë po pakësohet gjithnjë edhe më shumë dhe nga ana tjetër, nuk po bëhen përpjekje minimale për të ndryshuar gjendjen. Zgjedhjet vendore të vitit 2003 shfaqën rastin më të keq të kandidimit të grave. Asnjë femër në asnjë bashki nuk u kandidua për kryetare bashkie nga asnjë forcë politike.

tabela 3.11 Numri i personave me arsim të lartë sipas komunave

Komuna	Berat	Kuçovë	Skrapar	% ndaj totalit
< 20 banorë me arsim të lartë	1	0	5	30.0
21-30 banorë me arsim të lartë	2	1	1	20.0
31-50 banorë me arsim të lartë	3	0	2	25.0
> 51 banorë me arsim të lartë	4	1	0	25.0

Burimi: HDPC

Shifrat e përfaqësimit të femrës në administratën lokale dhe qëndore në qarkun e Beratit tregojnë një përfaqësim relativisht të mirë të saj si nëpunëse e administratës, me përjashtim të administratës së komunave ku shifra është 18.4% (shih tabelën 3.12). Megjithatë, shkalla e përfaqësimit në poste drejtorësh është shumë e ulët. Vetëm një femër është drejtoresh drejtorie në prefekturë, ndërsa asnjë femër nuk është drejtoresh drejtorie në keshillin e qarkut dhe në bashkitë e qarkut. Në gjykatat e shkallës së parë të Beratit dhe Skraparit punojnë 13 gjyqtarë dhe 3 prej tyre janë femra, të gjitha në rrethin e Beratit. Kryetarja e gjykatës së rrethit të Beratit është gjithashtu grua.

tabela 3.12 Femra në administratën qendrore dhe lokale te qarkut

	Total	Femra	%
Nëpunës në prefekturë	42	13	31.0
Drejtorë drejtorie në prefekturë	14	1	7.1
Nëpunës në qark	44	13	29.5
Drejtorë drejtorie në qark	8	0	0.0
Nëpunës në bashkitë e qarkut	220	106	48.2
Nëpunës në komuna	256	47	18.4
Drejtues në shkolla	197	52	26.4
Kryetarë gjykate	2	1	50.0
Gjyqtarë	13	3	23.1

Burimi: HDPC

3.5 Masa me përparësi në fushën gjinore

Vitet e fundit po i kushtohet një vëmendje më e madhe diskutimit të problemeve gjinore, si dhe trajtimit të mjaft dukurive ekonomike e sociale edhe nga këndvështrimi gjinor. Aktorët më aktivë në fushën e çështjeve gjinore janë organizatat jo fitimprurëse të grave, mediat dhe institucionet ndërkombëtare, misioni dhe strategjia e të cilave përmban elementë të çështjeve gjinore. Megjithatë, niveli i ndërgjegjësimit të institucioneve të ndryshme ekzekutive dhe vendimmarrëse për rëndësinë e problemit gjinor është ende i ulët. Kjo ka bërë që në rastin më të mirë institucionet të mjaftohen thjesht me konstatime të fenomeneve të ndryshme që lidhen me barazinë gjinore, çka është shoqëruar me mungesë politikash dhe masash të veçanta për rritjen e vëmendjes ndaj çështjeve gjinore.

Në këndvështrimin e Objektivave të Mijëvjeçarit për Zhvillimin, masat e mëposhtme me përparësi mund të ndikojnë në mënyrë të dukshme në përmirësimin e treguesve të barazisë gjinore të qarkut të Beratit: (i) Organizimi i veprimtarive të ndërgjegjësimit për aspektin gjinor në të gjitha nivelet politike dhe qeverisëse të qarkut; (ii) Marrja e zotimeve konkrete nga ana e strukturave politike nëpërmjet vendosjes së treguesve sasiorë të anëtarësisë së femrave në partitë politike në nivel lokal, të përfshirjes së femrave në forumet drejtuese të tyre, si dhe të numrit të femrave kandidatë në fushata të ndryshme elektorale; (iii) Organizimi i veprimtarive trajnuese për çështjet gjinore me pjesëmarrës nga drejtoritë e burimeve njerëzore në nivel lokal, të drejtorive të marëdhënies me publikun, zyrtarëve të punës dhe të sektorëve të tjerë, që ata të lehtësojnë pjesëmarrjen e gruas në administratë dhe në tregun e punës; (iv) Përfshirja e kriterit gjinor në kriteret e përzgjedhjes së punonjësve në nivele të ndryshme të administratës vendore: në komunë, bashki dhe qark, (v) Mbështetja e organizatave jo fitimprurëse me profil gjinor për të zhvilluar aktivitete ndërgjegjësimi para dhe gjatë



fushatave zgjedhore në mbështetje të kandidateve femra. Veçanërisht vëmendje kërkojnë fushatat e ndërgjegjësimit të bashkësive në zonat rurale për një klimë paqësore gjatë zgjedhjeve, si dhe për evidentimin e kandidateve femra dhe mbështetjen e tyre; (vi) Në përputhje me strategjinë sektoriale të punësimit, të hartuar nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, të hartohen dhe të zbatohen programe të veçanta të nxitjes së punësimit të femrave në nivel qarku e rrethesh; dhe (vii) Me anë të studimit të tregut të punës në kushtet e veçanta të qarkut të Beratit, të vihen në dukje nevojat për profesionet më të kërkuara e të mundshme për femrat dhe të nxitet kualifikimi i femrave në këto profesione nga strukturat shtetërore, private ose të shoqërisë civile.

Objektivi 3	Nxitja e barazisë gjinore
--------------------	----------------------------------

SYNIMI 6	Eliminimi i çdo dallimi gjinor në arsimin bazë dhe të mesëm
-----------------	--

Treguesi 22	Norma neto e regjistrimit
--------------------	----------------------------------

	2002		2006	
	Gjithsej femra	Femra fshat	Gjithsej femra	Femra fshat
Cikli i ulët %	94	93	95	94
Cikli i lartë %	96	88	97	90

Treguesi 23	Shkalla e frekuentimit
--------------------	-------------------------------

	2002		2006	
	Gjithsej femra	Femra fshat	Gjithsej femra	Femra fshat
Arsimi bazë %	98	99	98	99
Arsimi i mesëm %	99	72	99	99

Treguesi 24	Kalueshmëria
--------------------	---------------------

	2002		2006	
	Gjithsej femra	Femra fshat	Gjithsej femra	Femra fshat
Arsimi baze %	96	95	97	96

SYNIMI 7	Rritja e rolit të femrave në zhvillimin ekonomik të qarkut
-----------------	---

Treguesi 25	Shkalla e papunësisë të femrave në qytete
--------------------	--

Qyteti	2001	2015
Berati %	46.9	28.0
Ura Vajguore %	62.2	30.0
Kuçova %	49.8	26.0
Çorovodë %	46.2	25.0
Poliçan %	38.4	22.0

Treguesi 26	Femra në pozicione drejtuese	
Rrethi	2003	2015
Berati %	14.1	32
Kuçova %	14.3	32
Skrapari %	17.5	35
Qarku %	14.0	32

SYNIMI 8

Rritja e rolit të femrave në strukturat vendimmarrëse dhe në administratën qendrore dhe lokale të qarkut

Treguesi 27	Femra në strukturat vendimmarrëse	
	2003	2015
Femra të zgjedhura në strukturat drejtuese të degëve të partive politike	24%	35%
Femra të zgjedhura në organet e pushtetit vendor	5%	25%

Treguesi 28	Femra në administratën qendrore dhe lokale	
	2003	2015
Nëpunës në prefekturë	31.0%	40.0%
Nëpunës në qark	29.5%	40.0%
Nëpunës në bashkitë e qarkut	48.2%	55.0%
Nëpunës në komuna	18.4%	33.0%

përkujdesja për shëndetin e nënës dhe fëmijës

“Zvogëlimi i vdekshmërisë foshnjore” dhe “Përmirësimi i shëndetit të nënës” janë Objektivat 4 dhe 5 të Mijëvjeçarit për Zhvillimin. Zvogëlimi, brenda vitit 2015, me dy të tretat i normës së vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç dhe me tre të katërtat i normës së vdekshmërisë amësore janë synimet më kryesore të këtyre dy objektivave. Këto lidhen me rritjen e kujdesit për fëmijët nën moshën 5 vjeç, uljen e vdekshmërisë foshnjore, vaksinimin e të gjithë fëmijëve njëvjeçarë, si dhe me rritjen e kujdesit për nënën para dhe pas lindjes. Sipas analizave në nivel kombëtar, del se Shqipëria mbase mund të përmbushë objektivin 4, për të cilin shkalla e mbështetjes nga ana e politikave, kuadrit ligjor, burimeve të financimit, ndërgjegjësimit të publikut etj. konsiderohet e dobët. Shqipëria mundet të përmbushë objektivin 5, për të cilin shkalla e mbështetjes së këtyre faktorëve quhet normale³⁶.

³⁶ UNDP (HDPC). “Shqipëria dhe Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit”, Tiranë, maj 2002.

4.1 Të dhëna të përgjithshme

Kujdesi për shëndetin publik është përgjegjësi e përbashkët e pushtetit qendror dhe e organeve të pushtetit vendor. Masa dhe mënyra e shpërndarjes së funksioneve dhe përgjegjësi janë të përcaktuara me ligj.

Sistemi shëndetësor përbëhet nga shërbimi shëndetësor parësor, shërbimi spitalor dhe shërbimi farmaceutik. Shërbimi shëndetësor parësor apo shërbimi ambulator përfaqëson edhe pjesën më të rëndësishme të këtij sistemi. Misioni kryesor i tij është të sigurojë përmirësimin e vazhdueshëm të shëndetit dhe kushte më të mira shëndetësore për popullatën. Ai përfaqëson edhe kontaktin e parë të personelit shëndetësor me popullatën. Prandaj edhe lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me përmbushjen e objektivave të përcaktuara në fushën e përkujdesjes për shëndetin e nënës dhe fëmijës, sidomos në zonën rurale, ku shërbimi spitalor pothuajse nuk ekziston.

Shërbimi shëndetësor parësor është organizuar në nivel drejtorie të kujdesit shëndetësor parësor në qendër të qarkut dhe drejtorie të shëndetit publik të rretheve. Ai sigurohet nëpërmjet qendrave shëndetësore dhe ambulancave. Sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë, në zonën rurale, si rregull, duhet të ketë të paktën një qendër shëndetësore për çdo komunë dhe nga një ambulancë në çdo fshat, ndërsa në zonën urbane numri i ambulancave përcaktohet në varësi të numrit të popullsisë. Sigurimi i aktivitetit të tyre dhe mirëmbajtja janë përgjegjësi e pushtetit vendor, si një funksion i deleguar nga pushteti qendror. Kualifikimi profesional, veprimtaritë parandaluese dhe edukuese, mbikëqyrja e cilësisë së shërbimeve, shpërndarja dhe vendndodhja e institucioneve etj., janë përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë që ushtrohen nëpërmjet Drejtorive të Shëndetit Publik të rretheve.

Reforma e decentralizimit në shëndetësi ka filluar të zbatohet në vitin 1999, kur për herë të parë shpenzimet operative për këtë shërbim i kaluan pushtetit vendor. Masat që po merren mbështeten në strategjinë 10-vjeçare të sektorit të shëndetësisë dhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social. Ato synojnë, midis të tjerash, zgjerimin e mundësisë për të patur shërbime shëndetësore, rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe rritjen e frytshmërisë së përdorimit të burimeve materiale, njerëzore dhe financiare të sistemit shëndetësor. Megjithatë, ritmet e decentralizimit në këtë sektor përgjithësisht konsiderohen të ulëta dhe përgjegjësitë kryesore vazhdojnë të mbeten tek pushteti qendror. Sipas ligjit³⁷, ndarja e funksioneve dhe kompetencave të përbashkëta të pushtetit qendror dhe vendor, ku përfshihet edhe funksionimi i sistemit të shërbimit parësor shëndetësor, duhej të fillonte në janar të vitit 2002, por kjo ende nuk është zbatuar. Një hap përpara është hedhur me matricën e masave publike prioritare, që është pjesë e SKZHES, ku përfshihen delegimi i më shumë kompetencave nga pushteti qendror tek pushteti vendor.

³⁷Ligji Nr. 8652 datë 21.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".

Në qarkun e Beratit, në fushën e shëndetit të nënës dhe fëmijës, përgjithësisht hasen të njëjtat probleme, mangësi e vështirësi që vihen re në shkallë vendi. Megjithatë, disa çështje të veçanta si mundësia për të pasur shërbimin shëndetësor parësor, sidomos në zonat rurale, përkujdesja për fëmijët e porsalindur dhe edukimi i nënave, kërkojnë një trajtim më të vëmendshëm, nëpërmjet ndërhyrjeve me përparësi në shkallë qarku, rrethi ose komune.

4.2 Vdekshmëria e fëmijëve

Vdekshmëria foshnjore

Sipas të dhënave zyrtare, vdekshmëria foshnjore³⁸ në qarkun e Beratit ka ardhur duke u ulur nga viti në vit (shih tabelën 4.1 dhe figurën 4.1). Shifra më e lartë e normës së vdekshmërisë foshnjore është vënë re në vitin 1993, rreth 40.4 për 1,000 lindje të gjalla, çka përkon me periudhën kur ky tregues edhe në shkallë vendi ka qenë në nivele të larta. Pas dy - tre viteve me tregues në një nivel përgjithësisht të mirë, vihet re një përkeqësim i menjëhershëm pothuajse në nivelin e parë, çka provon që këto përmirësime janë më shumë rezultat i rastësisë sesa i krijimit të kushteve të qëndrueshme për ta mbajtur këtë tregues në nivelet e duhura. Në vitin 2002 vlera e vdekshmërisë foshnjore u raportua rreth 3 herë më e vogël se në vitin 1993.

Duhet theksuar se gjatë kësaj periudhe edhe numri i lindjeve është zvogëluar dukshëm. Ndikimin më të madh në numrin e lindjeve e kanë dhënë ndryshimet demografike (shih kapitullin 1.1). Pas vitit 1990, një pjesë e konsiderueshme e popullsisë ka migruar dhe veçanërisht çiftet e reja, gjë që ka ulur ndjeshëm numrin e lindjeve, veçanërisht në zonën rurale. Kështu, rreth 40 fshatra të qarkut, shumica e të cilëve në rrethin e Skraparit, gjatë gjithë periudhës 1995-2002 kanë patur mesatarisht nga 0 në 2 lindje në vit. Në 8 komuna, nga të cilat 3 në rrethin e Skraparit dhe 5 në rrethin e Beratit, numri i lindjeve në vitin 2002 është më se 50% më i ulët se numri i lindjeve në vitin 1995.

Në shkallë rrethi, vlerat më të larta të vdekshmërisë foshnjore vërehen në rrethin e Beratit, 15.3 vdekje për 1,000 lindje të gjalla në vitin 2002 dhe më të ultat në rrethin e Skraparit, 4.3 vdekje për 1,000 lindje të gjalla. Megjithatë, vlera kaq të ulëta të këtij treguesi nuk duket se janë shumë të përligjura e bindëse. Është vështirë, për shembull, të shpjegohen arsyet e uljes së menjëhershme të vdekshmërisë foshnjore në këtë rreth nga 24.6 në 2.2 vdekje për 1,000 lindje të gjalla brenda një periudhe 4 vjeçare, kur në këtë periudhë nuk rezultojnë të jetë marrë ndonjë masë e posaçme në këtë fushë. Vlerat shumë të ulëta të këtij treguesi në zona të ndryshme të vendit, sipas UNICEF³⁹, lidhen me pasaktësitë në raportimin e rasteve të vdekjeve, veçanërisht në zonën rurale.

³⁸Vdekshmëria foshnjore nënkupton vdekshmërinë e fëmijëve të moshës deri në një vjeç dhe është numri i vdekjeve për 1000 lindje të gjalla.

³⁹UNICEF, Multiple Indicator Cluster Survey Report, Tirana, Dhjetor 2000.

tabela 4.1 Norma e vdekshmërisë së fëmijëve 0-1 vjeç në qarkun e Beratit

	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002
Berat	46.6	28.9	28.1	24.9	18.7	27.7	24.7	14.3	23.4	15.3
Kuçovë	27.4	48.8	18.9	17.4	23.6	37.2	19.7	10.8	5.7	8.8
Skrapar	29.4	36.8	20.6	19.6	10.5	24.6	7.6	5.6	2.2	4.3
Qarku	40.4	33.4	24.9	22.8	17.8	28.4	21.0	12.4	17.9	12.4
Vendi	33.4	35.7	30.0	25.8	22.5	20.5	17.5	16.0	17.4	17.3


Burimi: Ministria e Shëndetësisë

Rreth 60% e vdekjeve foshnjore në shkallë qarku janë tek femrat (shih tabelën 4.2). Rastet e vdekjeve në banesë, megjithëse janë ulur nga viti në vit, mbeten përsëri më të larta sesa vdekjet në klinikë. Nga të dhënat del që më shumë se 50% e vdekjeve të periudhës 1999-2002 kanë ndodhur në banesë dhe në vitin 2002 këto kanë qenë më shumë se 60% e rasteve. Numri i vdekjeve foshnjore të ndodhura në muajin e parë të jetës në vitin 2002 është 28.5% dhe pothuaj të gjitha vdekjet në muajin e parë të jetës ndodhin në klinikë, ndërsa vdekjet në banesë janë kryesisht ato që ndodhin pas muajit të parë të jetës. Në shumë prej këtyre rasteve vlerësohet se ndihma e mjekut kërkohet ose jepet me shumë vonesë, duke mos dhënë mundësi që asistencë nga ana e tij të jetë efektive. Sëmundjet e frymëmarrjes dhe ato perinatale konsiderohen si shkaqet më kryesore të vdekjeve. (shih tabelën 4.2). Të gjitha këto tendenca që vihen re në qarkun e Beratit del se janë përgjithësisht të njëjta me ato në shkallë vendi.

Numri i përgjithshëm i vdekjeve të fëmijëve të moshës deri në 1 vjeç gjatë vitit 2002 në shkallë vendi ishte 466. Rreth 51% e tyre kanë ndodhur në banesë, ndërsa pjesa tjetër në spital. Vdekjet gjatë muajit të parë pas lindjes zënë rreth 39% të rasteve. Shkaqet kryesore kanë qenë ato të sëmundjeve të aparatit të frymëmarrjes dhe perinatale, të cilat sëbashku përfaqësojnë rreth 50% të rasteve. Pësha specifike e vdekjeve për shkaqe pulmonare tek fëmijët nën 1 vjeç është dyfishuar nga viti 2001 në vitin 2002.

Analiza e shkaqeve të vdekshmërisë foshnjore në qarkun e Beratit tregon se ato përfshijnë një spektër të gjerë arsyesh, veçanërisht për zonën rurale, që nga mundësia e kufizuar e popullsisë për të përfituar shërbimin shëndetësor dhe deri te niveli ekonomik, kushtet e jetesës e niveli kulturor i familjes në përgjithësi dhe i nënës në veçanti.

Fig. 4.1 Vdekshmëria foshnjore në rrethet e qarkut të Beratit



Në të gjitha rrethet vërehet përgjithësisht prirja e rritjes së përgjegjshmërisë së personelit mjekësor dhe ndihmës, por mbeten ende aspekte të rëndësishme për t'u përmirësuar. Kështu, vazhdojnë rastet e mosregjistrimit në kohë të fëmijëve në zyrat e gjendjes civile, me gjithë përmirësimet e bëra në legjislacion vitet e fundit. Po kështu ka edhe raste të mungesës së raportimit apo të raportimeve të vonuara të vdekjeve foshnjore.

tabela 4.2 Vdekjet e fëmijëve nën 1 vjeç në Qarkun e Beratit, 2002

	Nr. i vdekjeve nën 1 vjeç	Vdekje sipas gjinisë		Vendbanimi		Shkaqet kryesore (%)		
		Meshkuj	Femra	Qytet	Fshat	Sëmundjet e aparatit të frymëmarrjes	Perinatale	Të papërcaktuara
Berat	20	7	13	10	10	35	-	30
Kuçovë	5	3	2	4	1	20	40	20
Skrapar	2	1	1	1	1	50	-	-
Qarku	27	11	16	15	12	33.3	7.4	25.9
Vendi	466	243	223	190	276	27.0	22.1	15.7

Burimi: Ministria e Shëndetësisë

Ndjekja e shëndetit të fëmijëve të moshës nën 1 vjeç bëhet nga konsultoret e fëmijëve, të cilat janë një element i rëndësishëm parandalues ndaj sëmundjeve në këtë grup moshë. Në qytet, ecuria e shëndetit të fëmijëve ndiqet me kujdes nga personeli i këtyre konsultoreve, por në zonat rurale vihen re probleme të herëpashershme, më së shumti për shkak të pakujdesisë së personelit shëndetësor dhe prindërve.

Sipas strategjisë së zhvillimit të sektorit të shëndetësisë dhe Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social, vdekshmëria foshnjore në shkallë vendi synohet të ulet nga 17.3 në vitin 2002, në 14 në vitin 2006 dhe në 10.1 në vitin 2015. Në qarkun e Beratit janë mundësitë që këta tregues të arrihen brenda një kohe më të shkurtër. Kështu, norma e vdekshmërisë foshnjore prej rreth 10 vdekje/mijë lindje të gjalla mund të realizohet deri në vitin 2006. Që të përmbushet ky objektivi, masa të veçanta kërkohet të merren në të tre rrethet, por veçanërisht në zonën rurale të rrethit të Beratit, ku ky tregues raportohet të jetë më i përkeqësuar.

Në dy qendra shëndetësore të Beratit dhe në një qendër shëndetësore të Kuçovës është duke u zbatuar një projekt tre vjeçar i financuar nga USAID, i cili ka për qëllim rritjen e frytshmërisë së këtyre qendrave dhe konsolidimin e marëdhënieve ndërmjet personelit të shërbimit shëndetësor dhe publikut. Projekti është përqendruar në: (i) përmirësimin e cilësisë së shërbimit të kujdesit parësor, (ii) përmirësimin e menaxhimit të qendrës shëndetësore, (iii) përmirësimin e sistemit të informacionit shëndetësor, (iv) përmirësimin e financimit, planifikimit dhe buxhetimit.

Vdekshmëria e fëmijëve nën 5 vjeç

Norma e vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç⁴⁰ në shkallë qarku përgjithësisht ka pësuar rënie të vazhdueshme nga viti në vit (shih tabelën 4.3). Vlerat më të larta janë vënë re në vitet 1992 dhe 1993, veçanërisht në rrethin e Beratit dhe të Kuçovës, duke arritur deri në rreth 62 vdekje për 1,000 lindje të gjalla. Rrethi i Beratit në të gjitha vitet ka shfaqur tregues më të përkeqësuar të vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç krahasuar me dy rrethet e tjera. Ashtu si në rastin e vdekshmërisë foshnjore, edhe për treguesin e vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç vihen re luhatje të dukshme të vlerave, të cilat dëshmojnë për nevojën e përmirësimit të mëtejshëm të sistemit të raportimit të tyre.

Rastet më të shumta të vdekjeve të fëmijëve të moshës deri në 5 vjeç i takojnë grupmoshës 1-2 vjeç. Këto përfaqësojnë rreth 58% të rasteve në shkallë qarku, ndërsa në rrethin e Beratit rreth 67% të rasteve. Këto të dhëna tregojnë për ulje të kujdesit nga ana e personelit mjekësor dhe e prindërve pasi fëmija mbush moshën 1 vjeç, sidomos në zonën rurale.

tabela 4.3 Norma e vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç

	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002
Berat	62.5	42.8	38.3	33.5	21.4	33.2	28.4	24.1	25.2	22.0
Kuçovë	31.5	62.3	23.1	22.6	23.6	41.5	22.1	16.1	5.6	22.0
Skrapar	34.1	41.8	22.8	23.4	11.9	35.1	18.9	9.3	7.1	6.4
Qarku	52.4	45.7	32.5	30.1	20.0	34.6	25.9	20.7	19.3	18.9
Vendi	44.0	47.1	38.7	33.1	27.50	25.9	22.0	19.7	20.1	20.7

Burimi: Ministria e Shëndetësisë

⁴⁰Ky tregues nënkupton vdekshmërinë e fëmijëve të moshës nga 1 deri në 5 vjeç.

Megjithëse vdekshmëria e fëmijëve nën 5 vjeç ka ardhur duke u ulur, ka ende zona, veçanërisht ato rurale, në të cilat numri i vdekjeve është i madh. Nga pikëpamja e moshës, më problematike janë fëmijët e moshës 1-2 vjeç, ndërsa shkaku kryesor mbeten sëmundjet pulmonare dhe ato kardiovaskulare. Edhe në këtë rast, dukuri negative është numri i lartë i vdekjeve të ndodhura në banesë. Kjo shpjegohet kryesisht me nivelin e ulët të kulturës shëndetësore të prindërve në zonat më problematike dhe me mungesën e shërbimit të përhershëm shëndetësor në këto zona, i cili bën që fëmijët e sëmurë të paraqiten me mjaft vonesë në spitalin pediatrik më të afërt.

Fëmijët e lindur nën peshë

Fëmijët e lindur nën peshë janë kategoria më e prekshme prej vdekshmërisë foshnjore dhe vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç. Ndër shkaqet kryesore të lindjes nën peshë janë kushtet e varfra social-ekonomike të familjeve, ushqyerja e papërshtatshme, streset e ndryshme të nënës, veçanërisht gjatë periudhës së shtatzënisë, kontakti i pakët me personelin shëndetësor dhe ndjekja jo sistematike e gruas shtatzënë në qendrat shëndetësore të specializuara.

Në qarkun e Beratit, përqindja e fëmijëve të lindur nën peshë ka ardhur kryesisht duke u ulur nga viti në vit dhe është në nivel më të mirë sesa mesatarja në shkallë vendi (shih tabelën 4.4). Ky tregues është më i përkeqësuar në rrethin e Beratit, ku në vitin 2002 e tejkalonte vlerën mesatare të këtij treguesi në shkallë vendi. Ashtu si dhe për treguesit e tjerë të analizuar më sipër, rrethi i Skraparit ka vlera mjaft të ulëta dhe në vitin 2002 në këtë rreth nuk është raportuar asnjë lindje nën peshë.

Ushqyerja me gji është një faktor i rëndësishëm për rritjen e shëndetshme të fëmijës. Të dhënat për qarkun e Beratit tregojnë për një traditë të fortë e të qëndrueshme të ushqyerjes me gji. Numri i fëmijëve të ushqyer me gji ka ardhur duke u rritur. Kështu, në rrethin e Beratit gjatë vitit 2003 rreth 88.6% e fëmijëve janë ushqyer me gji. Rreth 65% e tyre janë në fshat, ndërkohë që, për të njëjtën periudhë, shumica e fëmijëve të ushqyer në mënyrë artificiale janë me banim në qytet. Në përgjithësi, konsiderohet se janë mundësitë për një përmirësim të mëtejshëm të këtij treguesi, në mënyrë të veçantë në zonën urbane të qarkut.

tabela 4.4 Përqindja e fëmijëve të lindur nën peshë

	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002
Berat	-	-	6.1	4.4	5.8	3.8	2.6	2.5	3.1	5.0
Kuçovë	-	-	3.9	3.8	2.5	3.0	3.1	2.6	3.9	1.7
Skrapar	-	-	4.5	3.7	6.4	5.8	18.1	1.4	0.6	0.0
Qarku	-	-	5.5	1.7	5.5	4.0	5.2	2.3	2.8	3.7
Vendi	6.8	8.3	9.3	5.0	7.1	5.7	6.0	4.8	4.4	4.7

Burimi: Ministria e Shëndetësisë



Vaksinimi i fëmijëve

Gjendja e vaksinimit të fëmijëve në rrethet e qarkut të Beratit është e mirë dhe pothuaj në nivelin e mesatares kombëtare (shih tabelën 4.5). Vlerat më të ulëta të mbulimit me vakcina në qark janë në vitet 1996 dhe 1998, por në vitin 2002 shkalla e mbulimit me vakcina ka arritur në 95%. Edhe në shkallë komunash përgjithësisht ky tregues nuk ka shmangie të rëndësishme krahasuar me mesataren e rrethit, ku ato bëjnë pjesë. Nuk ka, gjithashtu, dallime midis zonës urbane dhe asaj rurale.

Në shkallë vendi është arritur që, me mbështetjen e UNICEF, të sigurohet mbulimi në masën 100% i nevojave për vakcina të programit EPI. Synohet përfshirja gjithnjë e më e madhe e Ministrisë së Shëndetësisë në financimin e programit të vaksinimit deri në financimin e plotë të tij në vitin 2005. Mbulesa vaksinale në nivele të larta në të gjithë vendin po siguron ulje të ndjeshme të sëmundjeve ngjitëse, ndërkohë që Shqipëria është çertifikuar si vend pa poliomielit.

Procesi i vaksinimit organizohet dhe kontrollohet nga sektori i epidemiologjisë në secilin rreth. Instruktoret përgjegjëse për vaksinimin mbi bazën e një programi të caktuar, bëjnë kontrolle mbi dokumentacionin, në veçanti lidhur me zbatimin e kalendarit të vaksinimit, funksionimit të zinxhirit ftohës, si dhe janë angazhuar në trajnimin e infermiereve vaksinatore në të gjitha zonat e rrethit. Këto kontrolle janë tepër të rëndësishme, pasi në zonat problematike ka raste të mangësive në mbajtjen e dokumentacionit dhe në zbatimin e kalendarit të vaksinimit. Me gjithë këto masa, të dhënat tregojnë se ka akoma familje dhe individë që vazhdojnë të nënvlerësojnë e të mos kujdesen për vaksinimin e fëmijëve të tyre, nuk paraqiten në kohën e duhur për t'u vaksinuar apo nuk njoftojnë kur largohen nga vendbanimi i tyre.

tabela 4.5 Vaksinimi i fëmijëve kundër fruth-rubeolës⁴¹

	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002
Berat	-	93.4	93.2	91	94.2	89	96.6	92	96	95
Kuçovë	-	92.2	89	-	88.6	77	80.9	86.8	90	94
Skrapar	-	90	98.7	90	97	84	89.2	88.2	96	96
Qarku	-	92.9	96.2	83.5	93.5	84	91.9	90.7	94	95
Vendi	76.2	81.2	91	92	95.06	90	83.9	92	95.1	96

Burimi: Ministria e Shëndetësisë

⁴¹Nga viti 1993 deri në vitin 2000 është zbatuar vetëm vaksinimi kundër fruthit, ndërsa më pas u zbatua Programi Kombëtar i luftës kundër fruth-rubeolës.

4.3 Vdekshmëria amësore

Qarku i Beratit në tre vitet e fundit nuk ka asnjë rast të vdekshmërisë amësore, ndërsa rrethi i Kuçovës këtë tregues e ka zero që prej vitit 1993 (shih tabelën 4.6). Vitet e fundit shkalla e kujdesit për nënën ka ardhur duke u rritur. Të gjitha lindjet në qarkun e Beratit asistohen nga personel i kualifikuar për këtë qëllim, përfshirë edhe lindjet që ndodhin në banesë. Megjithatë, rastet e vdekjeve amësore të ndodhura në vitin 1996 dhe 1999 në rrethin e Skraparit, si dhe në vitin 1997 në rrethin e Beratit janë argument i mjaftueshëm për të mbajtur nën kujdes të vazhdueshëm këtë tregues në të gjithë qarkun.

tabela 4.6 Norma e vdekshmërisë amësore

	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002
Berat	32.5	64.8	66.1	0.0	79.6	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Kuçovë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Skrapar	0.0	0.0	0.0	130.3	0.0	0.0	378.7	0.0	0.0	0.0
Qarku	21.5	43.3	41.2	24.3	54.8	0.0	64.8	0.0	0.0	0.0
Vendi	19.7	40.2	29.1	32.2	27.5	21.6	20.7	22.6	22.7	26.0

Burimi: Ministria e Shëndetësisë

Pavarësisht nga treguesit pozitivë të vdekshmërisë amësore, mbetet shumë për të bërë në drejtim të shëndetit të nënës. Në këtë aspekt, midis të tjerash, ndihet nevoja e trajnimit të personelit shëndetësor që punon në shërbimet e kujdesit për nënën dhe fëmijën me konceptet bashkëkohore të këtij profesioni.

4.4 Mundësia për të pasur shërbime shëndetësore bazë

Sipas standardeve ndërkombëtare, një person quhet se ka mundësinë të shfrytëzojë shërbimet shëndetësore atëherë kur ai mund të arrijë shërbime shëndetësore lokale të përshtatshme në këmbë apo me mjete transporti në jo më shumë se një orë.

Qendrat shëndetësore dhe ambulancat

Shërbimi shëndetësor parësor mbështetet në një rrjet ambulancash e qendrash shëndetësore. Numri i ambulancave në qytet varet nga numri i popullsisë, ndërsa çdo komunë duhet të ketë të paktën një qendër shëndetësore në përputhje me tipin standard të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë. Në secilën qendër shëndetësore duhet të ketë një mjek të përgjithshëm/mjek familjeje i mbështetur nga infermiere dhe/ose mami. Çdo fshat duhet të ketë të paktën një

ambulancë në varësi të qendrës shëndetësore të komunës, ku bën pjesë fshati. Ambulanca duhet të ketë një infermiere/mami, e cila duhet të sigurojë kujdesin për gruan shtatzënë, shërbimet shëndetësore për fëmijën dhe vaksinimin sipas kalendarit për këtë qëllim.

tabela 4.7 Të dhëna për sistemin shëndetësor në qarkun e Beratit

	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002
Qendra Shëndetësore	56	52	54	52	36	35	34	37	37
Ambulanca	178	207	102	113	119	119	119	152	170
Konsultori i fëmijëve	141	153	148	148	146	145	142	171	186
Konsultori i gruas	124	149	137	135	132	n.a	n.a	178	184
Spitale	4	4	4	4	4	4	4	4	4

Burimi: Drejtoria e Shëndetit Publik

Në qarkun e Beratit funksionojnë 37 qendra shëndetësore, 170 ambulanca, 186 konsultore për fëmijë dhe 184 konsultore të gruas. Gjithashtu në këtë qark ndodhen edhe 4 spitale, përkatësisht 2 në qytetin e Beratit, një në qytetin e Kuçovës dhe një në qytetin e Çorovodës (shih tabelën 4.7). Mbulimi me qendra shëndetësore në të tre rrethet e qarkut paraqitet i mirë. Qendra shëndetësore ka në çdo komunë të rrethit të Beratit dhe të Kuçovës, ndërsa në rrethin e Skraparit janë pa qendër shëndetësore komuna e Vendreshës dhe e Zhepës, ku jeton rreth 23% e popullsisë rurale të këtij rrethi.

Të gjitha qendrat shëndetësore të rrethit të Beratit janë rikonstruktuar ose janë ndërtuar të reja gjatë periudhës së tranzicionit dhe në rreth 70% të tyre investimet janë bërë me fonde të buxhetit të shtetit. Edhe qendrat shëndetësore të rrethit të Kuçovës janë përgjithësisht në gjendje të mirë, megjithëse për to nuk ka pasur fonde për investime kapitale por vetëm mirëmbajtjeje. Aktualisht, vetëm një qendër shëndetësore në komunën e Perondisë nuk është në gjendje të mirë. Gjendja është e ndryshme në rrethin e Skraparit. Të gjitha qendrat shëndetësore ekzistuese të këtij rrethi janë rehabilituar apo ndërtuar të reja me fonde të buxhetit të shtetit. Por rreth 50% e qendrave ekzistuese janë aktualisht në gjendje të keqe fizike, megjithëse godinat e tyre janë rehabilituar gjatë dhjetëvjeçarit të fundit.

tabela 4.8 Fshatrat pa godinë ambulance

	Fshatra pa godinë ambulance	Banorë në fshatrat pa ambulance	Fshatra me më shumë se 500 banorë
Berat	62	25,257	18
Kuçovë	8	9,340	4
Skrapar	87	11,463	0
Qarku	157	46,060	22

Burimi: Drejtoria e Shëndetit Publik, 2003

Figura 4.1 | Mbulimi i komunave me qendra shëndetësore



Figura 4.2 | Mbulimi i fshatrave me ambulanca



Shkalla e mbulimit me ambulanca është krejt e ndryshme nga ajo me qendra shëndetësore. Në shkallë qarku, 157 fshatra nga 245 fshatra gjithsej janë pa godinë ambulance dhe infermieret shërbejnë në shtëpitë e tyre ose në mjedise me qira. Në këto fshatra jeton rreth 40% e popullsisë rurale të qarkut. Rreth 56% e numrit të ambulancave ekzistuese janë rikonstruktuar apo ndërtuar të reja gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, shumica e të cilave me fonde të buxhetit të shtetit. Ambulancat e tjera janë në gjendje shumë të keqe fizike dhe kanë nevojë urgjente për investime.

Shkalla e mbulimit me ambulanca të fshatrave është mjaft e ulët në rrethin e Skraparit. Vetëm 18 nga 105 fshatra gjithsej të këtij rrethi kanë ambulanca dhe rreth gjysma e tyre janë aktualisht në gjendje jo të mirë fizike, megjithëse në to janë bërë disa investime rehabilitimi (shih tabelën 4.9). Shumica e këtyre fshatrave janë me një numër të vogël banorësh, me më pak se 500 banorë.

tabela 4.9 **Shtirja e qendrave shëndetësore dhe ambulancave në zonat rurale**

	Mbulimi me Qendra Shëndetësore %	Mbulimi me Ambulanca %	Qendra shëndetësore ekzistuese			Ambulanca ekzistuese		
			Rikonstruktuar & ndërtuar të reja (%)	Nga buxheti i shtetit (%)	Në gjendje të keqe (%)	Rikonstruktuar & ndërtuar të reja (%)	Nga buxheti i shtetit (%)	Në gjendje të keqe (%)
Berat	100.0	49.5	100.0	70.0	0.0	55.7	44.1	44.3
Kuçovë	100.0	55.5	0.0	0.0	16.6	50.0	60.0	0.0
Skrapar	80.0	17.2	100.0	100.0 ⁴²	50.0	66.6	100.0	66.7

Burimi: Drejtoria e Shëndetit Publik, 2003

Gjendja e plotësimit me pajisje e mjete e qendrave shëndetsore dhe ambulancave për të zhvilluar veprimtarinë në kushte normale vlerësohet se është shumë nën nivelin e standardeve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Në kuadrin e sigurimit të mundësisë së barabartë për të patur shërbime shëndetësore, dhe të përmirësimit të cilësisë së tyre, në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social është parashikuar plotësimi i hartës së shërbimit parësor, duke synuar që brenda vitit 2006 të plotësohen tërësisht nevojat për qendra shëndetësore pranë komunave dhe mbi 50% e nevojave për ambulanca pranë çdo fshati, duke siguruar infrastrukturën e nevojshme. Në përputhje me këtë objektiv, në qarkun e Beratit janë mundësitë që deri në vitin 2006 të plotësohen tërësisht nevojat për qendra shëndetësore, si dhe rreth 70% e nevojave për ambulanca në rrethin e Beratit, 100% në rrethin e Kuçovës dhe 50% në rrethin e Skraparit. Me këto ritme bëhet e mundur që deri në vitin 2010 të gjitha fshatrat e qarkut të kenë ambulanca.

Mbulimi me farmaci

Në të gjithë qarkun janë të licensuara 21 farmaci dhe 14 agjenci farmaceutike. Gjeografikisht, rrjeti farmaceutik është i përqendruar në zonat urbane, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë

⁴²Në tre raste qendrat shëndetësore janë ndërtuar apo rikonstruktuar me fonde të përbashkëta të buxhetit të shtetit dhe donatorëve



në ofrimin e kufizuar të këtij shërbimi në zonat rurale. Kjo është më e theksuar në rrethin e Skraparit. Si rrjedhim, në procesin e licensimit është e domosdoshme që autoritetet përkatëse të mbajnë parasysh edhe kriterin e shpërndarjes gjeografike të këtij shërbimi, veçanërisht për zonat rurale. Një problem tjetër për zonat rurale është niveli i kualifikimit të personelit të shërbimit farmaceutik, sepse në shumicën e rasteve ky shërbim ofrohet nga personel i pakualifikuar. Kështu, një popullsi prej rreth 90,000 banorësh në fshatrat e Beratit i shërbehet nga 4 ndihmës farmacistë, ndërsa në komunat e rrethit të Skraparit ka vetëm një ndihmës farmacist.

Personeli mjekësor

Problemet më të mëdha për plotësimin e nevojave me personel të lartë mjekësor ndeshen në zonat rurale të qarkut, ndërsa në zonat urbane vështirësitë lidhen me sigurimin e mjekëve specialistë, veçanërisht në shërbimin spitalor.

Në qarkun e Beratit ushtrojnë profesionin e mjekut 89 mjekë të familjes. Rreth 53% e tyre shërbejnë në qytet. Plotësimi i nevojave me mjekë të familjes është më i mirë në rrethin e Beratit dhe të Kuçovës, ndërsa në rrethin e Skraparit ka mungesa të theksuara mjekësh (shih tabelën 4.10). Shërbimi parësor në tetë komunat e këtij rrethi mbulohet nga vetëm 4 mjekë. Secili prej tyre ka një ngarkesë mesatare 4,945 banorë krahasuar me 1,700-2,000⁴³ banorë për mjek që është norma e përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë. Duke qenë një rreth me terren shumë të thyer malor, largësite e komunave nga qytetet dhe midis komunave janë të mëdha. Infrastruktura rrugore, gjithashtu, është në gjendje të keqe (shih kapitullin 1.6). Si rrjedhim, mundësite reale që banorët të përfitojnë nga kujdesi i mjekut të familjes janë shumë të kufizuara.

tabela 4.10 Shpërndarja dhe ngarkesa e mjekëve të përgjithshëm

	Rrethi	N. Mjekëve	Banorë/mjek
Zona urbane	Berat	28	2,370
	Kuçovë	12	2,342
	Skrapar	7	2,412
Zona rurale	Berat	30	2,892
	Kuçovë	7	2,469
	Skrapar	4	4,945
Qarku		89	2,660

Dhënia e përparësisë për rregullimin e sistemit të pagave në mënyrë të tillë që të rritet motivimi i mjekëve për të punuar në zonat rurale dhe veçanërisht në ato të largëta, përbën një domosdoshmëri, veçanërisht për rrethin e Skraparit. Rregullimet e deritanishme në sistemin e

⁴³Sipas udhëzimit të Ministrisë së Shëndetësisë, ngarkesa e mjekut të familjes është 2,000 banorë në zonën urbane dhe 1,700 banorë në zonën rurale.

pagave nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë janë ende të pamjaftueshme për të shërbyer si nxitje për personelin e lartë mjekësor që të punojnë në këto zona.

Në qarkun e Beratit ka, gjithashtu, 50 mjekë specialistë, rreth 72% e të cilëve ndodhen në klinikat dhe spitalet e Beratit, ndërsa në Kuçovë dhe Skrapar punojnë përkatësisht 8 dhe 6 mjekë të tillë. Një shpërndarje e tillë e mjekëve specialistë bën që për pacientët e rrethit Skrapar dhe Kuçovë të ketë një shërbim më pak të kualifikuar, të vonuar dhe më të kushtueshëm. Përveç kësaj, shumë nga mjekët specialistë të rrethit të Kuçovës, që aktualisht janë në moshë pune, brenda një periudhe 4-5 vjeçare parashikohet të dalin në pension, ndërkohë që për perspektivën e zëvendësimit të tyre nuk është menduar.

Probleme ka edhe me përputhjen e shpërndarjes së mjekëve sipas specialiteteve me nevojat e rretheve. Kështu, aktualisht ka 4 kardiologë ndërkohë që ka vetëm një endokrinolog apo dermatolog në të gjithë qarkun. Për të plotësuar kërkesat për specialitetet që nuk ofrohen në rrethet e Kuçovës dhe të Skraparit, ka filluar të funksionojë praktika e përkohshme, me grafik, që disa mjekë specialistë të rrethit të Beratit të shkojnë në dy qytetet e tjera për të kryer vizitat.

4.5 Masat me përparësi

Duke qenë se sektori i shëndetësisë aktualisht është një nga sektorët, ku ecuria e decentralizimit të përgjegjësive nuk është e madhe, shumica e ndërhyrjeve me përparësi që lidhen me përkujdesjen për shëndetin e nënës e fëmijës programohen dhe financohen në mënyrë të përqendruar në shkallë vendi. Megjithatë, përmbushja e objektivave mund të përshpejtohet dhe ndihmohet nga pushteti vendor e nga strukturat e pushtetit qendror në nivel lokal, veçanërisht nëpërmjet disa masave me përparësi, të tilla si: (i) Kryerja e një studimi të plotë mbi sigurimin e shërbimeve shëndetësore në të gjithë territorin e qarkut, përmirësimi i cilësisë së tyre dhe rishpërndarja optimale e burimeve njerëzore në përputhje me standardet e përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë; (ii) Kompletimi me qendra shëndetësore i komunës së Vendreshës dhe Zhepës në rrethin e Skraparit brenda vitit 2005; (iii) Plotësimi deri në vitin 2006 me ambulanca i 70% të fshatrave të rrethit të Beratit, 50% të fshatrave të rrethit të Skraparit dhe i të gjitha fshatrave të rrethit të Kuçovës, si dhe plotësimi deri në vitin 2010 me ambulanca i të gjitha fshatrave të qarkut; (iv) Parashikimi afatgjatë i nevojave për investime në qendrat shëndetësore dhe ambulancat e zonës rurale, i ndërthurur me studimin e shpërndarjes optimale të shkollave, me synim shfrytëzimin e mjediseve të shkollave ekzistuese në fshatrat, ku parashikohet ulje e madhe e numrit të nxënësve; (v) Studimi i shpërndarjes së shërbimit farmaceutik dhe licensimi i subjekteve në përputhje me këtë studim; (vi) Vendosja e një bashkëpunimi institucional midis zyrave të gjendjes civile dhe strukturave të shëndetit publik për të disiplinuar regjistrimin e lindjeve në zonat rurale brenda afateve ligjore; (vii) Përmirësimi i sistemit të raportimit të të dhënave të vdekshmërisë dhe të sëmundshmërisë së fëmijëve; (viii) Nxitja dhe mbështetja e fushatave ndërgjegjësuere periodike në të gjitha nivelet nga ana e organeve të pushtetit vendor në bashkëpunim me drejtorinë e shëndetit parësor për rritjen e kujdesit ndaj shëndetit të fëmijëve, ushqyerjen me gji, vaksinimin dhe forcimin e lidhjeve të familjeve me personelin e shërbimit shëndetësor të të gjitha niveleve.



Objektivi 4: Përkujdesja për shëndetin e nënës dhe fëmijës

SYNIMI 9 Zvogëlimi i vdekshmërisë së fëmijëve deri në 5 vjeç

Treguesi 29	Vdekshmëria foshnjore	
	2002	2015
Berat	15.3	5.0
Kuçovë	8.8	3.0
Skrapar	4.3	3.0

Treguesi 30	Vdekshmëria e fëmijëve 1-5 vjeç	
	2002	2015
Berat	22.0	7.4
Kuçovë	22.0	7.4
Skrapar	6.4	5.0

Treguesi 31	Përqindja e vaksinimit të fëmijëve ndaj fruth-rubeolës	
	2002	2015
Berat %	95	100
Kuçovë %	94	100
Skrapar %	96	100

SYNIMI 10 Rritja e përdorimit të shërbimeve shëndetësore prej popullsisë

Treguesi 32	Shkalla e mbulimit me qendra shëndetësore	
	2003	2006
Berat %	100.0	100.0
Kuçovë %	100.0	100.0
Skrapar %	80.0	100.0

Treguesi 33	Shkalla e mbulimit me ambulanca	
--------------------	--	--

	2003	2006
Berat %	49.5	70.0
Kuçovë %	55.5	100.0
Skrapar %	17.2	50.0

Treguesi 34	Ngarkesa e mjekëve të përgjithshëm			
--------------------	---	--	--	--

	2003		2006	
	Zona urbane	Zona rurale	Zona urbane	Zona rurale
Berat %	2,370	2,892	2,000	2,300
Kuçovë %	2,342	2,469	2,000	2,000
Skrapar %	2,412	4,945	2,000	3,000

SYNIMI 11	Ulja e vdekshmërisë amësore	
------------------	------------------------------------	--

Treguesi 35	Vdekshmëria amësore	
--------------------	----------------------------	--

	2002	2015
Berat %	0.0	0.0
Kuçovë %	0.0	0.0
Skrapar %	0.0	0.0

Treguesi 36	Ushqyerja me gji	
--------------------	-------------------------	--

	2002	2010
Qarku %	74.0	90.0

synimet dhe treguesit

